

ISSN 1857 - 8896



ANAS

Studia humanitatis

12

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

Shkup, 2018

ANAS

Studia humanitatis

12

Botues
Instituti Alb-ShkencaEditor
Alb-Shkenca InstitutRedaktori përgjegjës
Prof. dr. Zeqirja NEZIRI
“Shën Cirili dhe Metodi”, MaqedoniEditor-in-chief
Zeqirja NEZIRI, PhD., University
“St. Cyril and Metodij”, MacedoniaZëvendës redaktorë
Prof. dr. Shpresa HOXHA
(Universiteti i Prishtinës, Kosovë)
Prof. dr. Kristaq JORGO
(Universiteti i Tiranës, Shqipëri)Vice editors
Shpresa HOXHA, PhD
(University of Pristina, Kosovo)
Kristaq JORGO, PhD
(University of Tirana, Albania)Redaksia
(Shqipëri) Emil LAFE
(SHBA) Sami REPISHTI
(SHBA) Niko QAFOKU
(Maqedoni) Zeqirja NEZIRI
(Kosovë) Shpresa HOXHA
(Shqipëri) Kristaq JORGO
(Maqedoni) Mustafa IBRAHIMI
(Shqipëri) Lluka QAFOKU
(SHBA) Robert MAGARI
(Kosovë) Arbnora DUSHI
(Kosovë) Nebi CAKA
(Shqipëri) Merita SAUKU BRUCI
(Maqedoni) Agim LEKA
(Kosovë) Arben HOXHAEditorial board:
Emil LAFE (Albania)
Sami REPISHTI (USA)
Niko QAFOKU (USA)
Zeqirja NEZIRI (Macedonia)
Shpresa HOXHA (Kosovo)
Kristaq JORGO (Albania)
Mustafa IBRAHIMI (Macedonia)
Lluka Qafoku (Albania)
Robert MAGARI (USA)
Arbnora DUSHI (Kosovo)
Nebi CAKA (Kosovo)
Merita SAUKU BRUCI (Albania)
Agim LEKA (Macedonia)
Arben HOXHA (Kosovo)Redaktor teknik
Prof. dr. Mustafa IBRAHIMITechnical editors
Mustafa IBRAHIMI, PhD.

PRMBAJTJA

Zeqirja NEZIRI

*NGA UNIVERSALJA KAH KOMBËTARJA – SKËNDERBEU TE BARLETI
DHE NAIMI*..... 5

Kristaq JORGO

*STATUSI DHE FUNKSIONI I DIALEKTEVE NË EVOLUCIONIN E
SISTEMIN LETRAR SHQIPTAR*..... 13

*STATUS AND FUNCTION OF DIALECTS IN THE EVOLUTION OF THE
ALBANIAN LITTERARY SYSTEM*..... 13

Nexhip MËRKURI

*KOMPETENCA DIGJITALE DHE RRRITJA E TË NXËNIT PËR GJUHËN
SHQIPE*..... 25

Mustafa IBRAHIMI

*SHUMETNIKËSIA DHE MIULTIKULTURALIZMI NË ONOMASTIKËN E
BIGËZUAR ARBËRESHE-ITALIANE*..... 39

*MULTI ETHNICITY AND MULTICULTURES IN THE ARBENESH-ITALIAN
FORKED ONOMASTICS*..... 39

Kosovare KRASNIQI

AGIM VINCA DHE KOSOVA 51

AGIM VINCA AND KOSOVO 51

AJTEN HAJDARI-QAMILI

*TERMINOLOGJIA ISLAME NË TEKSTET E PËRKTHYERA NË GJUHËN
SHQIPE*..... 59

ISLAMIC TERMINOLOGY AT TRANSLATING TEXTS INTO ALBANIAN..... 59

EDA SHEHU

*PROBLEME DHE ZGJIDHJE TË TYRE PËR FJALORËT TERMINOLOGJIKË
TË FUSHAVE HUMANITARE 71*

*ISSUES AND SOLUTIONS RELATED TO TERMINOLOGICAL
DICTIONARIES IN THE AREA OF HUMANITIES..... 71*

Brikena XHAFERI

*THE ROLE OF CORRECTIVE FEEDBACK IN SECOND LANGUAGE
ACQUISITION – A STUDY CONDUCTED WITH LANGUAGE TEACHERS
AND LEARNERS AT SEEU 81*

Afërdita DEMA

EMRAT E PËRVEÇËM NË VEPRËN ARTISTIKE TË REXHEP QOSES..... 93

DISTINCTIVE NAMES IN REXHEP QOSE'S ARTISTIC WORK 93

GRETA JANI

“KËNDI I VOGËL I GJUHËS” I NJË GJUHËTARI TË MADH 105

“SMALL ANGLE OF THE LANGUAGE” OF A GREAT LINGUIST 105

ANAS

Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 930.85(=18)
Punim studimor**Zeqirja NEZIRI**

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi

Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni

zeqirjaneziri@yahoo.com

**NGA UNIVERSALJA KAH KOMBËTARJA – SKËNDERBEU
TE BARLETI DHE NAIMI**

Përmbledhje

Studimi i ecurisë së personalitetit të Skënderbeut nga universalja kah kombëtarja paraqet interes për faktin se është në përputhje të plotë e në simetri me ecurinë e rrethanave kulturore historike, politike e filozofike letrare evropiane të Kohës së Re. Në këtë studim bëhen përpjekje të ndriçohet kjo dukuri përmes përshkrimit të figurës së Skënderbeut nga dy krijues shqiptarë të dy periudhave të largëta historike e të ndryshme kulturore, filozofike e letrare: Marin Barletit e Naim Frashërit. I pari, si përfaqësues i Humanizmit evropian të shekujve XV – XVI e bëri të famshëm në Evropë me veprën *Historia e Skënderbeut* (1510), ndërsa i dyti u bë poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare me poemën epike *Istori e Skënderbeut* (1898). Marin Barleti veprën e tij e shkroi në latinisht, në gjuhën dhe në frymën universale të kohës, ndërkaq Naim Frashëri poemën e tij e shkroi në gjuhën shqipe dhe në frymën iluministe romantike të shekujve XVIII – XIX.

Barleti në paraqitjen e Skënderbeut, duke u mbështetur në kërkesat historike, kulturore e filozofike letrare të kohës e popullarizoi në gjithë Evropën figurën e Skënderbeut dhe qëndresën shqiptare të shekullit XV. Kështu i dha frymë universale, si figurës së tij e personalitetit të Skënderbeut, ashtu edhe shqiptarëve që u udhëhoqën prej tij. Naim Frashëri, me veprën e tij duke e madhëruar figurën e Skënderbeut dhe qëndresën shqiptare të shekullit XV ndihmoi në rritjen e krenarisë, të vetëdijes e të ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve në frymën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Sheshimi i materialit ilustrativ të veprave këtyre dy autorëve i shërben analizës sonë të ecurisë historike të famës së Skënderbeut nga kategoria universale në kategorinë kombëtare.

Fjalët çelës: analizë, filozofi, formë, histori, kategori, kulturë, letërsi; humanizëm, iluminizëm, kombëtar, rilindje, romantizëm, universal.

Hyrje

Studimi i ecurisë së personalitetit të Skënderbeut nga kategoria universale drejt kategorisë kombëtare paraqet interes për faktin se është në përputhje të plotë e në harmoni me ecurinë e rrethanave kulturore historike, politike e filozofike letrare evropiane të Kohës së Re.

Në këtë studim, në mënyrë të sintetizuar bëhen përpjekje të ndriçohet ecuria e kësaj kategorie morale, pra nga universalja kah kombëtarja përmes përshkrimit të figurës së Skënderbeut nga dy krijues shqiptarë të dy periudhave të largëta historike e të ndryshme kulturore, filozofike e letrare, Marin Barletit e Naim Frashërit, njërit përfaqësues të Humanizmit Evropian, tjetrit përfaqësuesin kryesor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Mirëpo, midis këtyre dy periudhave, domethënë nga shekulli XVII deri në fillim të shekullit XIX paraqitet një periudhë për afro dy shekuj, në të cilën nuk shënohet ndonjë botim i rëndësishëm, përveç atij të Frang Bardhit¹, të botuar në gjysmën e parë të shekullit XVII.

Problemi i heshtjes, ose i mospërmendjes së figurës së Skënderbeut në shekujt XVII-XVIII sa lidhet me faktorët e përgjithshëm evropianë të përpjekjeve për krijimin e shteteve

¹ Franciscum, BLANCHUM, *Georgius Castriotes Epiensis, vulgo Scandebeg*, Venetii, 1636. *Skënderbeu*, apologji. Përkthyer Stefan I. Prifti, Tiranë 1957.

kombëtare, aq më shumë i atribuohet zhvillimit të rrethanave të brendshme historike, shoqërore e politike të shqiptarëve në vitet që pasuan pas rënies së tyre nën sundimin e gjatë osman. Shkencërisht është saktësuar se periudha e shekujve XVIII-XIX, në kulturën dhe historinë evropiane paraqet kohën e lindjes e të lulëzimit të konceptit lokal: si kultura e historia, ashtu edhe shkenca në përgjithësi humbin karakterin statik universal dhe fitojnë karakterin dinamik rajonal kombëtar. Ndaj edhe transformimi i personalitetit të Skënderbeut do parë edhe nga ky aspekt.

Barleti në paraqitjen e figurës së Skënderbeut dhe të qëndresës shqiptare të shekullit XV, duke u mbështetur në kërkesat historike, kulturore e filozofike letrare të kohës i afirmoi në gjithë Evropën². Kështu i dha frymë universale, si figurës e personalitetit të Skënderbeut, ashtu edhe shqiptarëve që u udhëhoqën prej tij.

Naim Frashëri, me veprën e tij, të botuar në fund të shekullit XIX duke e madhëruar figurën e Skënderbeut dhe qëndresën shqiptare të shekullit XV ndihmoi në rritjen e krenarisë, të vetëdijes e të ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve në frymën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Sheshimi i materialit ilustrativ të veprave të këtyre dy autorëve i shërben analizës sonë të transformimit historik të famës së Skënderbeut nga kategoria universale në kategorinë kombëtare.

1.0 Pak histori

Gjergj Kastrioti Skënderbeu është figura më e rëndësishme historike shqiptare e fundit të Mesjetës dhe e fillimit të Kohës së Re. I gjetur në cep të Evropës, në kufirin që ndante dy kontinente (Evropën me Azinë), diti me mjeshtëri të rrallë dhe aftësi të jashtëzakonshme strategjike t'i bëjë ballë sulmeve të pareshtura të Perandorisë Osmane, perandorisë së atëhershme më të madhe botërore.

Me qëndresën e tij 25-vjeçare kundër sulmeve të kësaj perandorie u bë model dhe sinonim i luftës çlirimtare i udhëheqësve kombëtarë kundër shtypjes e nënshtrimit. Këto ishin dy cilësi morale që i afirmonte Humanizmi Evropian i shekullit XV. Në pjesën e fundit të qëndresës së tij arriti të bëhet njëri ndër personalitetet, te i cili popujt e Evropës shihnin dritën e shpëtimit nga terri i Mesjetës dhe lindjen e një epoke të re. Në afirmimin e tij evropian e botëror ndihmoi edhe përkrahja që gëzoi, si nga udhëheqësit evropianë të

² Zija Xholi, *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare*, Tiranë, 2003: 27-29.

kohës (sidomos Alfonsët e Napolit), ashtu edhe nga Papa, i cili e shpërbleu me medaljen e “Kalorësit të Krishtit”. Përveç kësaj Papa Piu (1463) i kishte besuar udhëheqjen e një ushtrie gjith Evropiane kundërosmane, por me vdekjen e parakohshme të Piut, kjo iniciativë mbeti një ide e parealizueshme.

Kështu, Skënderbeu nga një hero kombëtar i një populli të skajit të Evropës Juglindore bëhet një personalitet historik universal. Në ndërtimin e figurës së tij universale ndihmuan edhe pikëpamjet e reja humaniste që kishin shpërthyer gjithandej Evropës. Një nga parimet humaniste ishte edhe pamja e figurës së personalitetit udhëheqës. Kërkohej që ai të ishte i gjallë e trim, i guximshëm e aktiv, mendjemprehtë e zemërgjerë, i afërt e i dhimbshëm, zemërbutë kur e do nevoja, por i rreptë dhe i egër për kundërshtarin, si dhe strateg luftarak e diplomat. Të gjitha këto tipare janë të skalitura për mrekulli në veprën e Marin Barletit.

1.1 Skënderbeu krenaria universale

Marin Barleti, si biografi i parë i Skënderbeut, kur shkroi librin e tij të famshëm, gati një gjysmëshekulli pas vdekjes së heroit, i gjetur para një përgjegjësie të madhe historike, në parathënien e librit shkruan me modesti, duke shprehur dhe një lloj frike, se mos nuk do të jetë në gjendje ta përshkruajë personalitetin e tij, ashtu si e kërkonte Humanizmi dhe ashtu si ai kishte bërë nam e ishte afirmuar në gjithë Evropën e kohës.

Marin Barleti kishte shkruar në latinisht, në gjuhën e Humanizmit, gjuhën universale të kohës. Në këtë kontekst ka dhënë një ndihmesë të madhe në ndërtimin dhe ngritjen e aureolës universale të Skënderbeut. Ngritjes së kësaj aureole i kanë ndihmuar edhe tre faktorë të tjerë kulturorë që janë: (a) ribotimi i këtij libri në gjuhën e origjinalit³, (b) përkthimi i tij në gjuhët kryesore evropiane përgjatë shekullit të parë të botimit⁴; dhe (c) botimi i dy veprave

³ Libri i Barletit në gjuhën e origjinalit është ribotuar tri herë: në Argentonat (Strasbourg) të Gjermanisë më 1537; në Frankfurt mbi Majn më 1578; dhe në Zagreb më 1743: Stefan I. Prifti, Hyrje: *Historia e Skënderbeut*. Përkthyer nga Stefan I. Prifti, Tiranë, 1964: 10.

⁴ *Historia e Skënderbeut* e Barletit është përkthyer dhe botuar në këto gjuhë: *anglisht* nga Z. J., Londër, 1596; në *frëngjisht* nga *Zhak dë Lavardin* u botua 5 herë në: Paris (1576, 1597, 1621), La Rochele (1593), Gjenevë (1604); *gjermanisht* nga *Johan Piniciani* përjetoi shtatë botime në: Augusta (Augsburg, 1533), Frankfurt am Main (1561, 1577, 1578, 1597), Magdeburg (1606 dy botime); *italisht* nga *Petro Roka* përjetoi katër botime në Venedik (1554, 1560, 1568, 1580); *polonisht* nga *Cyprian Banliku* përjetoi tri botime më: 1568, 1569 dhe 1587; *portugjisht* nga *F. de Andrades* u

historike: *njëra* në Evropën Lindore nga Martin Bjelski⁵ dhe *tjetra* në Evropën Perëndimore nga Zhak Lavardin⁶ janë dëshmi e gjallë e karakterit universal që ju dha Skënderbeut. Si faktor shtesë i përhapjes së famës së tij universale konsiderohet veprimtaria e studiuesve të Barletit (shqiptarë e të huaj), të cilët njëzëri që nga fillimi i shekullit XVI janë të një mendjeje se Marin Barleti ia ka arritur këtij qëllimi: ta afirmojë Skënderbeun në të gjitha anët e Europës dhe bashkë me të edhe vetë të bëhet një krijues i famshëm që lexohet nga të gjitha anët e botës⁷.

1.2 Skënderbeu ekzotikë kombëtare

Nga Marin Barleti, deri te Naim Frashëri (1845-1900), pra, nga shekulli XVI deri në dhjetë vjeteshin e fundit të shekullit XIX, kur botohet libri i tij *Istori e Skënderbeut* (1898) na paraqitet një periudhë shumë e gjatë historike, më shumë se treqind vjeçare. Skënderbeu përmendet vetëm jashtë vendit të shqiptarëve, ndërkaq në vendin e tyre pason një heshtje shumë e gjatë. Përgjithësisht janë të ditura arsyet historike të kësaj heshtjeje, sepse shqiptarët përzundimisht kishin rënë nën sundimin osman dhe lidhjet kulturore me Evropën Perëndimore, pothuajse, për pesë shekuj ishin ndërprerë krejtësisht. Kjo nuk do të thotë se kujtesa për të nga shqiptarët u harrua krejtësisht.

Shekulli XIX, si për të gjithë popujt e Evropës, ashtu edhe për shqiptarët paraqet periudhën e vetëdijesimit e të ndërgjegjësimit kombëtar. Në këtë drejtim edhe shqiptarët nuk prapambesin, por janë bashkëkohanikë me të gjithë popujt e saj, sidomos me ata të cilët në shekullin XVIII ishte paraqitur një periudhë e spostimit nga ngjarjet kryesore kulturore e letrare evropiane të kohës. Pra, është koha e ngritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe e ridaljes së shqiptarëve në skenën ndërkombëtare.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, Skënderbeu dhe qëndresa shqiptare e shekullit XV bëhen epiqendra e krenarisë kombëtare dhe e madhërimit të së kaluarës, tanimë rreth 400 vjet të

botua në Lisbonë më 1567; *spanjisht* nga Ochoa Joan de Saldes përjetoi katër botime në: Sevilë (1582), Lisbonë (1588), në Madrid (1592 e 1597): Prifti 1964: 10.

⁵ Martin Bielski, *Kronika tho jest historia świata*, Kraków, 1964. Mbi Skënderbeun flet në një kapitull të veçantë të titulluar: "O Skanderbegu Makedoni Albanskim Ksiażeciu": Kostallari 1969: 375.

⁶ Jac de Lavardin, *Histoire de Georges Castriot, surnommé Scanderbeg, Roy d'Albanie*, Paris 1576: Kostallari 1969: 375.

⁷ Androkli Kostallari, Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike I, Tiranë, 12-18 janar 1968*, Tiranë 1969: 371-394.

tërhequr në letargji. Nuk ekziston asnjë krijues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që, në veprat e tij të mos i kthehet kësaj teme e të mos shkruajë ndonjë vepër. Në këtë periudhë janë shkruar vjersha lirike, me patos të theksuar patetik kombëtar; shkruhen tregime e novela; nisin të shkruhen romanet e tekstet e para dramatike, si dhe poema të gjata lirike e epike të gjitha të shkruara në gjuhën shqipe.

Arbëreshët e Italisë janë të parët që në letërsinë shqiptare kthyen sytë kah kujtesa historike. Ata, në veprat e tyre kishin përqa-fuar idetë iluministe e romantike të shekujve XVIII e XIX, sidomos të këtij të fundit dhe në frymën e tij nuk u ndalën të përshkruajnë një botë të imagjinuar e ekzotike, siç vepronin një pjesë e mirë e romantikëve evropianë. Këtë “ekzotikë” ata e gjetën në të kaluarën e lavdishme historike të shqiptarëve. Jeronim De Rada (1814-1903) e Françisk Anton Santori (1819-1884), Gavril Dara i Ri (1826 – 1885) e Zef Skiroi, në veprat e tyre madhëruan këtë pjesë të historisë së shqiptarëve dhe, përmes saj ndihmuan në rritjen e ndërgjegjes kombëtare, jo vetëm të arbëreshëve të Italisë, por të gjithë shqiptarëve. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se Jeronim De Rada, në poemën e tij *Skënderbeu i pafan*⁸ (1887, në të cilën punoi një gjysmë shekulli), meqë jetonte në Itali, përkrah mbitheksimit të karakterit kombëtar ruajti e trasoi edhe karakterin universal të figurës së Skënderbeut.

1.3 Skënderbeu krenaria kombëtare

Përkundër Barletit e De Radës, Naim Frashëri, në fund të shekullit XIX, në kohën e lulëzimit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare iu rrek kësaj teme dhe figurës së Skënderbeut. Kësaj here në kontekst të ndërgjegjësimit e të ngritjes së krenarisë e të vetëdijes kombëtare.

Vepra ka 22 këngë me mbi 10 mijë vargje tetërrokëshe. Ndërtimi ndjek rrjedhën kohore të ngjarjeve. Zgjimi kombëtar është në krahasimin që ballafaqonte Naimi: Shqipëria, në kohën e Skënderbeut qëndroi si një kështjellë e lirë dhe e pathyeshme, ndërkaq në kohën e tij ishte e robëruar.

Naim Frashëri me *Historinë e Skënderbeut* (1898), në pajtim me konceptet iluministe e romantike, kërkonte në të kaluarën një 'epokë të artë' të historisë kombëtare. Vepra e tij i kundërvihet gjendjes së robëruar të Shqipërisë dhe shërbente për bashkatdhetarët, jo vetëm për të zgjuar ndërgjegjen dhe krenarinë

⁸ Jeronim De Rada, *Vepra letre VI. Skanderbeku I pafaan/Scanderbeg sventurato*. Botim kritik dhe përkthim italisht përgjitur nga Vincenzo Belmonte. Tiranë, 2014.

kombëtare, por edhe si një ideal për të tashmen e të ardhmen, ashtu si bënë humanistët me antikitetin, si bëri Barleti me Skënderbeun.

Naimi ka meritën se me qartësi të madhe ka zbuluar rrënjët e qëndresës shqiptare, që e ka mbështetur në tre faktorë: (a) bashkimin; (b) udhëheqjen besnike, të zgjuar e të guximshme; dhe (c) trimërinë e pashoqe. Ato përdoren herë për të nxitur sedrën e bashkëkohësve, herë për të shprehur besimin në forcat kombëtare e në të ardhmen e atdheut.

Historia e Skënderbeut e Naimit, kështu mbeti një nga veprat më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare që i ruan përherë vlerat poetike dhe edukative patriotike. Është një kushtrim i fortë për t'i rrëmbyer armët për çlirim kombëtar. Skënderbeu është personifikim i idealit të bukurisë e të madhështisë njerëzore. Në figurën e tij mishërohet atdhedashuria, pasuria shpirtërore e fuqia fizike, urtësia e trimëria, dituria e mirësia, karakteri popullor e virtytet e larta njerëzore. Me një fjalë, në figurën e tij harmonizoheshin parimet iluministe të kohës, të cilat përmbliidhen në aksiomën humaniste: *në trup të shëndoshë edhe shpirti është i shëndoshë*, ose thënë me fjalorin e sotëm të globalizmit: *fuqia e muskujve duhet të jetë në harmoni me fuqinë e mendjes*.

Në këto cilësi janë shkrirë idealet e Humanizmit e të Rilindjes Evropiane me konceptet e antikitetit dhe të dyja së bashku me pikëpamjet iluministe e racionaliste të shekujve XVIII-XIX mbi heronjtë e udhëheqësit. Shumë prej këtyre vetive Naimi i gjente në epokën e Skënderbeut dhe në personin e heroit të tij të adhuruar, ndërsa shumë të tjera duke u mbështetur te Barleti ia atribuon asaj kohe.

3. Përfundim

Marin Barleti, me veprën *Historia e Skënderbeut* (1510), si përfaqësues i Humanizmit të shekujve XIV – XVI e bëri të famshëm në gjithë Evropën; ndërkaq, Naim Frashëri, si iluminist e ideolog i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, me poemën epike *Istori e Skënderbeut* (1898) u bë poeti më i madh kombëtar.

Marin Barleti veprën e tij e shkroi në latinisht, në gjuhën dhe në frymën universale të kohës; ndërkaq Naim Frashëri poemën e tij e shkroi në një gjuhë lokale, në gjuhën shqipe, në gjuhën kombëtare të heroit dhe në frymën iluministe romantike të shekujve XVIII – XIX.

Kështu, me veprat e tyre Marin Barleti ndihmoi të ngrihet aureola universale e Skënderbeut, ndërkaq Naim Frashëri ndihmoi të rritet krenaria, sedra e vetëdija kombëtare e shqiptarëve.

Bibliografi

- BARLETI, Marin (1964), *Historia e Skënderbeut*. Përkthyer nga Stefan J. Prifti. Tiranë.
- BLANCHUM, Franciscum (1636, 1957), *Georgius Castriotes Epirensis, vulgo Scandebeg, Venetii, 1636. Skënderbeu, apologji*. Përkthyer Stefan I. Prifti, Tiranë.
- FRANGU, Dhimitër (2005), *Historia e Gjergj Kastiotit Skanderbeut*. Shkruar nga Dhimitër Frangu, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i heroit legjendar. Përktheu nga italishtja e vjetër Lek Previzi, Arbëria, Tiranë.
- FRASHËRI, Kristo (2002), *Skënderbeu - jeta dhe vepra*. Shtëpia Botuese "Toena". Tiranë.
- FRASHËRI, Naim H. (1967), *Vepra. Vëll. II. Histori e Skënderbeut*, Tiranë.
- JENSEN, Minna Skafte (2016), *Një rrëfenjë heroike: Skënderbeu i Marin Barletit midis krijimtarisë gojore dhe letërsisë*, E-mail address: webmaster@migesia.dk (25.II.2016).
- KOSTALLARI, Androklli (red. përgjegj.) (1969), *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike I, II, III*, Tiranë, 12-18 janar 1968, Tiranë.
- PRIFTI, Stefan I. (1964), *Hyje: Historia e Skënderbeut*. Përkthyer nga Stefan I. Prifti, Tiranë.
- XHIKU, Ali (1980), *Romantizmi arbëresh*, ShB "Naim Frashëri", Tiranë.
- XHOLI, Zija (2003), *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

ANAS

Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 811.18'28
Punim studimor**KRISTAQ JORGO**

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

E-mail: kristjorgo@yahoo.com

**STATUSI DHE FUNKSIONI I DIALEKTEVE
NË EVOLUCIONIN E SISTEMIN LETRAR SHQIPTAR
STATUS AND FUNCTION OF DIALECTS
IN THE EVOLUTION OF THE ALBANIAN LITTERARY
SYSTEM**

Përmbledhja

Artikulli merr përsipër të hetojë vijat qendrore të raporteve të letërsisë shqipe me dialektet në të gjithë shtrirjen diakronike të sistemit letrar shqiptar. Për të bërë të mundur një ndriçim të tillë kuadër: a. realizohen në krye të herës një varg përcaktimesh, qartësimesh e kufizimesh terminologjike; b. dukuria vendoset në rrjetën e gjerë të përbërësve /veprimtarive të sistemit letrar e të atij kulturor si dhe të marrëdhënieve komplekse ndërmjet tyre; c. analizohen me përqendrim të veçantë kushtëzimet e zgjedhjes si dhe funksionet e elementit dialektor; d. arsyetohet 'dialektika' e kushtëzimeve, e zgjedhjeve dhe e funksioneve në evolucionin e sistemit ; e. mbahen parasysh dinamikat mes synimit e realizimit si dhe qëndrimi ndaj dukurive letrare të së kaluarës në vështrim të idiomës dialektore të tyre. Në mbyllje përvijohen arsyet e domosdoshmërisë që gegërishtja letrare, toskërishtja letrare e

arbërishtja letrare të bëhen pjesë e programeve të shkollës shqipe në të gjitha nivelet.

Fjalë kyç: letërsi shqipe, gjuhë, dialekte, dialektalizmi në letërsi, letërsi dialektore

Abstract

The purpose of this article is to investigate the central lines of Albanian literature relationships with dialects throughout the diachronic axis of the Albanian literary system. In order to enable such a framework illumination we should consider: a. A series of definitions, clarifications and terminological limitations ; b. The phenomenon is placed in a wide network of components / activities of the literary and cultural system as well as the complex relations between them; c. The selection conditions and the functions of the dialectal element are analyzed with special focus; d. The "dialectics" of conditioning, election, and functions in the evolution of the system are explained as well e. The dynamics between the goal , realization and attitude towards the literary phenomena of the past in view of their dialectical idiom. At the end we enlighten the necessary reasons for literary *geg*h dialect, literary *tosk* dialect, and literary *arbwresh* dialect to be included in the Albanian school programs at all levels.

Key words: Albanian literature, language, dialects, dialectalism in literature, dialectal literature

I.

Artikulli është konceptuar natyrshëm, për shkak të komplet-sitetit të lartë të problemit, në trajtën e një vargu tezash të vetëmskicuara.

Në pikënisje e në themel të tij qëndron bindja se ky komplet-sitet ka lidhje me modelin e veçantë e të pazakontë të letërsisë dhe të kulturës shqiptare përgjithësisht, matricën a strukturën bazë të së cilës e kemi emërtuar me termin 'pluriunitare'. Karakteri 'pluriunitar', përkundër vogëlsisë së saj, shtrirjes relativisht të kufizuar në kohë dhe aksidenteve gjithfarëshe a ndoshta edhe për shkak të tyre, i siguron letërsisë e kulturës shqip(tar)e një pasuri tipologjike të jashtëzakonshme të dukurive, duke e bërë, si të thuash, një fenomen të laboratorizueshëm për njohjen shkencore; kjo matricë

mundëson dhe formulim paradigماش teorike risore në fushë të studimit në përgjithësi të sisteme letrare e kulturore kombëtare.

Teza jonë mund të përvijohet – provokueshëm – përmbledhtas kështu: Në sistemin letrar shqiptar thuhetse *nuk ka letërsi dialektore*, thuhetse *nuk ka letërsi në dialekt*. Ajo çka e lidh a e përnjëson këtë sistem me traditën e gjithëmbarshtme është vetëm fenomeni i ‘*dialektalizmit në letërsi*’. Unicum-in shqiptar në këtë prerje do ta përcillte mirë, sipas nesh, sintagma: *letërsi jodialektore në sidialekt* apo, e thënë ndryshe, *letërsi jodialektore në sigjuhë*.

Le ta pranojmë në krye të herës se teza provokuese e lartorrmular ka më fort një karakter instrumental, shërbyes, në funksion të (ri)ndërtimit të urave – të dëmtuara e të rrënuara rëndë - për (ri)lidhjen e lexuesit të sotëm e atij të nesërm shqiptar me traditën më të mirë letrare shqipe sesa është një pasqyrë besnike e realitetit të gjërave. Por, nga ana tjetër, duke qenë në thelb e tillë, instrumentale, kjo tezë nuk do të mundet ta njëmendësonte fuqinë e saj, sikur në bërthamën e vet racionale të mos ndrynte bash një thelb të qenësishëm të atij realiteti të gjërave, e kemi fjalën për atë çka shenjon specifikën e raporteve të letërsisë shqipe me gjuhën shqipe e varietetet e saj përbërëse.

Letërsia klasike shqipe në *sidialekt* shenjoht nga një dinamizëm i katërfishtë, i cili, i kuptuar si një fuqi njëheri centrifugale e centripetale, nuk është karakteristikë e tipit të përgjithshëm të letërsisë në dialekt: *dinamizmi hapësinor (aktual)*, *dinamizmi qëllimor-identitar*, *dinamizmi kohor (perspektiv)* dhe *dinamizmi funksional (përtejletrar)*.

Letërsia shqipe në *sidialekt* i drejtohet *gjithë publikut shqiptar të bashkëkohësisë (dinamizmi hapësinor)* dhe të së ardhmes (*dinamizmi perspektiv*), tematizon lëndë (e trajtë) me frymë(zim) gjithëkombëtar (*dinamizmi qëllimor*) dhe synon të projektohet e të imponohet (në mënyrë eksplicite a jo) si bazë për gjuhën e njësuar letrare të bashkësisë shqipfolëse apo, së paku, të kontribuojë realisht për këtë (*dinamizmi funksional*).

Këto tipare e bëjnë korpusin e letërsisë shqipe në dialekt (atë të para vendosjes së standardit kryesisht) të ketë veçanti tejet specifike dhe të trajtohet në përputhje me këto veçanti. Qëndrimi ndaj këtij korpusi përbën një detyrë madhore për shkollën, kulturën dhe shkencën shqiptare.

Kompleksiteti dhe veçantësia e modelit shqiptar nga këndvështrimi i raporteve letërsi – gjuhë – dialekt e kapërcen dhe atë me të cilin do të ishte më i përafërt, është fjala për modelin italian. (Është e njohur se letërsia italiane, e vetmja ndër letërsitë e mëdha,

përfill si pjesë integrale të saj dhe korpusin e veprave të krijuara në dialekt: «l'italiana è sostanzialmente l'unica grande letteratura nazionale la cui produzione dialettale faccia visceralmente, inscindibilmente corpo col restante patrimonio» Gianfranco Contini 1984: 611) Duke parafrazuar një përcaktim të Namik Resulit, nëse në rastin italian kemi një Dante e një gjuhë në kërkim të një shteti, në rastin shqiptar kemi një shtet pa gjuhë në kërkim të një Danteje. Ajo ç'është e vërtetë, në rastin italian, në sinkroni, njëmendësohet, në rastin shqiptar, diakronikisht, në vështrimin ideal, prej momentit të normativizimit të gjuhës së përbashkët letrare. Ç'mund të thuhej për korpusin e letërsisë shqipe në dialekte: ai është, përjashtuar me modelin Italian, jo thjesht 'bashkëpunues' me pjesën tjetër të letërsisë (Crocce), as 'njëra ndër dy fytyrat e letërsisë', 'lidhur që nga fillesat me të' (Contini) madje as vetëm 'përbërëse intrinseke' të letërsisë kombëtare (De Mauro), por fondatore dhe realitet i vetëm i letërsisë shqipe për një periudhë shumë të gjatë kohe. Një ndryshim tjetër thelbësor e përbën fakti se korpusi i letërsisë në dialekt në rastin shqiptar ze qendrën dhe jo thuhetse periferinë e sistemit letrar dhe është pjesë e kanonit të përhershëm të traditës letrare kombëtare.

II.

Letërsi jo dialektore në dialekt, si një akt krejt i natyrshëm në mungesë të një alternative tjetër zgjedhëse shpesh me synimin që idiolekti vetanak të bëhet a të imponohet si bërthamë e gjuhës së njësuar a të standardit – kjo ka qenë thirrja e krijuesit letrar shqiptar të periudhës së parë, e cila nis që prej dëshmimit të hershëm të shkrimit shqip (ngushtësisht prej fillimeve të sistemit letrar kombëtar shqiptar) e deri në dekadën që lidh Kongresin e Manastirit me Komisinë Letrare të Shkodrës.

Po të kalojmë me shpejtësi në revistë të gjithë historinë e shkrimit letrar shqip prej gjenezave deri vonë në epokën moderne, do të vetëdijësohemi për një fakt në të vërtetë sa të rëndomtë aq dhe të pazakonshëm: Çdonjëri prej krijuesve të letërsisë shqipe, i denjë për këtë emër ka gjithmonë vetëdijën se po krijon për mbarë gjindjen shqiptare në gjuhën e përbashkët shqip krejt pavarësisht, vetëdijes ku më të dobët e ku më të plotë, por asnjëherë munguese se idiolekti i vet lëviz kryesisht në orbitën e një dialekti, regjiolekti a topolekti të caktuar.

Evolucionin e sistemit letrar shqiptar nga pikëvështrimi i idiomës e shënjon në krye të herës prirja maksimalisht larguese pastaj prirja gjithnjë e më fort afruese e varianteve/varieteteve më saktë e idiolekteve letrare kryesisht për nga tiparet e tyre fonologjike

e ortografike, por edhe nga ato morfo-sintaksore e leksikore. Në periudhën e lindjes e të ngjizjes së sistemit letrar kombëtar shqiptar, proces i nistuar nga Jeronim de Rada dhe i cili mbulon gjithë shekullin XIX, gjuha e veprave letrare shfaq maksimumin e veçantësive dialektore/të folmeve gjegjëse si dhe po ashtu maksimumin e ndihmesës vetjake autoriale.

Kompetenca gjuhësore e krijuesit shqiptar prej fillimeve të Rilindjes ka përfshirë si normë të gjithë repertorin verbal të bashkësisë gjuhësore shqipe, në kuptimin e njohjes së varieteteve regjionale apo më saktë të idiolekteve të autorëve bashkëkohës dhe atyre të traditës. Nga ana tjetër thirrja gjithëkombëtare e krijuesit shqiptar në të tëra periudhat si dhe bashkëprania thujse në të gjitha organet themelore të periodikut shqip e teksteve letrare më nënshtresë dialekte, regjiolekte e topolekte të ndryshme ka mundësuar zgjerimin e kompetencës gjuhësore të publikut duke e lehtësuar në njëfarë mase komunikimin e këtyre teksteve në mbarë hapësirën gjuhësore shqipe.

Periudhën e dytë – prej viteve '10 e deri në fillim të viteve '50 të shekullit XX (kur pak a shumë u kristalizua kahja që do të merrte procesi i përcaktimit e formësimit të varietetit standard të shqipes) – e shënjon përpjekja kryesisht e vetëdijshme, ku më e fort e ku më e dobët nga ana e shkrimtarëve, për zbehjen e dallesave ekstreme në tekstet letrare të proveniencave dialektore të ndryshme.

Një variant letrar i ndërmjetëm si gjuhë e shtetit dhe e shkollës shkoi paralelisht me zbehjen e tipareve të theksuara të dy kryedialekteve në tekstet letrare. (Zotërimi i letrarishtes së mesme, i detyruar nga shkolla në periudhën midis dy Luftërave, e bënte më të afërt për publikun tosk korpusin e teksteve letrare geqe dhe anasjelltas.)

Në këtë fazë të një kontinuumi dialektor letrar në fushë të letërsisë kemi shfaqjen e dukurisë së përkundërt, atë të ngritjes në trajtën e nëndialektit apo të së folmes/varianteve/varieteteve letrare të arealeve gjuhësore thujse pa asnjë përfaqësim deri më atëherë në korpusin e përgjithshëm të letërsisë shqipe. Është fjala, sa për të sjellë dy shembuj, për vëllimet me rrëfenja të Musine Kokalarit apo për tekstet humoristike në të folmen e Tiranës të Liut të Cakes (alias Mustafa Greblleshi).

Periudha e tretë kapi apogjeun në segmentin prej Kongresit të Drejtshkrimit deri në kapërcyell të viteve '90, kur standardi, tashmë i sanksionuar e tejkapërcen së tepërmi rrezën e veprimit të vet, duke u shtrirë thujse pa mbetje, në gjithë praktikën e shkrimit shqip e duke përjashtuar kështu botimin e teksteve letrare në dialekt, çka natyrshëm solli asfiksimin e traditës krijuese në idiomat lokale dhe u

bashkëshoqërua me 'modernizimin' (lexo: redaktimin përshtatës kah standardi) të asaj pjese të traditës letrare dialektore që i shpëtoi 'dënimet kapital'.

Letërsia në dialekt apo letërsia me tipare të dialektit priret të mbijetojë edhe pas formësimit të standardit në dy tipe arealesh gjeografikë- gjuhësorë-letrarë: a. në arealet me traditë letrare të gjatë, te të cilët, veç kësaj, bën jetë fenomeni i diglosisë brendagjuhësore, i ushqyer, pos tjerash, edhe prej diferencave të theksuara, në strukturën fonologjike kryesisht, midis regjiolektit, të folmes a topolektit dhe standardit (rasti i arealit shkodran); b. në arealet, po ashtu me traditë letrare të gjatë, të cilët jetojnë situatën e diglosisë ndër-gjuhësore gjegjësisht mungesën thuajse të plotë të asaj brendagjuhësore (rasti i arealit arbëresh); c. në areale ishullorë, autorët e të cilëve krijojnë në dialekt, për shkak të ruajtjes a vijimit të traditës, por edhe si shfaqje e rezistencës ndaj regjimit politik në atdheun e origjinës (rasti i krijuesve të diasporës)

Në areale të tjerë, te të cilët gjallon fenomeni i dilalisë, pra përdorimi i varietetit të lartë apo të standardit qoftë në situatat formale, qoftë në ato joformale dhe i varietetit të ulët krahas të parit ekskluzivisht vetëm në ambientin familjar, shfaqja e dukurive letrare në dialekt do të ishte një përjashtim. I tillë është deri më tash së paku edhe në areale me diglosi brendagjuhësore, por të cilët nuk gëzojnë një traditë letrare vetanake të fuqishme a të gjatë (rasti i arealit kosovar).

Periudha e katërt e pasfillimviteve '90, ajo në të cilën jetojmë, në kushtet kontradiktore të rifutjes në qarkullimin masiv letrar e në qendrën e kanonit letrar shqip të një korpusi të madh tekstesh në dialekt, të vështirësisë, për të mos thënë të paaftësisë, për t'i lexuar, kuptuar e shijuar ato – shkaku i mungesës së kompetencës gjuhësore – në veshjen e tyre autoriale, si dhe në kushtet e bulëzimit të drojtur të krijimtarisë në dialekte – të drojtur jo vetëm si rrjedhojë e ndërprerjes disadekadëshe të traditës – shto këtu dhe rihapjen e debatit mbi bazën dialektore të standardit, mbi krijimin e një shqipeje të dytë standard etj. – kjo periudhë e fundit pra, *sa i takon objektit të diskutimit tonë*, mund të cilësohet pa drojë si 'traumatike' dhe e paqartë.

Nëse shtyja/prirja për një kompetencë gjithëgjuhësore apo gjuhësore sa më gjithëpërfshirëse, në mungesë të standardit, ka qenë e pashmangshme, e detyrueshme dhe e natyrshme, jo vështirësisht e arritshme, me themelimin e varietetit standard dhe me shndërrimin e tij idiomën e korpusit zotërues të krijimit letrar shqip ajo nis e bëhet e tepërt, fakultative dhe, në një kuptim, artificiale e një barrë e vërtetë.

Në periudhën e parë e të dytë forcat që synojnë krijimin vetëdijes së bashkësisë etnike janë të fuqishme, çka ushqen domosdonë e receptimit të artefakteve letrare që vijnë prej arealesh të ndryshëm dialektorë. Me ngjizjen e kësaj vetëdijeje e për të tjera arsye, në periudhën e tretë e të katërt, ato forca e zbehin fuqinë e tyre e njëherazi me të zbehet dhe pesha e artefakteve të traditës letrare, aq më pak të domosdoshme këto në veshjen e tyre gjuhësore autentike. Ndërhyrja në këtë veshje, vështirë e konceptueshme e kundërfunksionale në dy periudhat e para, ndihet a përjetohet tani, për më shumë se një arsye, si nevojë, madje e përligjur kjo përmes elementeve të instrumentit unifikues e të arritshëm për të gjithë, standardit.

III.

Prej viteve '30 e veçanërisht pas formësimit të standardit, elita akademike, shkolla dhe editoria u përballen me problemin jo të vogël të kapërcimit të vështirësisë të receptimit të letërsisë në dialekt, i rënduar ky problem sidomos në kushtet kur politika shtetërore e pas 44-ës ndikoi që standardi t'i kapërcejë së tepërmi sferat e tij legjitime të përdorimit, shtu këtu dhe kufizimin apo përjashtimin prej komunikimit letrar të një numri të madh krijuesish në dialektin geg.

Zgjidhjet e këtij problemi kanë qenë disa, asnjëra prej të cilave megjithatë e plotkënaqshme. Ruajta maksimalisht besnike e vullnetit autorial të shoqëruar me aparat shpjegues; modernizimi ortografik dhe ai i pikësimit për të përfunduar me përshtatjet ku më të lehta e ku më rrënjësore, të cilat kanë krijuar, vetëkuptohet tekste në të vërtetë të rinj.

Në fillimvitet '40 Lasgush Poradeci, propozonte një zgjidhje që tingëllon më së paku e çuditshme, po të mbajmë parasysh profilin e tij të lartë si filolog. "Gjuha ndryshon pas 500 vjet. Është ligji i saj fiziologjik dhe shpirtëror. Kryeveprat letrare, duke qenë të përsosura, të derdhura si në mermer, pas mbarimit të kohës sa qëndron gjuha e tyre (p.sh. 500 vjet) ato mund të ripunohen në themel të formës, të derdhjes së parë, pa ç'formuar derdhjen e parë." (Poradeci 2009: 5).

Ngjan si e pavend kjo ide e Poradecit sjellë këtu. Së pari, për shkak se nuk bëjmë fjalë për distanca kaq të mëdha kohe; së dyti, pse ajo çka parakupton poeti me 'ripunim' a nuk është shkurt e thjesht 'përshtatja', operacion të cilit, kur me njëfarë sukcesi e fort e më shpesh me një dështim shfytyrues i janë nënshtruar një pjesë e mirë e teksteve letrare shqipe të traditës, kryesisht të arealit gjuhësor arbëresh, por dhe të atij geg. Në të vërtetë, distancat kohore për të

cilat diskutohet janë dy a tri herë më të shkurtra se gjysmë-mijëvjeçari i Poradecit (dekadat që na ndajnë p.sh. nga kohëkrijimi i veprave të De Radës a Fishtës), por a nuk 'ka ndryshuar' sa për 500 e më shumë vjet 'gjuha e sotme' (standardi) prej idiolektit deradian apo atij fishtian? Nga ana tjetër, Lagushi, poet e filolog, flet për ripunim, 'pa ç'formuar derdhjen e parë' 'si në mermer' të kryeveprave letrare, 'të përsosura' këto, pa dyshim, në formë.

Por a mund të kemi 'ripunim' të veshjes gjuhësore pa e cenuar veshjen gjuhësore, themelin e strukturës formale të krijimit letrar (poetik) të përkryer?! Një projekt yni në proces, të cilin e kemi emërtuar 'teori e kuantifikimit harmonik të tekstit' mëton t'i japë një përgjigje pozitive kësaj pyetjeje duke zbuluar më shumë se një *vullnet të tekstit* përkundër *vullnetit* unik e të patjetërsueshëm të *autorit* të tij. Por, edhe në u dëshmoftë i suksesshëm, ky projekt e le gjithnjë të hapur e të domosdoshme për realizim detyrën e njohjes së monumenteve të letërsisë kombëtare në veshjen e tyre plotësisht autentike.

IV.

Ndriçimi i situatës nga kjo perspektivë mund të ndihmojë për të hedhur një dritë të re mbi debatin e hershëm dhe asnjëherë të përmbyllur mbi gjuhën – po e formulojmë me vetëdije kështu përgjithshëm – në hapësirën kulturore dhe akademike shqiptare. Këndvështrim i ri paqtues e pajtues pse horizontzgjeres, pa synuar shembjen, përkundrazi duke u përpjekur të mirëmbajë e gjallërojë ura tashmë të ngritura e të sprovuara – e kemi fjalën për standardin – do të parakuptonte një ndryshim radikal paradigmatic në sjelljen ndaj trashëgimisë letrare shqipe. Kjo sjellje parashih projektimin e zbatimin e një edukimi, i cili t'i mundësojë individit shqiptar një kompetencë gjuhësore-letrare të tillë përmes së cilës ai të jetë i aftë e gjithaq së brendshmi i motivuar të mbajë një ekuidistancë, po duke me thanë, në të vërtetë, të dëshmojë një ekuiempati ndaj traditës e bashkëkohësisë letrare të të gjitha shprehjeve gjuhësore shqip. Ky synim kaq radikal mund të njëmendësohej vetëm nëse përpjekja do të shkonte fort përtej edhe asaj që sugjeronte në 1992-in Rolf Këderiçi: **"Zgjidhja e problemit mund të jetë vetëm diglosia e shkaktuar me vetëdashje. Në shkolla duhet të mësohet si deri tani gjuha letrare, megjithatë, në mësimin e letërsisë duhet të ketë më shumë literaturë në dialekte nga më të ndryshmet. Asnjë nxënës nuk duhet të diskriminohet, vetëm sepse ai flet dialekt, ai duhet të futet në gjuhën e shkruar nga mësuesit e pajisur me dije pedagogjike dhe gjuhësore, për të cilët është e**

qartë që dialekti është vetëm një variant i të njëjtit diasistem gjuhësor.” (Rolf Këderiç (Ködderitzsch) 2002: 46).

Si mund të realizohet kjo? Dialektet letrare të shqipes – gegërishtja letrare, toskërishtja letrare e arbërishtja letrare të bëhen pjesë e programeve të shkollës shqipe. Jo thjesht në trajtën e informacioneve të shpërndara në kapituj të teksteve të gjuhës e të letërsisë, por si lëndë më vete. ‘Dialektet letrare të shqipes’ – po e titullojmë kështu - duhet të jetë një lëndë më vete që në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare, e përthelluar kjo lëndë në gjimnaz e në tipet e tjerë të shkollave të arsimit të mesëm, për t’u ngritur në nivel akademik dhe ndarë në tri kurse të veçanta në programet universitare të drejtimit filologjik.

Rrjedhojat pozitive të një politike arsimore të tillë do të ishin të disafishta e largvajtëse:

a. Do t’i vihej fre gradualisht e gjithnjë e më fort largimit të lexuesit të sotëm e atij të nesërm prej një pjese të rëndësishme të korpusit të traditës letrare në sidialekte, njohja e së cilës në rastin shqiptar është, siç me të drejtë nënvizohet në mënyrë të përsëritur e plot shqetësim, jetike: “Në kulturat e mëdha mënjanimi i një apo disa kryeveprave është çështje inventari, por në kultura të vogla e të varfra, si kjo e jona, bëhet çështje jetike, ruan ose dëmton drejtpeshimin e tërë ngrehinës. Është e vërtetë drithëruese të thuash se disa nga majat e letërsisë sonë po i ikin thekshëm leximit dhe ndërveprimit me auditorin e sotëm. Lirika dhe sidomos epika e Fishtës është bërë thujse arkaike për një shumicë të rinjsh, që njohin vetëm standardin.” (Çapajev Gjokutaj 2016: 8)

b. përmes njohjes së thelluar në veshjen e vet autentike të traditës më të mirë letrare shqipe në sidialekte, do të rritej dashuria për të, do të rafinohej shija estetike e publikut, ashtu siç do të ngrihej në një nivel më të lartë njohja e historisë dhe e traditave kombëtare, ruajtëse e kujtesës dhe shpalosëse e përzgjedhur e të cilave është pikërisht letërsia e madhe.

c. Jo vetëm njohja e thelluar e letërsisë së traditës, por dhe krijimtaria letrare në sidialekte e receptimi i saj do të ktheheshin nga një dukuri përjashtimore në një dukuri normale e të mirëseardhur.

d. Do të zgjerohej në mënyrë të natyrshme kompetenca gjuhësore e nxënësit e qytetarit të ardhshëm shqiptar, përveçse në standard, me veçoritë në të gjitha nivelet të mbarë varieteteve letrare të shqipes si dhe me pasurinë leksikore e frazeologjike të tyre.

e. Kohezioni i botës shqiptare do të forcohej bindshëm, shí duke i mundësuar bartësit të një varieteti dialektor a nëndialektor të përdorë në nivelet joformale të komunikimit njohuritë / kompe-

tencat në varietetet dialektore a nëndialektore të tjera me sivëllezërit e vet, bartës të këtyre të fundit.

f. Gjuha e tjetrit është bota e tjetrit, botëvështrimi i tij, ndjeshmëria e tij. Fitimi i kompetencave në varietetet dialektore të shqipes, i ndërmjetësuar/mundësuar ky prej studimit të dialekteve letrare në shkollë, do të zgjeronte njohjen më të mirë prej gjithkujt të universit pluriunitar shqiptar.

g. Kalimi prej dialektofobisë në dialektofili do të mund të ishte një nga rrugët e pasurimit të gjuhës letrare: “Përveç kësaj dialektofobia duhet marrë edhe në një aspekt tjetër, në kuptimin që përdorimi i variantit letrar të dialektit nuk e rrezikon gjuhën letrar kombëtare të njësuar. Madje duke qenë se asnjëri nga dialektet nuk i ka shterur mundësitë e tij shprehëse, nuk e ka vënë në qarkullim të gjithë pasurinë leksikore, frazeologjike dhe ndërtimet sintaksore, ndoshta lëvrimi me shkrim i dialekteve në sfera e funksione të caktuara do ta pasuronte edhe vetë gjuhën letrare si përrenj që derdhen në një lumë të përbashkët.” (Seit Mansaku 2002: 420).

h. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja: politika e re gjuhësore-arsimore që propozojmë e rrjedhojat që do të vinin soje do ta sillnin, më saktë, *do ta mbledhnin* në hullinë e ngushtë, por të thellë të diskutimit thjesht e vetëm akademik debatin çekuilibruet e të hipersforcuar mbi standardin, i cili në mënyrë periodike aktivizohet në hapësirën publike (kulturore, parashkencore e atë shkencore) shqiptare prej 1972-shit, sidomos prej fillimviteve '90 të shekullit të kaluar. I gjithë ky debat (po e thjeshtëzojmë në skaj idenë për hir të arsytimit) është rrjedhojë e një ‘gabimi’ origjinar (për shumë arsye e rrethana, me gjasë, të pashmangshëm, por që duhet tash me urgjencë të shlyhet): politikat gjuhësore-arsimore e gjuhësore-letrare që shoqëruan në vite e dekada zgjidhjen e problemit gjuhësor shpërfillën thelbin *sui generis*, pluriunitar, kryesisht të polisistemit të letërsisë shqipe (në vështrim të varieteteve të përdorura), ashtu si të kulturës e të botës shqiptare në përgjithësi. Ky thelb i shpërfillur, i cili tash natyrshëm hakmerret, lyp që institucionalisht të çbëhet e të kryhet çka po institucionalisht është keqbërë a nuk është kryer fare.

Utopike mund të duket kjo ide për nga mundësia e realizimit, e dëshiruar ndoshta-ndoshta, por aspak e domosdoshme si dhe me sakrifica të larta në raport me fitimin që soje do të vinte. Por, drama e botës shqiptare - ndarja e konflikti endemik - i cili e ka çuar në mënyrë ciklike individin e kolektivitetin shqiptar në padashurinë, në shpërfilljen, në braktisjen, jo fort rrallë dhe në shkatërrimin e Atdheut të vet fizik, ku tjetër mund ta ketë burimin më të thellë përveç se te mosnjohja, padashuria e shpërfillja që qenia shqiptare

(individuale e kolektive) i bën Atdheut të vet shpirtëror, themel e kryevatër e së cilës është gjuha shqipe?

Sakrifica, e këtu përfundojmë, s'është ndërkaq asgjë para fitimit që e ndjek: është, me një sintagmë të liturgjisë së krishterë, rënia e baltës së syrit, baltë që na pengon të nistohemi me dijen e shpirtit, të shohim në plotërinë e vet e ta banojmë duke u rritur në plotërinë tonë shtëpinë e qenies shqiptare në gjithë shtrirjen e vet në kohë e hapësirë si dhe bukuritë e artefakteve që atë e jetësojnë: gjuhët/gjuhën shqipe, të shumta e një – shqipen pluriunitare dhe monumentet letrare shqip.

BIBLIOGRAFIA

- Gian Luigi Beccaria (a cura di), *Letteratura e dialetto*, Zanichelli, Bologna, 1975.
- Gianfranco Contini, (1984²), *Varianti e altra linguistica. Una raccolta di saggi (1938-1968)*, Torino, Einaudi (1^a ed. 1970).
- Jorgo Buló etj. (Red.), AA.NN., *Konferenca Shkencore : Shqipja Standarde dhe Shoqëria shqiptare sot*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë, 11-12 nëntor 2002), Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 2003.
- Emil Lafe, *Shqipja standard në vështrim strukturor dhe funksional*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 11-22.
- Idriz Ajeti, *Shqipja standard dhe shoqëria kosovare sot*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 23-29
- Shaban Demiraj, *Rreth dis çështjeve thelbësore të shqipes standard*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f.30-35.
- Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit 30 tridhjetë vjet pas*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 36-41.
- Leonardo M. Savoia, *Aspekte ideologjike të nacionalizmit gjuhësor*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 42-55.
- Rexhep Ismajli, *Rreth shqipes standard, kodeve të tjera dhe kontestimeve*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 56-86.
- Xhevat lloshi, *Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 87-97
- Francesko Altimari, *Heteroglosia arbëreshe: të folmet dhe shqipja standard*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 98-121
- Fadil Raka, *Gjuha standard shqipe dhe mjetet e kodifikimit të saj*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 122-130
- Rami Memushaj, *Planifikimi i satusit të shqipes standard*, në: Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 131-136.
- Matteo Mandala, *Gjuha letrare shqipe dhe dialektet arbëreshe të Sicilisë*, në: f. Jorgo Buló etj. (Red), 2003, f. 142 - 146

- Emil Lafe etj. (përgatitur për botim nga), AA.NN., Konferenca shkencore: “*Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*” (Tiranë, 20-21 nëntor 1992), Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia botuese “Shkenca”, Tiranë, 2002
- Rolf Këderiç (Ködderitzsch), *Ligjëratë për një gjuhë letrare kombëtare shqipe*, në: Emil Lafe etj. (përgatitur për botim nga), 2002, f. 42-49.
- Seit Mansaku, *Diskutim*, në: Emil Lafe etj. (përgatitur për botim nga), 2002: f.419-424. Çapajev Gjokutaj, *Thesaret e letërsisë, në jetë apo në kamare?* në: “Panorama”, 3. 07. 2016, f.8,
<http://www.panorama.com.al/>
- Lasgush Poradeci, *Vepra I. Poezia*, Shtëpia Botuese albPAPER, Tiranë, 2009, f.5.



Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 811.18:004.912

Punim studimor

NEXHIP MËRKURI

Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë

KOMPETENCA DIGJITALE DHE RITJA E TË NXËNIT PËR GJUHËN SHQIPE

Përmbledhje

Gjuhëtari me përvojë disa vjeçare ka ndërtuar aplikacionin e parë për gjuhën shqipe për rritjen e të nxënit. Afron realizimin e kompetencës digjitale dhe aftësinë për përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në orët e mësimit dhe gjatë kohës së lirë. Mjeti didaktik i ndërtuar për programin tërësor për një vit shkollimi për rritjen e njohurive të qëndrueshme. Ngërthen testet me disa zgjedhje, *për gjithë vitin shkollor, 35 javë mësimi*, të cilat janë për të gjitha orët e gjuhës shqipe *2,3...: të flasim, të shkruajmë, njohuri për gjuhën, drejtshkrim*. Janë mjetete/instrumentete didaktike për portofolin shkollor dhe kombëtar të vlerësimit. Duke kapërcyer vështirësitë e aplikacionit dhe të moshës së nxënësve përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, miniteste, diskutimet për orët: *të flasim, veprimtarinë e nxënësit në klasë, projekte, portofolin dhe performancën e nxënësit*. Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësimdhënies/nxënies. Mësuesi, nxënësi duke zotëruar kompetencat e përcaktuara në dokumentet zyrtare të

UNESCO-s për teknologjinë në arsim, moduli 4 në konferencën e UNESCO-s, rrit treguesit e të nxënësve. Është një mundësi që edhe gjuha shqipe të ketë një mjet bashkëkohor si edhe gjuhët e tjera të Europës për rritjen e të nxënësve. Pajisjet si tabletë, ajpedë (iPad), celularët android dhe iOS janë veçanërisht të dobishme për nxënësit e ciklit fillor gjatë 35 javëve të vitit shkollor, duke stimuluar dhe rritur kështu aftësinë e të folurit e të shkruarit, kompetencën gjuhësore. Është efektive kur pajisjet përdoren me synime të qarta didaktike edhe për shkollat shqiptare. Vendosja e përgjigjes për temën e re gjuhësore shërben si rimarrje e informacionit edhe jashtë orës së mësimi, duke e rihapur debatin për temën gjuhësore dhe motivim për realizim tërësor. Janë kontribut në fushën e neurolingustikës.

Abstract

Many years experienced linguist has built the first application of Albanian language for learning increasement. It approaches the implementation of a digital competence, critic, and effective skills of TIK usage along the class hours and free time. This didactic tool is instructed for the whole scholar program for an year, for raising the permanent and stable knowledges. It includes tests with some alternatives for this scholar year: *35 tuition weeks, which are for all the Albanian language classes: Albanian language 2, 3, 4... speaking, writing, linguistic knowledge and spelling.* There are some didactic tools/instruments for scholar and national assessment portfolios. By transcending difficulties of the application, as well as the age of pupils, there are included many alternatived questions, minitests, discusses around the lessons: speaking, classroom activities of pupil, projects, portfolio and performance of each pupil. This assessment tools provide informations on what pupil knows, and what can they be able to execute as a result of teaching and learning activity. The teacher and pupil, by possessing the defined competences in official documents of UNESCO for the technology in teaching, fourth module in the conference of UNESCO, raises the indexes of learning. It is a good opportunity for Albanian language to have a contemporary tool like other European

countries for learning increasement. Devices like tablet, iPad, android devices and iOS are very useful, especially for primary classes along the 35 scholar weeks, by stimulating and raising the learning and writing skills and for linguistic competences. It is effective when these devices are used with clear didactic objectives fir Albanian schools too. The placement of the linguistic topic is a second regain of the informations taken in class even outside the class, by reopening a debate for the linguistic topic and giving a motivation for a complete realisation. It is a contribution in the neurolinguistic field too.

Hyrje

Projekti “*Smart education*” u zbatua si fillim në pak vende me teknologji të lartë zhvillimi nga UNESCO-ja. Qëllimi i saktë dhe i zbatuar solli rritjen e treguesve në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Realizimi i këtij synimi kryesor e bëri këtë projekt që të shtrihej edhe në vende të tjera dhe ato europiane. Nuk janë pak vite edhe për vendin tonë, kur aplikimet e teknologjisë, të tilla si:videoprojektori, smart board-i, kompjuteri, softuerë, interneti, tabletë, celularë android etj., janë futur në sistemin e arsimit e, për rrjedhojë, mjetet për mësimdhënie kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Zbatuesit e guximshëm: metodistë, profesorë të universiteteve, të cilët i prekin treguesit në rritje, shkruajnë se ka shumë përparësi përdorimi i teknologjisë në klasë dhe në auditorë.

Kjo teknologji që po përdoret në klasa dhe auditorë, e bën nxënësin dhe studentin më të interesuar për temën mësimore, zvogëlon kohën e të mësuarit si dhe ofron mundësi për të mësuar në mënyrë krejt ndryshe, dhe motivohet për të gjatë punës së pavarur.

Pajisjet si tabletë, ajpedë (iPad), celularët android dhe iOS janë veçanërisht të dobishme për nxënësit e ciklit fillor gjatë 35 javëve të vitit shkollor, duke stimuluar kështu aftësinë e të shkruarit (kompetencën gjuhësore). Është efektive kur pajisjet përdoren me synime të qarta didaktike edhe për shkollat shqiptare, për rrjedhojë të prodhohet një tastierë të alfabetit të gjuhës shqipe, edhe për këto pajisje të cilat po shtohen në duart e popullsisë shkollore.

Shfletohet shumë herë faqja e IZHA-s⁹ ku theksohet se përdorimi i pajisjeve kompjuterike mbështet metodat e të nxënësve edhe për nxënës me aftësi ndryshe. Kështu, përdorimi i tyre ndihmon nxënësit me aftësi ndryshe konceptore si dhe nxënësit me nevojë të veçanta në përthithjen më të shpejtë të koncepteve të reja gjuhësore gjatë një teme çfarëdo mësimi.

Përvoja jonë në disa vite dhe kolegëve në universitete të tjera na ka dhënë mundësinë të shkruajmë se përdorimi i teknologjisë në klasë dhe auditorë gjithashtu ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve dhe studentëve, pasi ata ndihen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Jo vetëm të shkruajmë, por edhe të hedhim hapa të mëtejshme duke krijuar mjete didaktike konkurruese me këtë teknologji për rritjen e të nxënësve, për rrjedhojë zvogëlohen nxënësit me arritje të pakënaqshme (N.1), si edhe nxënësit me arritje që kanë nevojë për përmirësim (N.2), duke ngjitur shkallë me arritje të kënaqshme (N.3), arritje shumë të kënaqshme (N.4), arritje të shkëlqyera (N.5). Ngjitja e këtyre shkallëve kërkon një mjet didaktik bashkëkohor.

Përvoja 15-vjeçare, duke realizuar tek fjala *teste* dy kuptimet e saj në: latinisht dhe anglisht duke u ardhur në ndihmë mësuesve, prindërve dhe nxënësve me mjet didaktik, për rritjen e të nxënësve, qysh para 15 vjetësh botuam librat “Teste gjuhësore”. Për herë të parë për gjuhën shqipe në vitin 2002 dhe u shtrinë në të gjitha shkollat e vendit së bashku me modulën e përdorimit¹⁰, i cili shërben për kualifikimin e mësuesve. Përveç përdorimit, hulumtuam për një kohë të gjatë, hulumtuam këtë mjet të efektshëm (*Teste¹¹ në gjuhën shqipe, 2, 3, 4, 5*) për orët e gjuhës shqipe. Treguesit e rritjes ishin deri në 70% duke i krahasuar me klasat të cilat nuk i kishin përdorur.

⁹ Instituti i Zhvillimit të Arsimit, *Të nxënësve me situata konstruktivizmi dhe teknologjia*, Tiranë, 2015.

¹⁰ N. Mërkuri, *Modul. Integrimi i mësimdhënies dhe i të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe 2-4, në Ndërveprimi në klasë. Për zhvillimin profesional*. (për pasuniversitarët e Ciklit të Ulët), Botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003.

¹¹ N. Mërkuri, *Teste në lëndën e gjuhës shqipe, 2, 3, 4, Triptik*, 2002.

Prej disa vjetësh kemi punuar për përgatitjen e një aplikacioni të efektshëm si mjet didaktik “Teste” me disa zgjedhje¹² për nxënësit e klasave të dyta dhe të treta në hapësirën mbarëshqiptare, 60 mijë përdorues për secilën klasë, ky aplikacion vjen si një mjet tepër konkurues dhe realizues për rritjen e të nxënit. Është realizuar si aplikacion për pajisjet mobile: *sistemet Android, iOS dhe web*. Mund të punohet sipas mundësisë së nxënësit dhe mësuesit me tri nënndarjet: *Shfleto testin, Sfido shokun dhe Kampionët*. Ky aplikacion mund të shkarkohet falas nga Google play dhe Apple store. Në të ardhmen ai do të vijojë me klasat e katërta, të pesta e më tej.

1. Përvoja amerikane për kujtesën afatgjatë dhe të nxënit

Pas viteve 90- të u bënë përkthime nga autorë të suksesshëm perëndimorë në fushën e psikologjisë dhe të strategjive të të mësuarit. U përqendruan më shumë tek përvoja amerikane sidomos e autorëve: Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Constance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh me librin “*Strategjitë e të mësuarit*”. Nga kjo përvojë sjellim për citim nënvizimin e autorëve kur flitet për të mësuarit zbulues dhe nënndarjen *Vlerësim formativ. Kërkimi*.

Një teknikë kërkimi do të ndihmonte për të nxjerrë idenë:

- a) Demonstrimi i një leksioni duhet të bëhet gjithmonë para se nxënësit të prekin instrumentin.
- b) Nxënësi duhet të dinë rregullat e përdorimit të instrumentit para se ta përdorin atë.
- c) Një trajtim induktiv i ndihmon nxënësit të bëjnë zbulime dhe përgjithësime që mund të mbahen mend.

¹² Shih: Nexhip Mërkuri.com Aplikacione, 2017 në Google Play Teste gjuhë shqipe, 2, 3.

- d) Instrumentet janë kaq komplekse, saqë planet e zgjeruara të mësimit dhe teknikat e mësimit duhet të përgatiten më parë¹³.

Përgjigja jepet në vijim, theksi është në *pjesëmarrje* (c).

Po autori që u zgjodh dhe u përkthye për shkollat shqiptare pas viteve '90, ishte amerikani Terry F. Pettijohn, i cili ka eksperimentuar për një kohë të gjatë të mësuarit me ndihmën e kompjuterëve për të ndihmuar nxënësit, studentët, mësuesit dhe të tjerë për depozitim të informacionit për një kohë të gjatë. Faqet e librit janë shumë të vlefshme edhe për kujtesën afatgjatë. Po ky autor ka shkruar se si ta përmirësojmë më tej kujtesën, si ta depozi-tojmë informacionin që mësohet në mënyrë që mund të merret dhe të përdoret më vonë. Hapi i parë, procesi i futjes së informacionit në sistemin e kujtesës. Por për të mbajtur mend duhet të jemi të motivuar. Procesi i radhës është riprodhimi nxjerrja e informacionit nga sistemi i kujtesës. Rruajtja matet duke i kërkuar individit të përdorë informacionin e mësuar më parë.

Një element tjetër i rëndësishëm është kujtesa rindërtuese, e cila ka të bëjë me kombinimin e hollësive të caktuara të ngjarjeve me informacione të tjera që mbushin boshllëqe. Nxënësit përdorin mjete ndihmëse të kujtesës së jashtme, si marrja e shënimeve apo të pyeturit e dikujt më tepër se mjete ndihmëse të kujtesës së brendshme, përsëritje mendore dhe imazhet për t'u përgatitur për provim. Sa më shumë ta përsëritim materialin pasi ta kemi mësuar, aq më e gjatë do të jetë koha që do ta mbajmë mend atë material.

Teknika e studimit SQ3R (Survey "bëj sondazh" + Question "pyet" + Read "lexoj" + Recite "thuj me gojë" + Review "përsërit"), e hartuar nga Fransis Robinson, është mjaft efektive dhe e pëlqyeshme për përmirësimin e kujtesës. Përsëritja e materialit ndihmon për ta mbajtur mend atë gjithnjë në mendje.

Psikologët e përkufizojnë të mësuarit si një ndryshim relativisht të përhershëm në sjelljen ose aftësitë e individit për të manifestuar një sjellje të caktuar që ndodh si rezultat i përvojës. Sjellja konkrete

¹³ Shih më gjerë: Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Constance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh në librin "Strategjitë e të mësuarit" Tiranë, 1995, f. 269–270.

mund të vëzhgohet. Zbatimi mund të mendohet se është rezultat i kombinimit të të mësuarit me motivet¹⁴.

Përforcimi është i domosdoshëm për të realizuar të mësuarit. Programet e përforcimit, përforcimi i vazhduar, gjatë të cilit përforcohet çdo reagim i saktë, sjell në mënyrë të shpejtë në rritjen e ritmit të reagimit. Përforcimi dytësor është efektiv kur shoqërohet me përforcim parësor. Faqe të tjera po të Terry F. Pettijohn janë mundësi për të përmirësuar kujtesën, pasi, siç shkruan ai, vijnë pas shumë eksperimentimeve.

Këto përvoja eksperimentuese na dhanë mundësinë që të provojmë në vite, duke filluar nga viti shkollor 2002 me *Teste në lëndën e gjuhës shqipe, 2, 3, 4, 5*. Ky mjet didaktik, i cili përmirësonte të nxënësit në lëndën e gjuhës shqipe, u përdor nga mësues dhe nxënës edhe përtej kufijve, duke vijuar edhe sot për gjuhën shqipe 4-5.

2. Aplikacioni “Teste me disa zgjedhje, gjuhë shqipe 2, 3...” si alternativë e eksperimentuar

Ka më shumë se një gjysmë shekulli që nga autorë amerikanë punohet dhe eksperimentohet për të mësuarit e programuar. Jo vetëm që punohet, por kanë ndërtuar edhe parimet e të mësuarit të programuar. Këto parime janë mishëruar në një metodë që quhet *Instruksioni i Sistemit të Personalizuar (ISP)*¹⁵. Sipas kësaj metode, nxënësi dhe studenti e përvetëson materialin mësimor të përbërë nga njësi më të vogla. Çdo nxënës apo student duhet ta përvetësojë materialin e paraqitur në një njësi dhe t’u përgjigjet disa pyetjeve para se të kalojë në njësinë tjetër. Është shkruar se është metodë shumë efektive për arsye të pjesëmarrjes aktive dhe rezultatit tek njësitë e vogla në një kohë shumë të shpejtë duke e motivuar. Informacioni i menjëhershëm dhe i ndërsjellë që ai merr (feedback) dhe përforcimi (Reiser, 1984; Gage dhe Berliner, 1988) e bëjnë të admirueshëm për përdorim. Po kolegët e tyre shkruajnë më tej se kompjuterët mund të përdoren për të paraqitur materialin mësimor dhe për ta ndihmuar nxënësin a studentin që të mësojë me anë të

¹⁴ Terry F. Pettijohn. *Psikologjia*. Tiranë, 1996, f. 219–252.


¹⁵ Terry F. Pettijohn. *Psikologjia*. Tiranë, 1996, f. 219.

teknikave të ndryshme, siç janë testet me disa zgjedhje.¹⁶ (Pettijohn,1985). Duke vijuar më tej, shkruajnë se përmes të mësuarit të programuar zbatohen në procesin mësimor në shkolla disa prej parimeve themelore të kushtëzimit veprues (Kulik, Klik dhe Gangert-Drowons, 1985).

Në bazë të kësaj përvoje sot zhvillohen provimet e marrjes së licensës dhe provimet finale nga disa profesorë në universitete të ndryshme.

Vitet e përdorimit të teknologjisë u kanë dhënë mundësi shumë autorëve të eksperimentojnë dhe të ndërtojnë një alternativë për vite më të ulëta shkollimi, për zgjerimin e marrjes së informacionit të një teme të parashikuar për atë klasë shkollimi në lëndën e gjuhës, duke rritur procesin e të nxënit.

Synimi kryesor i kësaj alternative për nxënësin *për matjen e njohurive* për klasën e dytë, të tretë dhe në vijim për gjithë lëndën e gjuhës shqipe të arsimit 9-vjeçar, është: *aftësim, efekt dhe gatishmëri*.



Për çdo orë mësimi, sado i paktë të jetë informacioni që jepet për një temë gjuhësore, ndihet shqetësimi dhe gëzimi njëkohësisht. Çfarë ka mësuar nxënësi, shqetësim për mësuesin, drejtuesin dhe prindërit për atë orë mësimi dhe në vazhdimësi. Vlerësimi i mësimdhënies/nxënies (rezultateve të të nxënit) ndodh para, gjatë dhe pas mësimdhënies / nxënies duke ndihmuar mësuesin të vlerësojë se sa janë arritur rezultatet e të nxënit përcaktuar për atë orë mësimore nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve. Për

¹⁶

Po aty f. 220.

ndërtimin e aplikacionit si mjet didaktik, kemi pasur në vëmendje vlerësimin, i cili mund të jetë: *përmbledhës* (përmbledh atë që nxënësit kanë mësuar në fund të një ore mësimi ose për disa orë mësimi), *formues* (ndodh gjatë gjithë kohës) ose *diagnostikues* (i paraprin një mësimi si një mënyrë për të matur atë që nxënësi paraprakisht di.).

Mjetet/instrumentet e vlerësimit përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta¹⁷, miniteste, diskutimet për orët: *të flasim, veprimtarinë e nxënësit në klasë, projekte, portofolin dhe performancën e nxënësit*. Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësimdhënies/nxënies.

Në vitet '80 të shekullit që lamë pas, planifikohej përforsimi me gojë, pyetje për të parë përvetësimin e një teme gjuhësore dhe përforsimi me shkrim. Shihej si zbatoheshin njohuritë në një ushtrim të dhënë e më andej kalohej në dhënien e detyrës së shtëpisë. Ishin pak ato orë mësimi që nga koha e planifikuar të zbatoheshin edhe këto dy etapa të ditarit të atyre viteve edhe nga mësues shumë të mirë.


Hulumtimi sot paraqet mundësi të tjera. Është shkruar për qasjen e re kurrikulare dhe se portofoli i të nxënësit merr një vend të posaçëm, pasi mbështet zbatimin e kurrikulës të bazuar në kompetenca; krijon qëndrueshmëri në procesin e realizimit të saj; ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënësit. Është shkruar nga autorët eksperimentues që si mjete të teknologjisë që mbështesin

¹⁷ Përvoja shumëvjeçare e ndërtimit të testeve dhe e eksperimentimit na ka dhënë mundësinë të zgjedhim ndërtimin e aplikacionit: *pyetje me disa përgjigje* ose siç emërtohet nga autorë të tjerë si pyetje me përgjigje të shumëfishtë. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë janë lloji më fleksibël i pyetjes objektive. Bashkohem me mendimin e shkruar nga shumë autorë se ajo mund të përdoret për të testuar çdo lloj shprehje: njohja, të kuptuarit, zbatimi dhe analiza. Është e bollshme për të vlerësuar të nxënësit për një temë gjuhësore, për disa tema tremujore e vjetore. Rimarrje për të nxënësit, për ndërtimin e aplikacionit: pyetjet me disa përgjigje ose me zgjedhje të shumëfishtë janë vendosur në aplikacionin maksimumi i tyre (4 pyetje); pyetje me zgjedhjen e përgjigjes së saktë – ka një përgjigje të saktë, të tjerat janë të gabuara; pyetje me zgjedhjen e përgjigjes më të mirë – çdo pyetje ka elementë të vërtetë, por vetëm njëra është më e mira, më e sakta; pyetje për zgjedhjen e përgjigjes mohuese – duhet të zgjedhin atë që mohohet; pyetje për zgjedhjen e përgjigjes së thjeshtë apo të kombinuar – duhet të zgjedhë përgjigjen mohuese (*përveç*).

procesin e vlerësimit, dhe vlerësimin e nxënësve janë: testet elektronike dhe kuizet¹⁸.

Disa autorë që kanë eksperimentuar dhe hulumtuar në shumë shkolla këto vitet e fundit duke u bazuar dhe në përvojën e shkollave perëndimore, kanë shkruar se integrimi i përdorimit të TIK¹⁹-ut në programet shkollore sjell ndryshime në cilësinë e procesit mësimor. Në dokumentet e reja kurrikulare të hartuara në kuadër të rishikimit të kurrikulës aktuale për sistemin tonë arsimor, *kompetenca digjitale* është një ndër shtatë kompetencat kyçe të kurrikulës. Kjo kompetencë nënkupton aftësinë për përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë dhe gjatë kohës së lirë. Ajo bazohet në shkathtësimin e përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëpunuar në internet. Aplikimi i TIK-ut në klasë ofron rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shtimin e dijeve afatgjata për nxënësit.

Duke kapërcyer vështirësitë e aplikacionit “Teste me disa zgjedhje, gjuhë shqipe 2,3...”, më lart kemi shkruar se kemi nisur një seri mjetesh didaktike për shkallën e parë (klasa e dytë) dhe shkalla e dytë (klasa e tretë e në vijim, arsimi fillor). Mund të punohet sipas mundësisë së nxënësit, mësuesit dhe prindërve me tri nënndarjet sipas skemës së mëposhtme për gjuhën shqipe 2 dhe gjuhën shqipe 3 dhe në të ardhmen e dhe për gjuhën shqipe 4, 5.



Pas parathënies drejtuar mësuesve dhe prindërve të nxënësit, kemi hartuar nënndarjen kryesore: *Shfletu testin!*

¹⁸ Shih më gjerë Z. Gjini, G. Janaqi, M. Andoni, I. Todhe, A. Zisi, *Portofoli i të nxënit. Tregues i arritjes së kompetencave*, Tiranë, 2016, f. 16.

¹⁹ Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Përvoja shumëvjeçare na ka dhënë mundësinë të hartojmë situata të ngjashme nga gjuha shqipe 2, 3, ... Programi tërësor për një vit shkollimi për rritjen e njohurive të qëndrueshme ngërthen testet me disa zgjedhje, të cilat janë për të gjitha orët e gjuhës shqipe 2: *të flasim, të shkruajmë, njohuri për gjuhën, drejtshkrim. Janë 100 teste për gjithë vitin shkollor, 35 javë mësimi. Pas 30 testeve janë hartuar teste përmbledhëse për secilin tremujor dhe semestër. Dy variante kemi hartuar edhe për testin përzundimtar vjetor.*

Për nxënës me arritje shumë të kënaqshme (Nota 4), arritje të shkëlqyera (Nota 5), kemi hartuar 12 teste plus orëve të mësimi: *Gëzohem nga interneti; Plotësimi i kuicit (kuiz) e do puthjen; Ndryshoj gjatë klasës së dytë; Provo leximin e bukur; Vallëzimi i pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës; Provo rimarrjen për shkallë të së ardhmes; Fjala te fjalia. Kemi hartuar 4 teste me titull Kur kuicet (kuiz) plotësohen më shpejt nga gjëgjëzat.*


Edhe për gjuhën shqipe 3 kemi hartuar teste me situata të ngjashme nga programi i saj tërësor për një vit shkollimi për rritjen e njohurive të qëndrueshme. Testet janë për të gjitha orët e gjuhës shqipe 3, pra 121 teste me disa zgjedhje për të gjitha orët e mësimi: *të flasim, të shkruajmë, njohuri për gjuhën, drejtshkrim. Aplikacioni për gjuhën shqipe 3 ka një mënyrë tjetër fillimi. Nis me variante të testeve diagnostikuese në 4 faqe, duke përafuar për tremujorin e parë, të dytë, e të tretë apo për gjithë semestrin I, 39 teste, 36 teste për semestrin e dytë, ndërsa 22 teste janë për semestrin e tretë. Ky numër ndryshon në varësi të realizimit të orëve. Nga dy variante janë hartuar edhe për testet përfundimtare vjetore të kësaj klase. Për këtë klasë më të rritur të shkallës së dytë, për nxënës me arritje shumë të kënaqshme (Nota 4), arritje të shkëlqyera (Nota 5); kemi hartuar teste plus orëve të mësimi: *Provo leximin e bukur; Si ke ndryshuar ti? Analiza të ndryshme (2p); Lajme nga interneti; Çdo ditë dua puthje për suksesin.**

Nënndarja e dytë e vendosur në faqen e parë: *Sfido shokun!*

Sfidë e re, Sfidat, gjatë ditës perceptohen si dy duar. Çdo ditë ka një provë për vete dhe për shokun ose shoqen.

Mund të konceptohet edhe si një lojë gjuhësore, por më tepër mëshohet në rimarrjen e informacionit kur është e domosdoshme, duke e zgjeruar përveç mësuesit dhe tekstit. Ka mundësi ta rritë të

nxënit nga prindi, më i rrituri i familjes, por edhe nga shoku/shoqja. Mund të shfrytëzojë edhe orët kur shkolla është qendër komunitare.



Vendosja e përgjigjes për temën e re gjuhësore shërben si rimarrje e informacionit jashtë orës së mësimi, duke e rihapur debatin për temën gjuhësore dhe motivim për realizim tërësor. Është një mundësi që përmirëson të nxënit afatgjatë.

Në pak minuta nxënësit rishikojnë të nxënët e tyre përmes vlerësimit me notë nga aplikacioni, duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët.

Për prindërit është kohë e vlefshme, pasi sigurojnë mundësi që të diskutojnë, të shkëmbejnë përvoja për rezultatet e pritshme nëpërmjet pjesëmarrjes në moderimin e vlerësimit për fëmijën a të afërmin.

Nënndarja e tretë: Kampionët



Konceptohet me dy krahë: Arritjet vetjake dhe lista e kampionëve, duke formuar një portofol kombëtar për gjuhën shqipe 2, 3 dhe në vijim.

Vështirësitë e aplikacionit të detyrojnë që të zgjedhësh një fjalë që të jetë motivuese, duke shërbyer si portofol i vlerësimit vjetor për nxënësin ose përdoruesin.

Nënndarja e tretë në aplikacion ka synim kryesor të mbikëqyrë përparimin e nxënësit gjatë procesit të të nxënit dhe të mbledhë informacion për të lehtësuar dhe për të ndihmuar marrjen e vendimeve për ta përmirësuar këtë proces. Regjistrimi i vlerësimit

për çdo orë të zhvilluar përcakton arritjet në përfundim të temës gjuhësore për atë ditë, përcakton arritjet e kapitullit, semestrit, të vitit shkollor, duke ruajtur notat dhe për të certifikuar nxënësit për nxënie të mëtejshme.

Mësuesi i klasës së dytë, të tretë e në vijim mund t'i përdorë të dhënat e portofolit për qëllime të ndryshme, duke përfshirë nxitjen e të mësuarit të vetëdrejtuar; krijimin e një panorame të qartë të asaj që është mësuar nga nxënësi; demonstrimin e progresit të nxënësit, bazuar në rezultatet e regjistruara nga aplikacioni si mjet didaktik.

Portofoli i të nxëniet²⁰ është koleksionimi i kontributeve të nxënësit dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij në lëndën e gjuhës shqipe 2, 3 e në vijim. Siç e ka përcaktuar Diane Hart, portofol: "një enë që mban evidencën e njohurive, të ideve, interesave dhe arritjeve"; ne e shohim për nxënësin e klasës, fëmijën, por edhe mund të shpallim fituesit kombëtarë e me tej. Duke shpallur kampionët nga portofoli i vlerësimit, kemi mundësi të hedhim hap tjetër për motivimin e nxënësit, përtej dorëzimit të fletëlavdërimit apo fletënderit edhe para klasës dhe shkollës. Për çdo test që ka një temë mësimi, nota maksimale është shoqëruar edhe me një mesazh e kupë të animuar: "Ju përgëzojmë! Të gjitha përgjigjet e sakta!"

Teoria motivacionale e kompetencës na tregon se nxënësit janë të motivuar të bashkëveprojnë suksesshëm me shokët, familjen e gjithë shoqërinë. Nota e marrë në aplikacion do të nxitë përpjekjet për realizimin e kompetencës gjuhësore dhe do ta motivojë nxënësin për të vazhduar përpjekjet për të dalë me arritje progresive, të shkëlqyera.

John Atikson përpunoi një model për të kuptuar motivacionin për të ecur përpara me formulën: $T = M \times P \times SH$ që duhet kuptuar kështu: Tendencë për të arritur sukses (T) është e barabartë me motivin për të arritur sukses (M) shumëzuar me probabilitetin e suksesit (P) shumëzuar me vlerën shtytëse të suksesit (SH)²¹. Këta nxënës që arrijnë të dalin kampionë kombëtarë, të kuptojnë se kupa pas çdo vlerësimi me notën *pesë* apo dhjetë nuk është e vetme me

²⁰ Shih më gjerë: Z. Gjini, G. Janaqi, M. Andoni, I. Todhe, A. Zisi, *Portofoli i të nxëniet. Tregues i arritjes së kompetencave*. Tiranë, 2016.

²¹ Terry F. Pettitjohn. *Psikologjia*. Tiranë, 1996, f.341.

mesazhin shoqëruës, por duhet të besojnë se kanë një shans për sukses dhe se shoqëria, e cila është e interesuar, do ta vlerësojë portofolin e arritur në fund të çdo klase.

Kur fitojmë mirënjohjen e të tjerëve, vëmendjen e atyre me pozitë të lartë, ne plotësojmë nevojat për vlerësim dhe ndihemi të rëndësishëm e me besim në vetvete, shkruan autori i teorisë së motivacionit Abraham H. Maslow (1987). Po ky autor shkruan se duhet ta shohim nxënësin si një të tërë dhe pjesëtar i shoqërisë, i cili formësohet nga një hierarki nevojash, të cilat, nëse plotësohen në mënyrë të kënaqshme, bëjnë që nxënësi ta realizojë plotësisht potencialin e vet në vitet e shkollimit dhe nesër si pjesëtar i rritur i shoqërisë. Është plotësisht e mundur që kampionët e shpallur nga portofoli i aplikacionit të shpërblehen me dhurata, si: tabletë apo smartfonë dhe, kur ka më shumë se dy, klasa mund të marrë një “Smart board” etj.; stimuj që mund të jepen nga bashkëpunëtorë apo nga fondi i Ministrisë së Arsimit apo i drejtorive rajonale, Bashkia etj.

Kompetenca digjitale dhe rritja e treguesve të të nxënimit për gjuhën shqipe kërkon mjete didaktike efektive të eksperimentuara, si aplikacioni, duke mos e lënë vetëm tekstin e nxënësit, gjuhën shqipe 2, 3... Realizimi i përgjigjes së vlerësimit në pak minuta, duke kursyer kohën e nxënësit, kërkon që mësuesit, duke u kualifikuar, të jenë më të suksesshëm me nxënësit dhe së bashku të jenë në gjendje të përdorin teknologjitë e reja (TIK). Mësuesi, duke zotëruar kompetencat e përcaktuara në dokumentet zyrtare të UNESCO-s për teknologjinë në arsim, moduli 4 në konferencën²² e UNESCO-s, rrit treguesit e të nxënimit. Është një mundësi që edhe gjuha shqipe të ketë një mjet bashkëkohor si edhe gjuhët e tjera të Evropës për rritjen e të nxënimit, rritjen e notës mesatare kombëtare, e cila do të pasqyrohet më tej në konkurset ndërkombëtare që zhvillohen çdo vit akademik.

²²

Shih më gjerë: UNESCO-Bangkok Office» Education» ICT in Education»

Themes»Training of Teachers»

Guidelines»Teachers' role and needs in the ICT environment

UNESCO-Bangkok Office» Education» ICT in Education»

Themes»Training of Teachers»Guidelines»Teachers' role and needs in the ICT environment

[UNESCO (2011). [UNESCO (2011).

UNESCO ICT competency framework for teachers (ICT CFT). IITE Conference Teacher Competencies in Knowledge Society: Policy, Pedagogy.

ANAS

Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 811.18'373.2(450)

Punim studimor

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti 'Nënë Tereza', Shkup

mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk**SHUMETNIKËSIA DHE MIULTIKULTURALIZMI NË
ONOMASTIKËN E BIGËZUAR ARBËRESHE-ITALIANE****MULTI ETHNICITY AND MULTICULTURES IN THE
ARBENESH-ITALIAN FORKED ONOMATICS**

Përmbledhje

Edhe pas 500 vjetësh, një nga mërgatat më të moçme të shpërngulur nga Arbëria e moçme dhe e shpërndarë përgjatë Italisë Jugore, qysh nga Peskara e deri poshtë në Sicili, edhe sot e kësaj dite emrat e përveçëm dhe të toponimeve të arbëreshëve të Italisë i përdor me dy forma: një formë zyrtare italiane dhe një formë jozyrtare shqipe. Atje, edhe pas kaq shekujsh, dyetnikësia, dykulturorësia si dhe krejt rrjedha shpirtërore e dyzuar: arbëreshe dhe italiane është shfaqur aq dukshëm edhe në gjuhën dhe në onomastikën e bigëzuar: gati të gjitha ngulimet arbëreshe në Itali kanë nga dy emra: një

vendor shqip ose të shqiptarizuar dukshëm sipas traditës përvetuese të hershme dhe një trajtë të dytë zyrtare italiane. Kështu kemi: Firmoza (<Acquaformosa), Dandalli (< Andali), Barilli (< Barile), Këmarini (< Campomarino), Garrafa (< Caraffa di Catanzaro), Karfici (< Carfizzi), Kazallveqi (< Casavecchio di Puglia) etj. Me dy mbishkrime italisht dhe shqip absolutisht është edhe çdo rrugë, si: *Via Albania*, (Udha e Shqipërisë), *Via di Kastriot* (Udha e Kastriotit) etj. Në dy gjuhë janë edhe muzeumet, bashkitë, kishat, apo dhe baret e thjeshta ku hyn të pish diçka, si "Vino rosso" dhe Verë e kuqe" përkarshi në një tabelë të madhe ndanë bar-kafesë "La bella poesia" në San Cosmos Albanese. Do të shqyrtohet terminologjia arbëreshe që i përgjigjet termit italian .

Fjalë çelës: Arbëreshët, onomastika, dykulturësia, mikrotomponimet, mbishkrimet

Abstract

Even after 500 years, one of the oldest diaspora displaced from old Arberia and distributed throughout southern Italy, from the Pescara's down to Sicily, even nowadays, nouns and toponyms of Italy's Arberesh uses two forms: an italian official. : Arberesh and Italian all Arberesh settlements in Italy have two names: Firmoza (Acquaformosa), Dandalli (< Andali), Barilli (< Barile), Këmarini (< Campomarino), Garrafa (< Caraffa di Catanzaro), Karfici (< Carfizzi), Kazallveqi (< Casavecchio di Puglia) etc. Every street is with two signs in Italian and Albanian, for example: *Via Albania*(Albania street), *Via di Kastriot* (Kastriot street) etc. In two languages are even the museums, municipalities, churches even the local bars when you enter to drink something, for example "Vino rosso" and red wine" in front a large table which is "La bella poesia" in San Cosmos Albanese. Will be reviewed the arbresh terminology which responds with Italian terminology.

Key words: Arberesh, onomastics, two cultures, microtoponym, inscriptions

Hyrje

Mjedisi dhe rrethanat politiko-shoqërore e kulturore në të cilat jeton një bashkësi njerëzish nuk mund të mos lënë gjurmë edhe në gjuhën që flet ajo, përfshirë edhe onomastikën. Tek toponomastika arbëreshe në katundet arbëreshe vërehet dashuria e tyre për një ringjallje shpirtërore, kulturore, shoqërore dhe ekonomike të tyre.

Arbëreshët si komunitet elitë në historinë e Kalabrisë janë kujdesur jo vetëm për gjuhën, por të gjitha institucionet që iu duhen për të ruajtur dhe rezistuar në identitetin e trashëgiminë e tyre kulturore kanë krijuar për bukuri libra dhe revista pa fund në shqip dhe arbërisht ku ruhen dhe zhvillohen edhe poezitë dhe proverbat gojore shekullore, muzeume ku ruhet tradita e kostumeve popullore dhe artizanale, fotografi kujtesë, festa kombëtare dhe fetare me rite bizantine, duke pasur rreth e përqark një Itali katolike.

Elementi arbëresh i Italisë gjatë këtyre pesë shekujve që nga ngulimi i tij në ato anë ka pësuar mjaft ndryshime dhe humbje në numër, sidomos nëpër qytete. Megjithatë ka ruajtur përgjithësisht me një qëndrueshmëri të çuditshme gjuhën dhe vetitë etnografike. Nëse krahasojmë arbërorët e Greqisë me Arbëreshët e Italisë, do të shohim se në Greqi toponimia shqiptare është më e pasur se në Itali, ajo paraqitet edhe nëpër vise, ku sot nuk ka mbetur më gjurmë shqiptarësh. Te të dyja elementet ruhet edhe emri i lashtë i popullit (arbëresh) e i gjuhës (arbërisht), gjë që dëshmon se në kohën e shtegimitit shqiptar për në ato anë ky ishte emri në përdorim dhe se emri i sotëm nuk ish përgjithësuar.

Besimi ortodoks në Greqi i ka çelur shteg asimilimit; në Itali përkundrazi, me një popullsi vendëse të ritit latin, ka qenë një faktor i ruajtjes etnografike e gjuhësore. Në lidhje me gjuhën do shtuar se si atje si këtu ndonjë fjalë e shqipes ka depërtuar në gjuhën e popullsisë që i rrethon.

Identitetet arbëreshe

Shoqëria e konsumit, globalizmi, largimi i të rinjve nga katundi, kultura dhe gjuha italiane, të gjitha këto nuk e kanë mposhtur ende identitetin e këtij komuniteti, për të cilin ata ndjehen tepër krenarë, por në masë të madhe e kanë lëkundur atë. Do të përpiqemi të tregojmë disa nga identitetet me të cilët ballafaqohen arbëreshët e Italisë, që mendojmë janë kyçe për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit të tyre.

1) Identiti krahinor përkatës (Kalabri, Sicili, Molise etj.);

- 2) Identiti fetar (katolikë të ritit grek, ose uniatë),
- 3) Identiti kulturor (*gjuha, trashëgimia popullore, veshja, letërsia, simbolet, toponimet etj.*),
- 4) Identiteti kombëtar italian (pikëvështrimi realist),
- 5) Identiteti kombëtar shqiptar (pikëvështrimi historiko-mitik),
- 6) Identiteti qytetar është qartësisht italian.
- 7) Identiteti kulturor.

Faktorët të cilët përforcuan identitetin e mbarë popullsisë arbëreshe, duhet kërkuar në kulturën e tyre popullore, ndër të cilët do të përmendim gjuhën, trashëgiminë popullore, veshjen, letërsinë, toponimet etj.:

Gjuha, edhe sot e folur në shumicën e komuniteteve me origjinë arbëreshe, përfaqëson një dukuri shumë të fortë që prek si ata që e flasin ashtu edhe dëgjuesit, italianët, që i kanë pritur arbëreshët si mysafirë;

Veshja e grave, që vetëm deri pak vjet më parë ishte shumë e pranishme në të gjitha komunitetet arbëreshe, funksiononte si një kartëvizitë për të gjithë popullsinë dhe kishte një domethënie etnike të veçantë sepse trashëgohej brez pas brezi si shenjë dallimi;

Gjithonia, mikpritja, besa përfaqësojnë disa nga elementet më origjinale dhe tradicionale të kulturës popullore arbëreshe. Disa veçori të kulturës arbëreshe lidhen me gjendjen e saj si kulturë tipike fshatare dhe prandaj mund të mos kenë një veçori specifike etnike: p.sh për lidhja e fortë e organizimit familjar, për solidaritetin më të madh në indin shoqëror etj. Kur flitet për besën, kryetari i Bashkisë së Fallkunarës, z. Erkole Konti pohoi se italianët për herë na kanë respektuar për fjalën. Fjala është fjalë, ne me shekuj e kemi ruajtur besën. Ne përveç besës dhe guximit, kishim edhe mençurinë, sepse pleqtë tanë na kishin mësuar " *numero deri dhjetë para se të flasësh*". (Ibrahimi 2008:137-138).

Me themelimin e kolegjeve bizantine në San Benedetto Ullano (më vonë shpërngulur në San Demetrio Corone) dhe në Palermo, lindi Letërsia arbëreshe e përfaqësuar nga veprat e autorëve shumë të njohur si: Variboba, Keta, De Rada, Serembe, Santori, Dara, Skiro etj., të gjithë këta nxitën përhapjen e ideve të reja romantike duke i dhënë popullsisë arbëreshe edhe një shenjë dalluese me të tjerët dhe duke përforcuar identitetin kombëtar, fetar dhe kulturor.

Identiteti arbëresh u mbrojt edhe nëpërmjet simboleve që janë të shumtë, si p.sh. motivi i gjarprit që e gjejmë si mozaik në Kishën e Shën Mitër Koronës, por edhe në shumë libra dhe materiale tjera propaganduese të arbëreshëve. (Ibrahimi 2008:58). Në disa fshatra, si në Frasnitë, rron shpirti i lashtë i etnisë arbëreshe. E Hëntja dhe e

Martja e Pashkëvet janë konteksti natyror të formave origjinale të përfaqësimit të identitetit.

Toponimet gati në të gjitha ngulimet arbëreshe në Itali kanë nga dy emra: një vendor shqip ose të shqiptarizuar dukshëm sipas traditës përvetuese të hershme dhe një trajtë të dytë zyrtare italiane. Kështu kemi: Mbuzat-(<it. San Giorgio Albanese), Maq-i (<it. Machia Albanese), Strigar-(< it. San Cosmo Albanese), Zhurë-a (<it.Ginestra), Horë-a (< it.Piana degli Albanesi), Puhëri-u (< it Pallagorio), Porkanun-i (= it. Portocannone), Ungër-a (< it. L' Ungro), Çift-i (<it.Çivita) etj.

Atje, edhe pas kaq shekujsh, dyetnikësia, dykulturorësia, si dhe krejt rrjedha shpirtërore e dyzuar: arbëreshe dhe italiane është shfaqur aq dukshëm edhe në gjuhën dhe në onomastikën e bigëzuar.

Onomastika e bigëzuar në katundet arbëreshe të Italisë



Le të marrim rastin e emrave të përveçëm dhe të toponimeve të arbëreshëve të Italisë me dy forma: një formë zyrtare italiane dhe një formë jozyrtare shqipe, një mërgatë e moçme, tashmë më se 500-vjeçare, e shpërngulur nga Arbëria e moçme dhe e shpërndarë përgjatë Italisë Jugore, qysh nga Peskara e deri poshtë në Sicili. Atje, edhe pas kaq shekujsh, dyetnikësia, dykulturorësia si dhe krejt rrjedha shpirtërore e dyzuar: arbëreshe dhe italiane është shfaqur aq dukshëm edhe në gjuhën dhe në onomastikën e bigëzuar: gati të gjitha ngulimet arbëreshe në Itali kanë nga dy emra: një vendor shqip ose të shqiptarizuar dukshëm sipas traditës përvetuese të hershme dhe një trajtë të dytë zyrtare italiane. Kështu kemi: Firmaza (<Acquaformosa), Dandalli (< Andali), Barilli (< Barile), Këmarini (< Campomarino), Garrafa (< Caraffa di Catanzaro), Karfici (< Carfizzi), Kazallveqi (< Casalvecchio di Puglia), Kastërnexhi (< Castroregio),

Kejverici (< Cavallerizzo), Qana (< Cerzeto), Qefti (< Chieuti), Çivëti (< Civita), Kuntisa (< Entellina), Purçilli (< Eianina), Fallkunara (< Falconara Albanese), Ferma (< Firmo), Farneta (< Fameta), Frasënita (< Frascineto), Zhura (< Ginestra), Katundi (< Greci), Ungra (< Lunpro), Maqi (< Macchia Albanese), Marçidhuza (< Marcedusa), Allimarri (< Marri), Mashqiti (< Maschito), Munxhufuni (< Montecilfone), Puheriu (< Pallagorio), Hora e Arbëreshëvet (< Piana degli Albanesi), Pllatëni (< Plataci), Porkanuni (< Portocannone), ShënVasili (< San Basile), Shën Benedhiti (< San Benedetto Ullano), Strigari (< San Cosmo Albanese), Shën Kostandini (< San Costantino Albanese), Shën Mitri (< San Demetrio Corone), Sënd Japku (< San Giacomo di Cerzeto), M buzati (< San Giorgio Albanese), San Marcani (< San Marzano di San Giuseppe), Shën Mërtiri (< San Martino di Finita), Shën Kolli (< San Nicola dell'Alto), Shën Pali (< San Paolo Albanese), Picilia (< Santa Caterina Albanese), Sëndastina (< Santa Cristina Gela), Shën Sofia (< Santa Sofia d'Epiro), Spixana (< Spezzano Albanese), Ruri (< Ururi), Vakarici (< Vaccarizzo Albanese), Vina (< Vena di Maida), Badhesa (< Villa Badessa) dhe Garona (< Zangarona).

Siç mund të shihet, karakteristikë tjetër është se materiali italian i është shtruar sistemit fonetik e gramatikor të shqipes, si në emërtimet shqipe të fshatrave, ashtu edhe leksikut të përditshëm që janë huazuar nga italishtja, si p. sh. (speranza : sprënc, abitare : bitër etj.), por ky vitalitet vise-vise sot ka zënë të zhduket.

Tabelat në hyrje të fshatrave për mirëseardhje

Për një shqiptar që viziton fshatrat arbëreshe befasia e parë që të shfaqet sapo hyn në katundet arbëreshe janë tabelat anës rrugës në hyrje të fshatit. Në të shkruhet: "Benvenuti nel Comune di _____" dhe "Mirësevini në Komunën _____".

Toponomastika rurale dhe urbane

Toponimia tradizionale arbëreshe jep mundësinë që të identifkohen më mirë gjitonit "rrugicat dhe lagjet" e katundit dhe të dëshmohen ngjarjet socio-kulturore e territorit të tyre. Çdo rrugë²³ absolutisht me dy mbishkrime; italisht dhe shqip,

²³ Arbëreshët me fjalën 'rrugë' emërtojnë hapësirën e ngushtë dhe me 'udhë' atë më të gjerë dhe kryesore.

Onomastika rurale dhe urbane në fshatin Strigar

Qendra historike e Strigarit nga sheshi ndahet në dy pjesë: Drelarti



(ana lartë) dhe Drehjimi (ana poshtë). Rrugët që shprishen për në katund janë: Konza (Ikonat e shënjtravet Kozmai dhe Damiani), Brinja (vend i hjimisur i katundit), Kambara Kazinit (hyrje në pronë të Kazinit), Katundi i ri (vend i katundit të ndërtuar tek vitet 60), Ka dera Qishës (sheshi përpara qishës), Aprapa Qishës (vend prapa qishës), Sheshi (sheshi i vogël), Kropëzit (vend ku bridhej tek vëret), Udhëe Rea (udha e re), Kallvari (vend i martirizimit), Radja (vend ku rritej një rrëmb me gjëmba). Në fshat ekzistojnë rrjedha uji si: *Lumi i Madh*, *Mballasiu*, *Lumi i mesit* (Mëxofti, siç i thonë vendasit). Sidomos e dukshme është toponomastika e udhëve.

Toponomastika rurale dhe urbane në fshatin ÇIVËT

Fshati Çivët është vend turistik. Vinë shumë turistë nga e tërë bota. Zoti ia ka falë këtë bukuri. Këtu është mirë ta vizitoni “Urën e djallit”, sipas ndonjë legjende kjo urë njëherë ka ra dhe prapë është ndërtuar. Emërtimet e vendeve në Çivët janë: ARAT: *Ka Faniku, Ka Kollolleshi, Ka Pllasi, Ka Stoci, Ka Tindinoti, Karrara Ursit (Rruga e arushës), Konëza, Kushnjezit, Llaka Qarrit, Marsi ka Sheshi, Sheshi Lliborit, Sheshi Pirindushit, Shkoza, Shpirti Shëjinjët*; GURËT: *Guri e vallëzues, Prapa Shkëmbi*; KROJ: *Kroj Kacamites, Kroj Mikës, Kroj Ndërmest, Kroj Piçirilit, Kroj Pringjip, Kroj Shën Mirtirit, Krojaposhta*; FUSHAT: *Botëza, Buteza, Fulurit, Kazjolla, Llaka Qarrit, Llamja, Marçoni, Mazjeli, Shën Miritir Lart, Shën Mirtiri Posht, Skirjanet*; MALET: *Mali i Bulinit (Pollino), Llakëza (Luginë e vogël), Cukalia, Mali Posht, Ka Rahjet, Timba Dhumënit, Qupat (plepat), Pjoka (Pisha)*; VRESHTAT: *Shpirti Shënjëtë, Shën Lliu, Pastanet (vreshta të reja), Mali Posht, Mali Lart*; URË: *Ura e djallit*.

Toponomastika rurale dhe urbane në fshatin Fallkunara

Fallkonara është përbërë si çdo qendër urbane nga lagje, secila e quajtur me emra që kujton shtatë familjet e para që e themeluan si qytezë, por dhe njerëz të rëndësishëm të jetës sociale, fetare e politike të saj, si dhe kushtëzuar nga prezenca e një çezme apo të një kishe. Çdo gjitoni ka sheshin e saj ne formë rrethi, me shtëpitë përreth me shkallë jashtë e plot lulemëllage, karafila e lulebore që i zbukurojnë.

Lagjet e fshatit mbajnë emra të ndryshëm: *Munisati*, "menëi i that", "Kurtina", "Dragati", "Dera e Baut", "Shpati i Kastelit", "Mbrukunxili", "Kaiëndulla", "Kroj i Vjetër", "Mulliri", "Pandana", "Mbikatundi", "Vasali".

Mikrotoponimet e fshatit Fallkunarë: "Gure Picuti", "Udhëza e Bukur", "Kroj Moll", "Kollaringu", "I Grieci", "U Fagutiellu", "San Pietro", "I Riciett", "Kroj Maces", "Kroj Prithit", "A Funtana Vuddruta", "Prroi i Markes", "Mbikatundi", "Santu Martin", "Spiniti", "Lumiti". "Timpa du Cuarvu", "Torremezzo", Rahmarinë (mal i vogël, gjysëm mal), Spinit, Honi, Rrahi (kodër), Prroi i Markes, lumenjtë: Dumi Kavunit, Dumi Favjanit, Dumi Munisatit, Gurët e Kondit etj.

Nga rrugët e qytezës, më kryesoret janë: rruga "Jeronim De Rada", rruga "Felice Staffa", shkrimtar e poet falkonar, rruga "Nënë Tereza" e sheshi "Skanderbeg".

Toponomastika rurale dhe urbane në fshatin Shën Sofi

Largo Carcarelle – Sheshi i Karkarelevet; Largo Croce - Sheshi i Kryqit; Largo Delle Marchianò – Sheshi i Marqaneshavet; Largo Marco Botzaris – Sheshi i Markut Boçarit; Largo Mons. Francesco Bugliari - Sheshi i Peshkut Frangjisk Bulari; Largo Ospizio - Sheshi i Spi-xit; Largo Sentine – Sheshi i Sentinëvet; Largo Trapesa - Sheshi i Tra-pëzës; Largo Vescovi - Sheshi i Peshkravet; Piazza S. Atanasio - Qaca E Shën Thanasit; Piazzetta Degli Eroi - Qaca e Trimavet; Via



Albania - Udha e Shqipërisë; Via Angelo Masci - Udha e Engjëllit Mashit; Via Antonio Gramsci - Udha e Ndonit Gramshit; Via Archi - Udha e Er-qevet; Via Ascensione - Udha e Shixhonës;

Via Cassano - Udha e Kasanës; Via Castriota - Udha e Kastriotit; Via Chiesa Vecchia - Udha e Qishës së Vjetër; Via Degli Olivi - Udha e Ullinjvet; Via Epiro - Udha e Epirit; Via Dr. Francesco Bugliari -



Udha e Dhon Frangijskut Bulari; Via Giacomo Matteotti - Udha e Japkut Mateotit; Via Glimirtiri - Udha e Lëmit të Mërtirit; Via Mandorle - Udha e Mendullavet; Via Morea - Udha e Moresë; Via Moroiti - Udha e Moroitëvet; Via Mustica Grande - Udha e Limustit të Madh; Via Orti - Udha e Kopshtrevet; Via Ospizio -

Udha e Spixit; Via Pasquale Baffi - Udha e Paskallit Bafit; Via Pedalati - Udha e Pedhallatit; Via Roma - Udha e Romës; Via Scigata - Udha e Shigatës; Via Stangò - Udha e Stangoit; Via Strada Grande - Udha e Madhe; Via Trieste - Udha e Triestes; Via Vescovi - Udha e Peshkravet; Via Vico Cieco - Udha e Rugës së Verbër; Via Vico Stella - Udha e Rugës së Yllit;

Shenjat e qarkullimit rrugor

Kur një i huaj ose një italian që vjen tek një katund arbëresh, e para gjë që vëren është se si sheshet, emrat e udhëve, muzeumet, bashkitë, kishat e objekte tjera janë të shkruara në gjuhën italiane dhe në gjuhën arbëreshe. Ata njerëz kuptojnë shpejtë se gjenden tek një katund që është në Itali por banoret e katundit kanë rrënja prej lindjes, sepse gjuha është arbëreshe dhe riti i tyre është bizantin. Gjithçka, gjithçka në dy mbishkrime.

2. Restorantet në katundet arbëreshe me meny dygjuhësore



Edhe në baret e thjeshta kur hynë të pish diçka, gjithçka është në dy mbishkrime. "Vino rosso" dhe Verë e kuqe" përkarshi në një tabelë të madhe ndanë bar-kafesë "La bella poesia" në San Cosmos Albanese.

Në fshatin Çivëti (< Civita) në dritaren e një restoranti ishte ngjitur lista e ushqimeve në italisht dhe arbërisht, edhe atë: Macelleria – mish, prociutto – pirsut, capretto – mish kaciqi, osso – asht, pecora – mish dele, bistecca – bistek, soppressata – supirsatë, agnello – mish shtjerri, carne congelata – misht të ngritë, costate – brinjazë, manzo – mish kau, fegato – mulshi, salsiccia – saucicë, coniglio – mish lepuri, frattaglie – pimbrendash, pollo – mish pule, vitello – mish viçi, montone – mish dashi.



Manifestimet kulturore në dy gjuhë



arbëreshët si mysafirë.

Përfundimi

Lirisht mund të themi se një nga projektet më të rëndësishme që ndërmorën institucionet e vendit dhe administratat bashkiake arbëreshe, padyshim është toponimia tradizionale nëpër rrugicat e katundeve arbëreshe. Projekti, përveç që përfaqëson një hap përpara drejt mbrojtjes së gjuhës, kulturës dhe të traditave të vendit si vlera të pasurisë sonë kulturore, ky projekt përfundimisht largon rrezikun e zhdukjes së kulturës arbëreshe.

Duhet të vazhdojnë dhe të intensifikohen Konferencat shkencore, seminarët dhe forma tjera bashkëpunimi nga të dyja

anët. Në seminaret e Prishtinës, Tiranës, Tetovës etj. nuk mungojnë arbëreshët, por marrëdhëniet duhet forcuar edhe më shumë midis botës mbarëshqiptare, ballkanike dhe asaj arbëreshe.

Tani kemi mundësi që të lëvizim më shpesh dhe më lirshëm dhe kjo mund të na ndihmojë shumë. Megjithatë, edhe më tej duhet programuar projekte më të zgjeruara, duhet zhvilluar një veprimtari që do të ndihmojë afrimin edhe më të madh midis të dy kulturave arbëreshe - shqiptare.



Teknologjia moderne duhet të na shërbejë për të krijuar një botë më të afërt duke vënë në dispozicion trashëgiminë historike që secili ka prodhuar në vendin e vet. Kjo është një mënyrë se si mund të afrohen. Kjo ndodh edhe me festivalet, me panairt e librave që po organizohen etj.

Kishim bindjen se pothuaj të gjithë arbëreshët toponimin e tyre e kishin ruajtur me xheloz, duke përkujtuar të

kaluarën dhe prejardhjen e tyre.

Bibliografia

- ALTIMARI, Françesko. (2002). *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*. Shpresa & Faik Konica. Prishtinë.
- ARMILLOTTA, Giovanni. (2001) *Emigrimi dhe ruajtja e identitetit nëpërmjet fesë*. Në gazetën e shqiptarëve në Itali "Bota shqiptare", nr.42, 6-20 korrik 2001. Romë.
- BAFFA, Giuseppe. (2004). *Të thëna, fjalë t'urta, pashoqe të koditura arbëreshe të Shën Sofis*. Komune di S'Sofia d'Epiro.
- BELLUSCI A., Dizionario fraseologico degli albanesi d'Italia e di Grecia, Centro ricerche socio-culturali "G. K. Skanderbeg", Cosenza, 1989
- BELLUSCI, Antonio. (2003). *Antologia Arbëreshe*. Cosenza.
- BELLUSCI, Antonio. 1989. *Dizionario frazeologico degli albanesi d'Italia e di Grecia*. Cosenza.
- BELLUSCI, Papàs Antonio. *Origjina dhe Zhvillimi Historik i Eparkisë Bizantine Arbëreshe e Ungrës në Kalabri dhe Mbrojtja e Identitetit Arbëresh (1439 – 1919)*

- BELLUSCI, Papàs Antonio. *Origjina dhe Zhvillimi Historik i Eparkisë Bizantine Arbëreshe e Ungrës në Kalabri dhe Mbrojtja e Identitetit Arbëresh (1439 – 1919)*
- ÇABEJ, Eqrem (1976). *Studime Gjuhësore, Prishtinë.*
- COMO, D. (1982). *L'entità etno –ecclesiale sicilianoalbanese, në Etnia Albanese e minoranze linguistiche in Italia (përpiluar nga Antonio Guxeta), Palermo.*
- DIDIER, Charls (1831). *Souvenirs de Calabre- les Albanais en Italie 1830. “ Kujtime nga Kalabria – Shqiptarët në Itali”*. *Revue des Deux Mondes, Paris 1831.*
- GERBINO, Gaetano. (2002). *Fjalori arbërisht-italisht i Horës së arbëreshëve. Palermo.*
- GIORDANO, Emanuele. (1963). *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë, Bari.*
- IBRAHIMI, Mustafa (2008), *Shënime udhëtimi mes arbëreshëve të Kalabrisë. Interlingua:Shkup.*
- ISLAMAJ, Shefkije (2008), *Gjuha dhe identiteti, Tiranë.*
- ISMAJLI, Rexhep. (1991). *Diaspora shqiptare. Në “Ora”, viti I, nr.3. Prishtinë (f.32-39).*
- NUSHI, Lirio. (2008) *O e bukura More! Në "Koha Jonë", 27 mars 2008..*
- SHKURTAJ, Gjovalin. (2007) *Ligjerimet arbereshe. Shqyrtime dialektologjike dhe sociologjike tek arbereshet e Italisë/ Arberesh colloquialism. Dialectological and sociological studies in Italy's Arberesh.*
- SHUERIQI, Dh. (1980). *Disa të dhëna mbi folklorin arbëresh të Italisë në vitin 1830. Në “Kultura popullore” nr 1/1980, f.113-132.*
- ZLLATKU, Rexhep (1996). *Me arbëreshët. Shkup.*



Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC _821.18-1.09

Punim studimor

KOSOVARE KRASNIQI

Instituti Albanologjik i Prishtinës

kosovare81@yahoo.com**AGIM VINCA DHE KOSOVA
AGIM VINCA AND KOSOVO**

Përmbledhje

Poezia bashkëkohore shqipe gjatë rrugëtimit të saj nëpër kohë një vend të veçantë i la edhe temës së atdhedashurisë, pjesë e së cilës është edhe tema e Kosovës. Ndjenja e atdhedashurisë është një nga shtytëset më të forta për krijimtarinë poetike, andaj edhe poetët shqiptarë figurën e Kosovës e trajtuan në një varg veprash letrare, mirëpo lloji letrar më i veçantë ku krijuesi shprehet ashtu siç ndihet, është poezia lirike. Kosova, ajo “ gjysma e prerë” e kombit shqiptarë, kaloi nëpër kohë kur pothuajse asgjë nuk përfundonte me një “fund të lumtur”, prandaj poetët figurën e Kosovës e futën në vargje. Një prej poetëve që përmes poezive të tij me tematikë “Kosova” është profesor Agim Vinca i cili si shumë poetë tjerë me këtë tematikë merr “rolin e misionareve” që i shërben kombit përmes poezisë.

Abstract

Summary.

During its time of journey, the contemporary Albanian poetry has kept a special place for patriotism, part of which is the topic of Kosovo as well. The feeling of patriotism is one of the driving forces of poetry, and because of that albanian figures of Kosovo have treated it in many poems, but the literature model in which most of poems were written is lyrical poetry. Kosovo, that "half-cut" of the albanian nation, has gone through difficult times where nothing was ending with a "happy end", because of that poets put the figure of Kosovo in many lyrics of poems. One of the poets who through his poems wrote topics related to Kosovo is professor Agim Vinca, who same as other poets through this topic takes "missionary role" to serve his nation through poetry.

Hyrje

Poezia bashkëkohore shqipe gjatë rrugëtimit të saj nëpër kohë një vend të veçantë i la edhe temës së atdhedashurisë, pjesë e së cilës është edhe tema e Kosovës. Ndjenja e atdhedashurisë është një nga shtytëset më të forta për krijimtarinë poetike, andaj edhe poetët shqiptarë figurën e Kosovës e trajtuan në një varg veprash letrare, mirëpo lloji letrar më i veçantë ku krijuesi shprehet ashtu siç ndihet, është poezia lirike. Kosova, ajo “gjysma e prerë” e kombit shqiptarë, kaloi nëpër kohë kur pothuajse asgjë nuk përfundonte me një “fund të lumtur”, prandaj poetët figurën e Kosovës e futën në vargje. Një prej poetëve që përmes poezive të tij me tematikë “Kosova” është profesor Agim Vinca i cili lirisht mund të themi se merr “rolin e misionareve” që i shërben kombit përmes poezisë.

Tema e Kosovës në letrat shqipe

Tema e Kosovës në letrat shqipe nuk njeh kufi, ajo udhëton herë te një poet e herë te tjetri, duke rrugëtuar kështu në mbarë trojet shqiptare, madje edhe në mërgim, kështu që ndjenjat dhe pasionet atdhetare të poetëve shfaqen pikërisht përmes poezive të tyre. Edhe pse muza për poezinë kushtuar Kosovës kalon poet pas poeti, ndër muzat e cila i dha frymëzim fuqishëm për t'i kënduar Kosovës është muza e poetit Agim Vinca.

Agim Vinca së pari njihet si poet, ndërsa në fushat tjera të letërsisë, emri i tij vazhdon të njihet edhe si, studiues i letërsisë, kritik letrar, historian i letërsisë, antologjist e përkthyes letrar. Vinca është njëri nga krijuesit i cili në opusin e tij letrar, Kosova, zë vend të rëndësishëm. Edhe pse i lindur në një vend tjetër shqiptar, Strugë, vargje i kushtoi më shumë atdheut të tij të dytë, Kosovës. Poezinë e tij për Kosovën e zotëron jeta e kohës. Vinca në poezitë e tij, Kosovën e trajton në motive të ndryshme, si: me motivin atdhetar, me motivin e atdheut të ndarë, me motivin e qëndresës, motive mërgimi, ndërsa në vitet 98-99 më shumë janë poezi me motive lufte.

Ndjenja dhe përkushtimi i tij ndaj poezisë është i veçantë, ai sipas Qosjes “*e ka konceptuar poezinë si mjet në të cilin fut shpirtin e vet dhe ndjenjat e veta; dhe si mjet me të cilin do i shërbej trollit në të cilin ka lindur*” (Qosja, 2008 : 10) por edhe trollit në të cilin ka jetuar, do të shtoja unë. Dashuria ndaj Kosovës, si ndjenjë e pastër, është e shfaqur në gjithë krijimtarinë e tij, mirëpo në një nga poezitë që më së miri na e dëshmon këtë, ku rroket shpirti i tij fuqishëm për Kosovën, është poezia me titull “Nëse të harroj ty, Kosovë”, e botuar në vëllimin “Feniksi”:

*Nëse të harroj ty, Kosovë
Qofsha i harruar!*

(Vinca, 2001:165).

Zogun Feniks e njohim si zog të stuhive, zogun që kurrë nuk iu shëruan plagët, dhe ai prapë qëndron. “Feniksi” (1970) është libri i parë i tij, me titullin e të cilit autori metaforizon Kosovën. Historitë e hidhura nëpër të cilat Feniksi i kalon ai prapë u mbijeton. Njashtu po të njëjtin fat ka edhe Kosova. E bërë shkumb e hi nëpër beteja të ndryshme gjatë historisë por e ringritur prapë nga hiri i vet.

Shikuar në vështrim të përgjithshëm poeti Vinca, Kosovës i thurr vargje qysh kur vije të studioj në Prishtinë, në vitet e 70 -ta. Poema “Kosova në vitet shtatëdhjetë” është njëra nga dy poemat e vëllimit poetik të Agim Vincës, “Feniksi”, që për temë ka Kosovën e viteve shtatëdhjetë. Vargjet e kësaj poezie janë vargje që na lënë të kuptojmë se poeti është duke aluduar në fillimin e një gjendjeje më të mirë ekonomike e shoqërore në Kosovë. Çdo gjë e re që ndërtohet në Kosovë bëhet lajm i ri, gëzim i ri për kosovarët. Hapen shkolla, hapen ambulanca, që Kosovës deri në këtë kohë i mungonin, prandaj subjekti lirik i poemës i gëzohet çdo lajmi të ri i cili fluturon mbi Kosovë. Të tilla lajme vinin rrallë dhe bënë jehonë nëpër gazeta e radio, siç është hapja e një shkolle, për të cilën gëzohen të gjithë. Kosovarët kërkonin dituri, jo se u mungonte dituria, por u mungonin shkollat. Dhe për këtë shembullin më të mirë e jep plaku i moshuar, i cili në pragun e vdekjes si testament të pashkruar lë te djemtë e tij:

*Amanet, o sokolat e mi,
një shkollë ndërtoni!
për shpirtin tim!”*

(Vinca, 2012: 75)

Në vargjet e poemës jepet gëzimi i fëmijëve të vegjël teksa vraponin nëpër rrugë të Kosovës duke u bërë kështu një armatë e fuqishme për të goditur errësirën dhe pushtuar kështjellën e diturisë. Pena e tyre bëhet armë për të luftuar dukurit negative, si vëllavrasja, analfabetizmi, si dhe për të ndërtuar një jetë të re.

Se sa e fuqishme është ndjenja kombëtare dhe afërsia shpirtërore e poetit me Kombin shqiptarë, veçantë Kosovën, e kuptojmë përmes poezive të tij. “Përtej letrës, është ndjenja” dhe ndjenja ishte ajo e cila i dha frymëzim të shkruaj për të, të mendoj për të, po edhe të burgosej për të. Poezia e tij “Pasaporta” është shembulli më i mirë ku poeti shpalos ndjenjat e tij dhe burgosjen e tij për çfarë e kishin akuzuar. Vizita e tij në shtetin shqiptarë, Shqipërinë, pa vizë hyrëse, bëhet shkak i burgosjes së tij. Në poezi poeti bëhet vet narrator dhe bashkëbisedon me heroin lirik të poezisë së tij:

*Më thanë: Ke qenë në Shqipëri.
Po, kam qenë, u thashë*

Pa vizë dalëse, më thanë.

Pa vizë dalëse, u thashë .

(Vinca, 2001: 31)

Ndonëse i pyetur për arsytet e kësaj vizite, subjekti lirik kish qindra sosh, sa edhe pse qëndroi për disa muaj i burgosur, “për të vënë mend në kokë” siç thuhet në poezi, ai prapë me një mosbindje të tillë vazhdon, sepse subjekti lirik ishte i prirur të vazhdoj rrugën prej të cilës kthim s’kishte:

Se unë, përsëri,

Ngado që të nisem do të arrij tek ti,

Shqipëri!

Rrugë tjetër s’di.

(Vinca, 2001: 31)

Pra, përmes subjektit çfarë autori e paraqet në poezi, ne kuptojmë që ai nuk do që të na tërheq vëmendjen vetëm se çfarë i ka ndodhë atij në mënyrë personale, sepse qartas del se poezia është autobiografi e autorit. Uni lirik i tij, përmes gjuhës së bisedës në poezi paraqet atë çfarë vërtet Kosova e ka vuajtur deri në ditët e çlirimit.

Dhe siç ecën koha, ashtu edhe letërsia ecën në periudhat e saj kohore, ndërsa bashkë me letërsinë edhe poezia. Fillimet e viteve të 90 ta Kosovën e gjejnë nën dhunën dhe presionin më të egër serb, dhe pena e tij s’kishte më si të ndalej kur çdo gjë e ndodhur në Kosovë të jepte frymëzim, dhe ndjenjat e poetit shfaqën hapur kundër padrejtësive që po i bëheshin popullit të Kosovës. Pasqyrimin më të mirë për një gjendje të tillë, na jep poezia “Prishtina në pranga”, kur poeti paraqet qiellin të mbushur me aeroplanë, ndërsa rrugët e mbushura me autoblanda, policë e udbashë në të katër anët e Kosovës. Në rrugët e Prishtinës u lejohet të ecin nëpër vetëm tankeve dhe pizguavere. Dhe populli i Kosovës e jetonte jetën nën hijen e tyre, nën zhurmën e bubullimave dhe krismave të tyre, por edhe me pranga në duar e pranga në gojë.

Revoltën për gjendjen e rëndë të jetës në Kosovë, përmes poezive të tyre nuk e shfaqën vetëm poetët kosovarë, por edhe poetët nga Shqipëria e viset tjera shqiptare. Poeti nga Shqipëria që ka trajtuar temën e Kosovës me gjuhë të thjeshtë por me mesazh të qartë është Dritëro Agolli. Mirëpo, ndonëse Agolli i këndon Kosovës me një dashuri prej së largu pa qenë i pranishëm në Kosovë, Agim Vinca ishte poeti i cili i përjetonte këto ngjarje me vet qenien e tij. Subjektin për Kosovën autori e vjelë nga ngjarjet të cilat ndodhen gjatë viteve andaj ai përmes poezive të tij, na kompletton Kosovën me një mozaik imazhesh, subjektesh e motivesh nga më të ndryshmet. Poezia e tij sjell para lexuesit Kosovën në formën e një vashëze për të cilën poeti ka mall. Poeti është mallëngjyer për çdo gjë në Kosovë.

Zëri i tij lirik paraqet Kosovën si një vashëz me flokë ngjyrë gruri, me mollëza të kuqe si molla dukagjini, ka mall për zërin e saj që rrjedh si uji gurgullues i Moravës, dhe për sytë e saj të blertë e të butë. Nostalgjia për Kosovën poetin e vret dhe në mall për Kosovën krijon vargje për të:

*Kam mall për flokët e tu ngjyrëgruri
Tufë kallinjsh të pjekuar arave të Kosovës.
Kam mall për mollëzat e tua të kuqe si mollë dukagjini.
(Vinca, 2008 : 215)*

Pra, poeti Vinca ne vargjet e poezive te tij eksploron figura të larmishme artistike dhe stilistike me mjeshtri të lartë poetike dhe me paraqitjen e lirizmit në poezi, poezitë e poetit Vinca bëhen të admirueshme.

Gjatë viteve 1997-1999, kur veç del në skenë edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, tema e Kosovës zgjerohet me motive të reja. Tashmë poetet kosovarë krahas motiveve të tjera shkruanin poezi kushtuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës etj. Fati i Kosovës ishte gjithnjë brengosës për poetet shqiptare, sidomos kjo ishte edhe më e dukshme kur filloi lufta e viteve 1998- 1999. Se cili do të ishte kuptimi i një poezie pa Kosovën brenda, kur populli i saj po përjetonte dhunën e dhembjen më të egër pushtuese nga regjimi serb dhe në c'situatë të rëndë ishte populli i saj, këtë më së miri e shprehën poetet në poezitë e tyre.

Në mes poetëve të tjerë edhe poeti Agim Vinca me vargjet që i kushtoi Kosovës dhe shqiptarëve e qëndresës në shekuj të tyre. Pra, ai në vargjet e tij, Kosovën jo vetëm që e metaforizon, por edhe e kthen në simbol dhe, në fund, edhe në mit. Miti i Kosovës në poezi krijohet përmes mitizimit të rrëfimit për të, kështu, që në një poezi të Agim Vincës, përmes përmendjes së Mollës së Eridës, ngjallet miti i grindjes, si pasojë e të cilit ndodhin të gjitha peripecitë që i pëson subjekti lirik në vazhdimësi:

*Ballkani (s)është fuçi baruti.
Kosova (s)është mollë e Eridës.
(Aforistike) (Vinca, 2001: 81)*

Pra, Kosova kthehet në mollë grindjeje, në mes të atyre që e banojnë dhe të atyre që e lakmojnë. Në poezinë tjetër të Agim Vincës, “molla e Eridës” sqarohet. Molla e Eridës është Kosova, në të cilën, në rrëfimin mitizues, rriten binjakë, por të cilët kanë prirje të ndryshme:

*Kosova: djep i Shqipërisë!
Kosova: djep i Serbisë!
Kosova: djep që rrit binjakë!
Njëri kërkon të thithë qumësht në gji;*

Tjetri të pijë gjak.

(Kosova) (Vinca, 2001: 138)

Mesazhi i saj është i qartë. Emri “Kosovë” është në mesin e dy binjakëve aspak të ngjashëm me njërin-tjetrin. Antiteza e përdorur nga autori, e cila vendos dy tablo të kundërta në të njëjtën kohë, bën përshkrimin e gjendjes reale në Kosovë . E shkruar në Janar të vitit 1997, atëherë kur Kosova veç gjendet në prag të luftës. Situata tashmë në Kosovë kur poeti i shkruan këto vargje është e tensionuar prandaj zëri lirik i tij përmes këtyre pesë vargjeve i kundërvihet kësaj situatë.

Në poezinë “Natyre e qetë” jepet peizazhi real i Kosovës gjatë kohës së luftës. Peizazhi i Kosovës këtu jepet i zbrazur nga vendësit e saj. Titulli është një paradoks me rrëfimin në poezi.

Dhuna që ushtrohet nga policia dhe ushtria serbe ndaj popullit të Kosovës, bën që shumë kosovarë të ikin nga toka e tyre e zhuritur, nga toka e djersës së tyre. Katunde që digjen në flakë, shtëpi të lëna shkretë, sorra që shqyejnë trupa njerëzish ishin pamjet e shpeshta që hasin fshatarët në shtëpitë e tyre, ndërsa këtu janë vargjet me të cilat fillon poezia.

Rimorkio traktoresh deng me gra e fëmijë

E pleq te rrjedhur me laqe e lot ne sy

Qe qajnë e qeshin si ciliminje.

Qielli i vrenjtur njerëz fjalëpakë.

Një nënë që mënd foshnjën e saj.

(Vinca, 2007: 18)

Ngjarjet reale të dëgjuara apo edhe të treguara nga vetë përjetuesit e frymëzojnë poetin Vinca, andaj ai i dha fuqi fantazisë në vargjet e tij, ku bartë ankthin për njerëzit e vendit të tij.

“Muza e mëmëdheut” është libër antologjik që ka përfshirë njëqind poet me nga një poezi, nga të gjitha trojet shqiptare, sepse “Se atdheu është i të gjithëve, dhe jo pronë e njëres apo tjetres palë” thotë poeti Vinca në parathënie. Se jo të gjithë jemi atdhedashës na e paraqet poezia “Atdhemohonjësi” të cilën poeti Vinca e fut në antologjinë e tij. Poezia e poetit elbasanas Thanas Konomi, një figurë e heshtur në letërsi, që nga titulli na bëhet e qartë se poeti është i revoltuar me atdhemohuesit, keqtrajtuesit e atdheut të tyre. Popullin shqiptarë tradhtia e ka përcjell ndër shekuj, andaj përkundër të tjerëve që shkruanin poezi atdhedashurie, Konomi i kthehet nga një horizont tjetër, tradhtisë së atdheut, më konkretisht tradhtarëve të saj. Imazhi prekës në mes nënës “atdhedashëse” dhe djalit të saj “atdhemohonjes”, është motivi që zotëron poezinë. Biseda në mes të nënës së vetme, nënës “me sisë të mallkuar” dhe djalit paraqet krenarinë e nënës shqiptare dhe turpin e djalit të saj i

cili i penduar, përkulet para derës së shtëpisë, dhe e lut nënën t'ia hap derën e shtëpisë.

*“Hape, nën’jam djali tënd,
Jam Petriti, bir i vetëm, që kam ler’ në këtë vend...
Hape shpejt, se jam këputur, po jap shpirt e me s’duroj,
Më rreh ballin er’ e vdekjes hape, nën’ se po mbaroj
(Vinca , 2012 : 66)*

Dhembja dhe krenaria luftojnë në shpirtin e nënës plakë, mirëpo megjithë dhembjen për të birin e saj, ajo nuk e fal për tradhtinë e bërë. Edhe pse tashmë një djalë ia kishte falur luftës, dhe i kishte mbetur djali i vetëm, ajo prapë, nuk ia hap derën. Indiferecën e nënës për djalin e saj tradhtar e japin vargjet:

*Unë skam djalë’, i thot’ nga brenda, nën’ e zezë e pikëlluar,
Një, që kesh, ma mori zoti dhe një tjetër ka mohuar
atë tokë, ku, së pari, kishte shkelur këmb’ e tij.
Djalin tim të mallkuar, nuk e dua të më vije!*

Pra, gjithë poezinë e përcjellë një gjendje e ftohët, e akullt, mirëpo vargjet në poezi janë në rrjedhë harmonishme me njëra pas tjetrën sa momenti më i bukur, por edhe më i trishtuar i gjithë leximit të poezisë është ai kur vije tek vargjet e fundit.

Përfundim

Arshi Pipa në librin e tij *“Kritika, esse 1940- 1944” për detyrën e kritikut shkruan* “detyra e kritikut është me dallua të mirat dhe të këqijat e veprës” (Pipa, 2006 :27). Për t’i hedhur në dritë mendimet e mija për këto poezi për Kosovën, si studiuese e re e çmoj mendimin e Arshi Pipes, sa mund të them se nuk është detyrë e lehtë e një kritikuri për t’i gjetur të mirat dhe të këqijat në krijimtarinë e Vincës, sidomos në vorbullën e gjithë atyre poezive të krijimtarisë së tij. Mirëpo përderisa më është dashur të “notojë” nëpër vargjet e krijimtarisë poetike të tij, nuk hasa në ndonjë poezi me subjekt amorf, por poezi të cilat që në leximin e parë të magjepsin sa jo rrallë herë gjatë leximit të poezive për Kosovën mendoja: Me ç’imazh të fuqishëm por edhe të dashur e paraqet poeti Vinca, Kosovën! Besnik Mustafaj për poezinë e tij, thotë *“Agim Vinca është poet që e ka jetuar dramën e popullit të vet dhe ka gjetur gjuhën universale për ta shprehur atë”*. Syrit të tij vrojtues prej poeti nuk i ikin ngjarjet nëpër të cilat kaloi realiteti kosovar. Në disa nga poezitë e tij, subjektin e realizon nën prizmin objektiv të ngjarjeve, të cilat ai i përjeton fizikisht e shpirtërisht. Vinca në poezitë e tij ka ndër futur artistikisht shumë ngjarje të cilat ndodhën në Kosovë dhe duke na kujtuar që për lirin e Kosovës sakrifikuan jetë shumë të rinj student. Dhe në poezinë e poetit Agim Vinca, në të cilën paraqitet dashuria për

atdheun nga ana e studenteve, është edhe poezia me titull “Provim”. Shikuar nga viti kur është shkruar 1998, atëherë kur çdo i ri i bashkohej Ushtrisë Çlirimtare, profesori ndikuar nga mungesa e studentëve të tij, në sallën gjysmë të zbrazur dhe i frymëzuar nga dashuria e studentëve të tij për atdheun, shprehet:

Mungon Drenica e Dukagjini...

Tani atje jepet tjetër provim.

(Vinca, 2001: 164)

Mungonin ata studentët që ishin prej pjesëve ku zhvilloheshin luftimet kundër forcave serbe. Në këto pak vargje shihet madhështia që u bën poeti studenteve të cilët e ndërprejnë fakultetin për t’u bashkuar aradheve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sa i përket temës për Kosovën në letërsinë shqipe, kritikët shqiptarë vlerësojnë se për këtë temë në hapësirën shqiptare është shkruar shumë më pak, në krahasim me vendet tjera. Akademiku Rexhep Qosja merr shembull përkushtimin serb ndaj temës së Kosovës dhe përkushtimin shqiptarë ndaj vet vendit të tyre. Sipas Qosjes, ka një shpërpjesëtim të madh në mes veprave shqiptare me temë Kosovën dhe atyre serbe, po me këtë temë. *Tema e Kosovës në letërsinë serbe është shumëfish më e pranishme se kjo temë në letërsinë shqipe*. - thotë Qosja. (Qosja , 2010: 322)

Andaj, si përfundim, sa i përket punimit tim, jam munduar që përmes një trajtimi pak më të gjerë dhe të analizës kritike të poezive te Agim Vincës të këtij poeti i cili, Kosovës i dha motive poezish nga më të ndryshmet, të arrij të jap një pasqyrë të qartë të pranisë apo të mospranisë së temës së Kosovës në poezinë e tij.

Ndërsa merita dhe falënderimi në trajtimin e figurës së Kosovës u takon poetëve të cilët e skalitën Kosovën në poezitë e tyre dhe me penën e tyre u dhanë jehonë ngjarjeve nëpër të cilat kaloi Kosova në shekuj, po edhe deri në ditët tona.

Referenca

- PIPA, Arshi. (2006). Kritika, esse 1940- 1944, Princi, Tiranë.
- QOSJA, Rexhep, (2010). Semantika e ndryshimeve historiko-letrare. Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- VINCA, Agim. (2007). “Psalmet e rrënjës”, Brezi 9, Tetovë.
- VINCA, Agim. (2002). Muza e Mëmëdheut njëqind poet për Atdheun, ANTOLOGJI Uegen Tirana -Artini Prishtinë.
- VINCA, Agim. (2001). Sonet i vetmuar, Ombra GVG, Tiranë.
- VINCA, Agim. (2007). Fije të pakëputura. Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë.
- VINCA, Agim. (2008), Letër zotit, Toena, Tiranë.
- VINCA, Agim. (2012), Feniksi, Këshilli i Rinisë Evropiane të Kosovës, Prishtinë.

ANAS

Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 811.18'373.46:28

Punim studimor

AJTEN HAJDARI-QAMILI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare

Universiteti "Shën Kirili e Metodi" Shkup, MAQEDONI

E-maili: teni79@yahoo.com**TERMINOLOGJIA ISLAME NË TEKSTET E PËRKTHYERA
NË GJUHËN SHQIPE****ISLAMIC TERMINOLOGY AT TRANSLATING TEXTS INTO
ALBANIAN**

Përmbledhje

Për shkak të besimeve të ndryshme ndër shqiptarë, terminologjia fetare është e larmishme. Po ç'ndodh brendapërbrenda teksteve të së njëjtës fe? A ka larmi apo njëjtësim terminologjik të këtyre teksteve? Cilat fjalë dhe shprehje janë më problematike gjatë përkthimit? Cilat janë shkaqet e mosnjëjtësimit terminologjik? Përkthimet e shumta që po bëhen kohëve të fundit të librave me karakter fetar nga njohës dhe mosnjohës të mirëfilltë të terminologjisë islame, të natyrës së shqipes dhe të vlerës së përpiktë semantike-leksikore të disa fjalëve, për shkak të komercializimit të përkthimit dhe të tendencave dhe qasjeve të ndryshme gjuhësore, kulturore, ideore dhe politike, bëjnë që të hasim shumëllojshmëri të terminologjisë islame. Në këtë kumtesë bëjmë analiza, krahasime dhe japim vlerësime se cilat fjalë ose togfjalësha duhet të unifikohen dhe cilat fjalë ose togfjalësha duhet të mbeten në formën arabe.

Fjalët çelës: *përkthime, terminologjia islame, shqip, laramani, njësim.*

SUMMARY

Because of different faiths among Albanians, religious terminology is varied. It is what happens within the same religious texts? Does the variety or terminological identification of these texts? What words and phrases are most problematic in translation? What are the causes of notification terminology? Numerous translations being made recently to books of a

religious nature by the expert and non-knowledge genuine Islamic terminology, the nature of the Albanian language and the value of meticulous semantic and lexis of few words, because the commercialization translation and trends and approaches different linguistic, cultural, ideological and political, related to face various Islamic terminology. In this paper we analysis, we compare, and give estimates which words or syntagmas should be unified and which words or syntagmas should remain in the Arabic form.

Key words: translation, Islamic terminology, Albanian language, diversity, unification.

HYRJE

Leksiku fetar përbën një nga fushat më të strukturuar dhe më të rëndësishme të leksikut të shqipes. Kjo është njëra nga fushat e para të leksikut të shqipes që ka nisur të lëvrohet dhe t'u nënshtrohet proceseve të shqipërimit, të përpunimit gjuhësor, të përshtatjes dhe të standardizimit qysh kur filloi të shkruhet shqipja në shekullin XV.

Përkthimet e librave me karakter fetar nga përkthyes të ndryshëm, të cilët mund të jenë njohës apo mosnjohës të mirëfilltë të terminologjisë islame, të natyrës së shqipes dhe të vlerës së përpiktë semantike-leksikore të disa fjalëve, për shkaqe të ndryshme objektive dhe subjektive, bëjnë që të krijohet laramani në përdorimin e terminologjisë islame. Dhe jo vetëm terminologjia, por edhe strukturat sintaksore dallojnë nga një përkthim në tjetrin, varësisht nga mënyra e perceptimit të formës origjinale nga përkthyesi dhe nga stili i tij i shprehjes.

Islami si fe dhe shkencat e islamistikës, për shkak të veçorive dhe specifikave të tyre, kanë terminologjinë e vet, të ndryshme nga çdo terminologji tjetër. Dhe, vetëm ajo është në gjendje t'i shprehë porosinë e së vërtetës islame. Një përkthyes i nivelit mesatar, nuk mund të sjellë në jetë asnjë tekst, në qoftë se nuk ka njohuri të thella në gjuhë dhe dije të mjaftueshme në teologjinë islame.

1. ANALIZA DHE SHITJELLIMI

Në Maqedoni, zakonisht, përkthehen tekste të fesë islam nga arabishtja, turqishtja dhe nga boshnjakishtja, prandaj përkthimi dhe interpretimi është i larmishëm, varësisht nga teksti origjinal, por edhe nga perceptimi dhe aftësia e përkthyesit. Madej edhe përkthimet e Kur'anit që bëhen drejtpërdrejt nga arabishtja në shqip, përsëri janë të larmishme. Kjo, sepse arabishtja është një gjuhë aq e pasur dhe e veçantë, saqë vështirë se mund të përkthehet në cilëndo

gjuhë botërore dhe të mund të përmbushë kërkesat e plota semantike të të gjitha fjalëve.

Promotore e terminologjisë islame në Maqedoni ishte gazeta *Hëna e Re*, pastaj vazhdoi Shtëpia botuese Logos-A, pastaj Furkan, NUN; ASR, revistat *Vepra*, *Ftesa*, *El-Medina*, *Ikre*, *Dritarja* etj., kështu që kohëve të fundit kemi një mori librash, fletushkash, librushash, fletëpalosjesh dhe revistash islame, por me terminologji të panjësuar. Për këtë arsye bazë e këtij studimi, janë pikërisht librat e botuar në këto shtëpi botuese.

Variantet e Kur'anit të përkthyer në shqip, por edhe të Haditheve dhe të librave me lutje duhet të vështrohen më shumë si përpjekje për gjetjen e formës më të përshtatshme të tij në shqipen, sepse ende kanë zbrazëtira, keqkuptime, paqartësi në mendime, fjali dhe mendime të palogjikshme ose të papërfunduara. Këto tekste duhet të jenë jo vetëm shumë afër origjinalit, por edhe shumë afër gjuhës së gjallë në të cilën përkthehet dhe gjithmonë duke mbajtur parasyshe dhe drejtshkrimin e gjuhës standarde dhe normën letrare, sepse ndodh që shpesh të shkelet norma letrare ose të ketë dialektizma. Përkthimin e Kur'anit nuk e bëjnë dot vetëm as arabologët e as teologët, sepse lypset ta bëjnë stilistë me përvojë, gjuhëtarë të pjekur dhe redaktorë me ndjenjë të hollë për tekste poetike. Terminologjia fetare, gjegjësisht fjalët e Zotit, është shumë më vështirë të përkthehen, krahasuar me tekstet e fushave të tjera të jetës, sidomos kur bëhet fjalë për përdorimin e disa sinonimeve të përafërta me dallime ngjyrimesh kuptimore dhe të fjalëve shumëkuptimëshe (polisemantike), të cilat nuk janë të pakta në terminologjinë islame (në gjuhën arabe). Këto fjalë asnjëherë nuk mund të gjejnë një barasvlerës të plotë apo fjalë përkatëse në shqipe, sepse nuk ndodh që e njëjta fjalë t'i ketë të gjitha kuptimet që mund të ketë në arabishte, si p.sh. fjala *ikre* që ka kuptimin "lexo", "mëso", "vepro" ose fjala *xhuma* "e premtë", "tubim", "namazi i së premtës" e të ngjashme. Në raste të tilla përkthyesit duhet të radhisin të gjitha fjalët që bartin kuptimin e fjalës në arabisht.

1.1. Kalkime të panatyrshme

Ndërkaq, në rastet kur në leksikon tonë nuk ka fjalë përkatëse, shpesh përkthyesit krijojnë fjalë të reja përmes kalkimit, por shpesh ato nuk dalin sipas natyrës së shqipes, prandaj hasim laramani fjalësh të tilla, si p.sh.: për Rrahman: *Mëshirues*, *i Mëshirshëm*, *i Gjithëmëshirshëm*, *Bamirës*, *Ndjesëmadh*, *i Plotmëshirshëm*, kurse për Rrahim: *i Dhembshueshëm*, *Përdëllimtar*, *Mëshirëbërës*, *Mëshirëplotë*, *Mëshirëshumë* etj. (Sipas komentuesit Ibën Kethiri fjala *Rrahman* është superlativi i fjalës *Rrahim*).

Do të përpiqem të jap një shpjegim më të hollësishëm për këto dy sinonime të përafërta. Nëse këto dy leksema të Kur'anit përkthehen njëlloj në shqip, atëherë, përpos dallimeve të tjera, atyre u mungon edhe vlera paradigmatiche, sepse secila paradigmë ka kuptim të veçantë, që nuk e kanë të tjerat. Pra, fjalët që shënojnë këto dytribute të All-llahut *Er-Rrahman* – Gjithëmëshirshëm (الرَّحْمَانُ) dhe *Er-Rrahim* – Mëshirëplotë (رَحِيمٌ), kanë të njëjtat mashkëtingëllore në rrënjët e tyre: R (ر), H (ح) dhe M (م), gjegjësisht kuptimi themelor i rrënjëve është i njëjtë, prandaj gjatë përkthimit është bërë lojë me fjalë, si: *Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë, Mëshirëshumë, Bamirës, Përdëllimtar, Shumë i mëshirshëm* etj., d.m.th. janë dhënë si sinonime të pjesshme ose të përafërta. Ajo që i dallon këto dy sinonime është vlera paradigmatiche, sepse në arabishte ka një rregull: “Nëse një fjale i shtojmë mbaresë, kjo tregon se fjala ka shtrirje më të gjerë kuptimore.” (Junus, Muhamed Dhenun, 2009: 180). Paradigma e leksemës së parë ka pesë shkronja në temë të fjalës (رحمان –r-h-m-elif-n), e dyta ka katër shkronja (رحيم – r-h-m-j-n), prandaj në bazë të rregullit të sipërpërmendur, atributi *Er Rrahman* (الرحمان) ka kuptim më të gjerë, sesa atributi *Er Rrahim* (الرحيم). Ibn Kajim-i thotë: „A nuk e shihni se *Er Rrahim* shpesh lidhet edhe me fjalë të tjera, si “*Për besimtarët është Er-Rahim (Mëshirshëm)*” (El-Ahzab, 43), kurse fjala *Er Rrahman* nuk lidhet me asnjë fjalë tjetër, sepse aty bëhet fjalë për mëshirë gjithëpërfshirëse e jo për ndonjë pjesë të caktuar”. (Omer Sulejman el-Eshkar, 2008: 36). Ky dallim vërehet edhe nga vetë paradigma, sepse në paradigmën e fjalës së parë ka më shumë shkronja.

Vlen të theksojmë se sasia e elementeve të njëjta në këto dy fjalë, me të cilat konstatojmë që këto fjalë janë sinonime, nuk mund të përcaktohet saktësisht, sepse një varg fjalësh që llogariten si sinonime, duhet të vështrohen nga këndvështrime të ndryshme, proces ky që nuk është aq i lehtë. (Лата, Зибер, 2016:82).

1.2. Mosasimilimi në gjuhën shqipe i termave orientale

Termet fetarë të besimit islam me burim oriental ndihen të paasimiluara mirë në gjuhën shqipe (*Krishterimi ndër shqiptarë*, 2000: 45), sepse gjuha fetare është komplekse dhe e rëndë për përkufizime shabllone. Pikërisht për këtë në krijimin e terminologjisë fetare islame në gjuhën shqipe konceptet islame duhet të mbështeten me analiza fenomenologjike dhe ekzistencialiste.

Lidhur me terminologjinë, por edhe me përkthimet e togjeve dhe fjalive të tëra ka shumë laramani. Si shembull mund të marrim

vetëm duanë *Sejjidul – istigfar* ose duaja e kërkimit të faljes: *Allahumme ente rabbi, la ilahe il-la ente, halakteni ve ene abduke ve ene ala ahdiqe ve va'dike mesteta'tu eudhu bike min sherri ma sana'tu ebu-u leke bi ni'metike alejje ve ebeu bi dhenbi, fagfir li, fe innehe la jagfirudh-dhunube il-la Ente.* për të treguar variante të ndryshme. Në tabelë kam vendosur vetëm pesë variante në shqip të kësaj duaje, të cilën e kam ndarë pjesë-pjesë për t'u vërejtur më qartë dallimi i tyre:

| | | | | |
|---|--|---|---|---|
| Kalendari islam i vitit 2016 / 1437, Komuniteti mysliman turk, Shkup, 2016. f. 404 dita e 202 | Seid El-Kahtani, <i>Mburoja e muslimanit me lutjet e Kur'anit dhe Sunnetit</i> , 1430 / 2009, Shkup, f. 91. (përkthyer nga Rexhep Lushta, lektor Roald Hysa) botimi XI | <i>Lutjet e jetës nga Kur'ani dhe Hadithi</i> , Logos-A, Shkup, 2001 / 1421, f. 47. (përkthyer nga Ymer Musa) | H. Naim Haxhiabdiq, <i>Ilmihal për shkallën e tretë të mësim besimit</i> , Shkup, 1411 / 1990, f. 188. (përkthyer nga Qufli Osmani) | Ramiz Zekaj dhe Sh.B. "Furkan ISM", <i>Drita e zembrës Duatë dhe jasini</i> , Shkup, 2001, f. 52. |
| Allahu im, Zoti im je ti, nuk ka zot tjetër veç teje. | O Allah, ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje; | O All-llahu im, Ti je Zoti im, nuk ka hyjni tjetër pos Teje, | O Zot, Ti je Zoti im! S'ka tjetër Zot pos Teje! | O All-llah Ti je Zoti im, nuk ka Zot tjerët pos Teje, |
| Mua Ti më krijove dhe unë jam robi yt. | Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, | më ke krijuar e unë jam robi Yt. | Ti mua më ke krijuar dhe unë jam robi Yt! | unë jam krijesa Yte, |
| Unë jam mbi fjalën që të kam dhënë ty për sa kohë jam i aftë dhe i besoj premtimit tënd. | do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd, sa të kem mundësi; | Unë i përmbahem besëlidhjes dhe premtimit Tënd aq sa mundem. | Unë përpiqem me këmbëngulje të jem në atë fjalë dhe premtim, të cilën Ta kam dhënë! | do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit tënd sa të mundem, |
| Mbështetem tek ty nga e keqja e atyre që kam | Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam | Kërkoj mbrojtje te Ti nga e keqja e asaj | Kërkoj që të më largosh nga të këqijat e veprave të | kërkoj që të më mbrosh prej të keqes që e kam bërë, |

| kryer. | vepruar, | që kam vepruar. | mija! | |
|--|---|--|--|---|
| E pohoj mirësinë që më ke dhënë. Pohoj edhe gjynahet e mi. Fali gjynahet e mi, | Unë pranoj se më ke begatuar me dhunti, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal, | Pranoj para Teje për dhuntinë Tënde ndaj meje dhe pranoj gjynahun tim. | <u>Prandaj!</u> mirësitë dhe nimetet Tua të cilat m'i ke dhënë dhe të falënderohem Ty për to! Gjithashtu, unë pranoj para Teje gjunahet e mija, dhe turpërohem për ta! | unë jam mirënjohës ndaj dhuntive Tua, i pranoj gabimet, më fal, |
| sepse nuk ka tjetërkënd që të më falë gabimet pos teje. | ngase mëkatet nuk i fal askush tjetër përveç Teje. | Më fal sepse nuk ka kush që i falë gjynahet veç Teje. | Dhe, ja Rabbi, Ti mua falmi gabimet e mija! Sepse gjunahet askush nuk mund t'i falë pos Teje | ngase gjunahet nuk i fal kush pos teje. |

Tabela 1. Analiza krahasimtare e duasë së kërkimit të faljes

Nga kjo tabelë krahasimtare vërehet se vetëm në këtë dua hasen aq shumë alternativa, qofshin terminologjike, qofshin sintaksore, por edhe drejtshkrimore e logjike. Po numërojmë vetëm disa:

1. *zot / i adhuruar / hyjni / Zot / Zot - për fjalën ilah;*
2. *fjalën e dhënë / marrëveshjen / besëlidhjen / me këmbëngulje të jem në atë fjalë / marrëveshje;*
3. *mbështetem tek ty / kërktoj mbrojtjen Tënde / kërktoj mbrojtje te Ti / kërktoj që të më largosh / kërktoj që të më mbrosh;*
4. *e pohoj mirësinë që më ke dhënë / pranoj se më ke begatuar me dhunti / pranoj për dhuntinë Tënde ndaj meje / Pranoj mirësitë dhe nimetet Tua të cilat m'i ke dhënë / jam mirënjohës ndaj dhuntive Tua;*
5. *gabimet / mëkatet / gjynahet / gjunahet / gabimet-gjunahet.*

Jo vetëm në këta shembuj, por edhe në të gjitha librat e fesë islame që kemi analizuar për të njëjtat sema dhe rema, si: *Zot, Allah, All-llah, Hyjni, Perëndi, i Adhuruar; gjynah, gjunah, mëkat, gabim; profet, pejgamber, i dërguar; sabah, mëngjes; haram, e ndaluar; nimet,*

begati, mirësi, dhunti; hadith, traditë; ajet, vargje Kur'anore etj. u ndeshëm me terminologji të larmishme.

1. Analiza e termave islame

1.1. Termat: *Allah, Zot, Perëndi, Hyjni*

Për të trajtuar vetëm disa nga termat më thelbësorë ose çelës të terminologjisë islame, mund të fillojmë me vetë emrin *Allah, All-llah, Zot, Perëndi, Hyjni, Rabb, Ilah, i Adhuruar* etj. Siç dihet, nga ana etimologjike *Zot* është fjalë e vjetër me burim autokton, e krahasuar me gr. *Zeus* e me lat. *Deus*. Ka qenë së pari fjalë e sferës jofetare, që ka kaluar më pas si fjalë e leksikut fetar të të gjitha besimeve. Fjala *Perëndi* me etimologji të diskutuar, mbahet më shumë si e burimit latin, nga lat. *imperantem*, pjesore e foljes *imperare* “sundoj, urdhëroj, zotëroj”. Fjala *Hyj, Hyjni* është fjalë me përdorim dialektor në veri të Shqipërisë dhe kryesisht te besimtarët katolikë. Është fjalë shqipe, sipas E. Çabejit, një krijim i P. Bogdanit, shumës i singularizuar i fjalës yll. Kjo fjalë ka krijuar çerdhe fjalësh, si: *hyjni, hyjneshë, hyjnor, i hyjnishëm, hyjnizoj* etj. (Çabej, Eqrem, 1996: 385).

Fjala *Allah* është emërtim vetëm për Krijuesin e gjithësisë, është emri i përveçëm i Zotit. Në Kur'an, në arabisht shkruhet me dy *ll* (All-llah) dhe kështu duhet ta përdorim edhe në shqip, sepse kjo lidhet me mënyrën e të shqiptuarit sikurse në arabisht, pra me një zgjatje, gjegjësisht dyfishim të *ll*-së. Termin *Zot* mund ta përdorim për termat *rabb* dhe *ilah*, që përdoren në Kur'an, por për All-llah, nuk është e mundshme, sepse fjala All-llah shënon konceptin islam të Zotit ose, siç thamë, është emri vetjak i Zotit; *All-llah* (Behxheti, Ahmet, 1994: 219-220). është term shumë i vjetër me burim semit, sepse edhe në librat e shenjtë Tevrat (Tora) dhe Inxhil (Ungjill) përdoret forma *Eloh* (Shih: www.hebrewletters.com) për të njëjtin qëllim siç është edhe në Kur'an (AShAK, FSI, Mehdiu, Feti, 2006: 43) edhe në librat e tjerë islamë me lutje ose shpjegime. Ndërsa tek Aniq-i për fjalën *Allah*, thuhet: (arabisht) “i vetmi perëndi, krijuesi i botës, i amshueshëm, i padukshëm, i gjithëpranishëm, i gjithëfuqishëm dhe i gjithëdijshtëm. Në Kur'an përmenden gjithsej 99 epitete të emrit të All-llahut, së bashku me All-llah bëhen 100. Në fjalorin e T. Dizdarit thuhet kështu: “ALLÀH-U, por në Kosovë e Dibër Allàh-i (tur.<ar. Allah الله) Zot, Perëndi, Hy, krijues i rruzullimit simbas besimit e përfytyrimeve fetare mistike. Shprehje para 30 vjetësh: *Allahu baftë merhamet. Allahu na ruejtë prej gazepit të zullumqarit. Ashtu ka qenë emr'i Allàhut, exhelit s'i delet para. Aman jarabi! hyqmetet e Allàhut s'kanë të mbaruem.*” (Tahir Dizdari, 1980: 22). Kurse në fjalorin shpjegues thuhet kështu: “Allah-u emër i gjinisë mashkullore, term ose shprehje fetare e

vjetër. Zoti, sipas paragjykimeve të besimit mysliman.” (ASHASH, 1980: 26).

Përdorimi i emrit të përveçëm All-llah ka edhe nuanca stilistike në gjuhën shqipe, sepse nëse dikush thotë *Zoti e pastë bekuar!* dhe *Allahu e pastë bekuar!*, kuptohet qartë se në rastin e dytë kemi të bëjmë me folës mysliman, kurse në rastin e parë mund të jetë edhe i krishterë. (Ibrahimi, Zeqirija, 2014: 121). Andaj le të mjaftojë këtu konstatimi se emri i përveçëm *Allah* duhet të qëndrojë në literaturën teologjike islame, këtu për shkaqe praktike e teologjike, por edhe në tekstet e tjera kur i referohemi *Zotit* në fenë islame, ngase ky emër me vete bart edhe elemente me nuanca të tjera kuptimore, duke formuar një varg shprehjesh e frazash që e kanë pasuruar fondin e shqipes. (Ibrahimi, Zeqirija, 2014: 123).

2.2. Termat: *haram* dhe *hallall*

Nëse analizojmë termat *haram* dhe e ndaluar, që merren si sinonime ose kështu përkthehet në tekstet shqipe, nuk është e njëjta gjë, sepse e para lidhet ngushtë me gjërat apo veprimet që janë të ndaluara sipas rregullave (shariatit) të islamit, kurse e dyta ka kuptim shumë më të gjerë. Në Fjalorin e orientalizmeve të T. Dizdarit shkruhet: “HARÂM – I (*m.*) ndalesë kategorike nga ana e fesë; e kundraligjshme; ant. hallall. Për besimtarët musliman janë *haram* në mënyrë të theksueme: dejmenija, bixhozi, kurvënimi, vjedhja, rushveti, para me faiz etj. Ke Bardhi *haram* “*mallëkuem*”; “Dieb” G. Meyer EW--, Weigand DAW 118, që e kanë për turqizëm; sh. dhe Jungg 44, Bashkimi, Buseti 147, 429, Leotti 335 (ku dhe *haramxhi*), Cordignano 55, 57, FGS 164. Arab. *haram* حرام (*khs. hebr. kherem* ke Gazulli 50). *Sekr.* *haram* “prokletstvo”: *haram* tebi materina hrana: *haramljvanje*; foljet *haramiti*, *haramljivati* – Vuk 717, Bakotic 1319; *Bulg., rum. haram*; *Gr. rë.*

E njëjta gjë vlen edhe për fjalët *hallall* dhe e lejuar, pra e para lidhet ngushtë me shariatin e islamit, kurse e dyta ka kuptim shumë më të gjerë.

2.3. Termat: *pejgamber* - *profet* - *i dërguar*

Termet *pejgamber* - *profet* - *i dërguar* në tekstet e përkthyer në shqip shpesh zëvendësojnë njëri-tjetrin, por sa janë të njëjtë apo të përafërt dhe ku qëndron dallimi, do ta zbërthejmë në vijim. Termi *pejgamber* edhe në literaturën islame ndërmjet dy luftërave botërore është përdorur paralelisht me termin *profet*, por më e drejtë është që të përdoret termi *pejgamber* për dy arsye: e para, sepse kjo rrjedh nga persishtja (*pejgam* “lajm” dhe *ber* nga infinitivi *burden* “sjell”)

(AShAK, Polisi, Mehdi, 2006: 87), d.m.th. *ai që sjell lajm*, ndërkaq fjala profet rrjedh nga greqishtja (*prophetes*) ose nga latinishtja (*propheta*), me kuptimin “parathënës”, prej së cilës kemi fjalët e prejardhura në shqipe *profeci* (parashikim), *profetizoj* (parashikoj), kurse Muhammedi a.s. nuk ka qenë parathënës, por i ka kumtuar fjalët dhe porosinë e All-llahut; dhe e dyta, sepse për terminologjinë islame duhet të merren për mbështetje gjuhët: arabe, perse dhe turke, duke u arsyetuar me faktin se këto janë bartëse të terminologjisë islame.

2.4. Sinonimet: *sabah* – *mëngjes*

Fjalët sinonime *sabah* – *mëngjes* në tekstet islame shpesh mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën. Fjala *sabah* është arabisht dhe ka kuptimet: “agim, mëngjes i hershëm, falja e parë islame e mëngjesit”. Dy kuptimet e para janë sinonime të plota me fjalën shqipe mëngjes, por kur bëhet fjalë për faljen e parë të mëngjesit, nuk mund ta zëvendësojmë me fjalën mëngjes, sepse asnjëherë nuk mund të thuhet: *A e ke falur mëngjesin?*

Në Fjalorin e orientalizmeve të T. Dizdarit shkruhet “SABÁH-I *m.* Veri. *sabá*-hu Jug. *sabáf*-i në Mat, Lurë (ndërrim i shpeshtë i spirantit gutural me atë labiodental në huazimet turke) dhe në Shqipërinë e Mesme pas ramjes së h-së fundore edhe në *gjin. fem.* *sabá*-ja. 1. Të zbardhurit e dritës, ag, mnâtje, mëngjes, me të gëdhimet, zbardëllim të mugëtisë, menatë (Camarda), akshani i dritës, ndenatja (Bardhi); *it.* alba, aurora, crepuscolo mattutino, mattino. Shih fjalorët e Jungg 122 dhe atë të Gjuhës shqipe 482. *Më ka dalë gjumi në pikë të sabahit, herët fort, me terr. U ngrit me sabáh. Ka ranë sabahu, gëdhi. Me të këndueme të gjelave, në sabah. Tur. < ar. sabáh صباح* (Tahir Dizdari, 2005: 228). Kështu që, po nënvizojmë se falja e parë e mëngjesit duhet të quhet *sabah* edhe në shqip.

2.5. Sinonimet: *gjynah* – *mëkat* – *gabim* – *faj*

Për vargun sinonimik *gjynah* (جُنَاحٌ) – *mëkat* – *gabim* – *faj*, që e gjetëm nëpër tekstet fetare, mund të themi se fjalët *faj* dhe *mëkat* janë me burim latin dhe me shtrirje tashmë në mbarë gjuhën shqipe dhe në të gjitha besimet, ndërsa *gjynah* është me burim nga arabishtja dhe me përdorim më të kufizuar, edhe pse ka krijuar gjedhen e saj në shqipe dhe shtrirje në të folmet dialektore e të shprehjeve frazeologjike, jo vetëm te folësit myslimanë. Ndërkaq, fjala *gabim* ka një nuancë të vogël të dallueshme semantike nga vargu sinonimik *gjynah* – *mëkat* – *faj*, sepse gabimi nuk është gjithmonë mëkat (p.sh. duke folur nëse e gabojmë një fjalë, me atë

ne nuk kemi bërë mëkat), prandaj kjo fjalë nuk mund të zëvendësojë kuptimin e fjalës gjynah ose mëkat.

2.6. *Duá* apo *lutje*

Dallimi mes *duá* dhe *lutje* qëndron aty se *duaja* është *lutje* drejtuar All-llahut, uratë, hir, urim, bekim, zakonisht është në arabisht. Ajo është *lutje* e gatshme nga Kur'ani dhe Hadithet ose të krijuara edhe më vonë; kurse *lutja* mund të jetë edhe administrative, madej edhe *lutje* me gojë që mund t'ia bëjmë ndonjë njeriu për nevoja vetjake. Mund të themi: *i lutem Allahut, lutjet e mia...*, por gjithnjë themi: *po lexoj një dua*.

2.7. Hadithi dhe tradita

Fjala *hadith* shpesh përkthehet me fjalën *traditë*, ngaqë *hadith* është fjalë arabe, që do të thotë traditë, por jo në kuptimin e përgjithshëm, sepse hadithet janë thënie të pejgamberit Muhammed s.a., kurse fjala *traditë* ka kuptimin e gjithçkaje që përcillet brez pas brezi.

PËRFUNDIME

Nga gjithë ç'u tha më sipër, mund të përmbylim se përkthimi i Kura'anit dhe i teksteve të tjera islame në gjuhën shqipe tashmë e ka kaluar fazën e nevojës religjioze dhe është koha për përkthime që do t'i kenë parasysh edhe qarqet akademike, por edhe të gjithë dashamirët e leximit, dhe që do të përpunohen nga shumë profesionistë, sidomos gjuhëtarë të rysur dhe njohës të mirë të kulturës islame. (Ibrahimi, Zeqirija, 2014: 157).

Fatmirësisht, niveli i përkthimeve të teksteve islame në gjuhën shqipe shkon drejt përmirësimit e po bëhen gjithnjë e më të mira, sepse shoqëria e sotme: shtëpitë botuese, bashkësitë dhe shoqëritë islame, por edhe individë, i kanë vënë vetes synim ta përsosin mjeshtërinë e përkthimit dhe gjuhën. Kështu vjen duke u rritur numri i varianteve dhe i përpjekjeve për zhvillim gjuhësor; gjithashtu sepse përkthimet e sotme nuk janë të parat fare, por kanë modele për mbështetje; veç asaj tashmë nuk ka censurë apo kufizime si në kohën e komunizmit që impononte terminologji të caktuar me çdo kusht joislame etj. Ajo që mbetet të bëhet tani nga përkthyesit, redaktorët, lektorët dhe këshilltarët profesionalë është që të tregohet kujdes më i madh në përzgjedhjen e termave më të përpiktë, cila fjalë të shqipërohet e cila të mbetet në arabisht, kurse togfjalëshat, fjalitë dhe periudhat të përkujtojnë me kërkesat e rregullave sintaksore të shqipes e jo të përkthehen fjalë për fjalë nga

gjuhët e tjera dhe kur të lexohen në shqip, të jenë të paqarta ose fare të pakuptimta dhe të palogjikshme.

Si çdo filolog shqiptar, edhe unë, jam e brengosur dhe e përkushtuar për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe jam kundër shpërdorimit të huazimeve të panevojshme arabe, perse dhe turke. Por, me ushtrimin e fesë, një numër i termave islame, disa prej të cilave i trajtuam më sipër, siç thekson edhe prof. Xh. Lloshi, “nuk mund të konsiderohen më si ekzotizma, as si fjalë të huaja të panevojshme, por si pjesë integrale e fjalorit fetar të shqipes” (Lloshi, Xhevat, 2001 – 2002: 115). Prandaj nuk ka pse të frikësohemi nga depërtimi i disa termave islame në shqipe, sepse ndikimi i arabishtes nuk arrin në shkallë të lartë të ndikimit në futjen e karakteristikave strukturore, kuptimore dhe sintaksore, gjegjësisht, në futjen e mjeteve fjalëformuese, të gjedheve fjalëformuese, strukturave kuptimore të një klase fjalësh, gjedheve strukturore sintaksore etj.

Duke u nisur nga kjo arsye, pajtohem me mendimin e Abdullah Hamitit kur thotë se “nuk është e këndshme që e tërë terminologjia kulturore-islame të shqiptarizohet, sepse ajo tashmë ato ngjyrime kuptimore e stilistike që i ka në origjinal vështirë se i shpreh me fjalë shqipe.” (AShAK, FSI, 2006: 99). Në fakt, shqipërimi apo shqiptarizimi (siç e quajnë disa) i terminologjisë islame e humb qëllimin e vet, sepse ajo ka shumë nuanca semantike, stilistike dhe përdorim kontekstual. Por, ata terma që janë të përgjithshëm në të gjitha fetë dhe që kanë shtrirje më të gjerë në të folmet dialektore të shqipes dhe traditat kombëtare, mund të njësohen. Faktori themelor i njësimi dhe i pavarësimit gjuhësor fetar është përkthimi i termit në gjuhën shqipe, kur është e mundur dhe kur nuk i bie ndesh saktësisë së koncepteve dhe ndjenjave fetare të besimtarëve.

Siç dihet, terminologjia ose fjalori terminologjik kërkon më shumë fjalë e jo togfjalësha për shumë arsye: së pari për ekonomizimin e gjuhës, për thjeshtësi dhe qartësi kuptimore, për saktësi dhe përpikmëri semantike, për ngjyrime emocionale dhe për nuanca stilistike, për këtë arsye do të ishte më mirë të përdoret fjala *ezan*, *sesa thirrja e myezinit për falje*; më mirë *Mahsher sesa tubimi i madh në Ditën e Gjykimit*, më mirë *zekat sesa paga që duhet bërë nga secili mysliman që ka*, e shumë shembuj të tjerë.

Njësimi i leksikut fetar të gjuhës shqipe nënkupton gjetjen dhe përkrahjen e disa invarienteve në gjuhë që u përgjigjen edhe koncepteve dhe praktikave të përbashkëta në fushën e besimeve dhe me siguri i shërbejnë nxitjes së dialogut ndër fetar, forcimit të mirëkuptimit dhe të tolerancës midis komuniteteve fetare dhe që shprehin edhe një emancipim më të madh të institucioneve të besimit. Megjithatë, nuk do të ishte e dëshirueshme që njësimi i

terminologjisë fetare të jetë i dëmshëm e të sjellë rrafshim dhe humbje vlerash të identitetit gjuhësor, përkatësisë fetare, traditës kulturore dhe të ndjenjave të besimtarëve.

BIBLIOGRAFIA:

- AHMETI, H. Sherif, (1987), *Kur'ani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- ASHAK (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës), FSI, (2006), *Terminologjia islame*, Prishtinë.
- ASHASH (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- BEHXHETI, Ahmet, (1994), *All-llahu – të konceptuarit islam dhe besimi*, Prizren.
- ÇABEJ, Eqrem, (1996), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, IV, Tiranë.
- DALLIU, Hafiz Ibrahim, (2005), *Ajka e kuptimeve të Kurani Kerijmit*, Tiranë: Lilo.
- DIZDARI, Tahir, (2005), *Fjalor i Orientalizmave*, (botim elektronik), AIITC, Tiranë.
- EL-KAHTANI, Seid, (1430/2009), *Mburoja e muslimanit me lutjet e Kur'anit dhe Sunnetit*, Shkup.
- HAXHIABDIQ, H. Naim, (1411 / 1990), *Ilmihal për shkallën e tretë të mësim besimit*, Shkup.
- IBRAHIMI, Zeqirija, (2014), *Interlinearis – studime mbi gjuhën shqipe*, Shkup.
- KOMUNITETI mysliman turk, (2016), *Kalendari islam i vitit 2016 / 1437,, Shkup.*
- KUR'ANI i madhërisëm*, (2006), përktheu: prof. Hasan I. Nahi, ISHMQI, Tiranë.
- LUTJET e jetës nga Kur'ani dhe Hadithi*, (2001 / 1421), Logos-A, Shkup.
- LLOSHI, Xhevat, (2001 – 2002), *Gjuha shqipe letrare përmes kontestimit*, “Studime”, 8-9, Prishtinë.
- MEHDIU, Feti, (1996), *Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe*, Shkup: Logos-A.
- POLISI, Mehdi, (2014), *Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe në: Hikmet nr. V: Prishtinë.*
- SIMPOZIUM Ndërkombëtar, (2000), *Krishterimi ndër shqiptarë*, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër.
- TAVASLI, Yusuf, (2014), *Yâsin-i şerîf, Bereket ve sıkıntı duâli*, Tavashlı yayıncılık sunar, Istanbul.
- ZEKAJ, Ramiz dhe Sh.B. (2001) *Drita e zemrës Duatë dhe jasini*, Furkan ISM, Shkup.
- ЛАТА, Зибер, (2016), *Преводите на „Куранот“ на албански јазик (лингвистичка анализа)*, (disertacion doktrati), Скопје.

ANAS

Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 81'374

Punim studimor

EDA SHEHU

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
edashehu_2006@yahoo.com

PROBLEME DHE ZGJIDHJE TË TYRE PËR FJALORËT TERMINOLOGJIKË TË FUSHAVE HUMANITARE

ISSUES AND SOLUTIONS RELATED TO TERMINOLOGICAL DICTIONARIES IN THE AREA OF HUMANITIES

PERMBLEDHJE

Në gjuhën shqipe janë hartuar e botuar një sërë fjalorësh terminologjikë të tipave të ndryshëm. Këto dallime fjalorësh bëjnë të nevojshme studimin e tyre, për të përcaktuar nga njëra anë, mënyrat e ndryshme për zgjidhjen e një varg problemesh, që lidhen kryesisht me disa dukuri të *spikatura për praktikën terminologjike* (si për shembull problemet e sinonimisë, të përfaqësimit të togfjalëshave terminologjikë, e gjetjes barazvlerësve në gjuhët e huaja etj.), kurse nga ana tjetër për përcaktimin e *një tipologjie pune në hartimin e fjalorëve terminologjikë në të ardhmen*, për fusha të ndryshme të dijes me anë të përbashkëta. Këta tipa fjalorësh janë hartuar sipas parimeve dhe kriterëve shkencore të caktuara në përputhje me konceptimin e hartimit të të gjithë fjalorëve të serisë terminologjike dhe kanë dhënë ndihmesë të vyer për sistemimin, njësimin dhe shqipërimin e terminologjisë të fushës në fjalë. Në to pasqyrohen

terma që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me fushën e dhënë, por aty këtu ka terma që u përkasin fushave të tjera. Kështu që në këto raste duhet zbatuar kriteri i heqjes së termave që janë larg fushës përkatëse, por duhet të shtohen ata lidhen drejtpërdrejtë me fushën përkatëse dhe sidomos terma që dalin në pjesë të tjera të ligjëratës, si psh. (*administroj -administrativ-e - administrativisht*), që pasqyrojnë specifikën konceptore të fushës dhe lidhen në mikrosisteme fjalëformuese. Në studim do të vështrohet me përparësi tipologjia e fjalorëve që lidhen me fushën e së drejtës.

Fjalë çelës: probleme, hartim, fjalor terminologjik, zgjidhje, togfjalësha terminologjike

SUMMARY

A series of different types of terminological dictionaries have been compiled and published in Albanian. It is thus necessary to study these differences and find out, on the one hand, the various ways of solving a series of issues related mainly to certain salient phenomena of the terminological practice (such as issues of synonymy, the presence of terminological word groups, finding of the translation equivalents in the foreign languages, etc.), whereas on the other, to determine a future working typology to compile terminological dictionaries for various areas of knowledge sharing common aspects. They are designed according to scientific principles and specific criteria in accordance with the design **conception** of the whole series terminological dictionaries and have provided valuable support for adjustment, and albanisation unification of terminology in the field in question. However there are terms that do not directly relate to **a given field** and **belonging to** other fields. So in these cases should apply the criterion of removing terms that are not **appropriate field**, but should be added to the Glossary some terms **that emerge** in other parts of speech, for example. (abstain, accuse). The study will give a priority to the investigation of the areas related to humanities, such as socio-political area, the area of law.

Key words: issues, compilation, terminological dictionary, solution, terminological word groups

Hyrje

Në një punim tonin rreth trajtimit dhe zgjidhjes së problemeve të hartimit të një fjalori terminologjik të fushës të së drejtës në

Këtë artikull do t'ia kushtojmë trajtimit të antroponimeve dhe toponimeve, duke u ndalur të ndërtimi i tyre, kuptimi leksikor, si edhe te veçoritë stilistike të tyre. “Emrat e njerëzve (apo me termin përkatës të gjuhësisë – antroponimet) janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të çdo populli. Kudo ata kanë pasur e kanë lidhje të ngushtë me vendin a kombin përkatës”²⁴, – thotë studiuesi Gj. Shkurtaç. Edhe Qosja i ka kushtuar një rëndësi të madhe krijimit të emrave vetjakë, karakterizimit dhe tipizimit të personazheve nëpërmjet ngjizjes së këtyre emrave, profilizimit të tyre artistik, duke zbërthyer botëkuptimin e tyre, anën psikologjike dhe atë shpirtërore, pa lënë anash edhe paraqitjen fizike, profesionet dhe rolin që luajnë në subjektin e veprës. Studiuesit theksojnë se “onomastika është ndër fushat më të rëndësishme shkencore, që ndriçon historinë e popujve, ndërsa onomastika e përdorur në veprën letrare, edhe pse ka vlerë të paktë praktike-shkencore, paraqet problem me rëndësi para së gjithash për poetikën”²⁵, ndërsa te Qosja ajo zbulon kuptimësi dhe aktualizon realitete konceptore e gjuhësore.

Pasuria leksikore e këtij gdhendësi të fjalës shqipe shfaqet edhe në ndërtimin e emrave vetjakë; ai e di mjaft mirë se antroponimet dhe toponimet marrin vlera stilistike dhe semantike, ato mund të shërbejnë si mjete të mirëfillta shprehësie. Ky fond i veçantë i leksikut të tij përfshin emra vetjakë të rëndomtë, të traditës, vendës ose të huaj, të marrë nga mitologjia apo historia, si edhe ata të krijuar nga ai vetë. Këta përbërës të rëndësishëm strukturorë të veprës së tij mundësojnë tipizimin e mjedisëve, ngjarjeve, personazheve si edhe psikologjinë e mendësinë e tyre.

Emra të përveçëm me mbi 200 paraqitje

| Nr. | Leksema | Paraqitje | Nr. | Leksema | Paraqitje |
|-----|----------|-----------|-----|---------|-----------|
| 1. | Saraç | 722 | 6. | Kosovë | 403 |
| 2. | Vajazan | 720 | 7. | Kabil | 279 |
| 3. | Tarik | 710 | 8. | Kurnajë | 214 |
| 4. | Shqipëri | 624 | 9. | Amerikë | 213 |
| 5. | Delina | 449 | 10. | Enver | 206 |

²⁴ Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë 2015, f. 24

²⁵ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, IA, Prishtinë 2000, f. 226.

Në tabelën e mësipërme kemi dhënë emrat e përveçëm me denduri më të lartë, ku vihet re që emrat origjinalë të krijuar nga shkrimtari kryesojnë në listën e frekuencave. Kështu, nga 10 emra e kësaj liste 6 janë krijime origjinale dhe 4 fjalë ekzistuese, si: *Shqipëri, Kosovë, Amerikë, Enver*. Prin fjala *Saraçi*, që është mbiemër i personazhit kyç në romanin me dy vëllime “Bijtë e askujt”, ndjekur nga fjala *Vajazan*, emërvend i krijuar nga Qosja, ku edhe vendosen ngjarjet në pothuaj gjithë veprat e tij. *Saraç, Tarik, Delina, Kabil* janë emrat e personazheve të përdorur me denduri më të lartë, ndërsa si toponime me denduri më të lartë kemi *Vajazan* dhe *Kurnrajë*, krijime origjinale të Qoses.

Do të shohim që emrat e personazheve dhe të vendeve të përdorura në romanet e Qoses kanë rëndësi të madhe jo vetëm përmbajtjesore, por edhe artistike: ato mbartin konotacione simbolike e estetike. Sigurisht, funksioni i parë i tyre është identifikues. Lidhur me këtë funksion, Ç. Bidollari shkruan: “Antroponimet dhe toponimet dallojnë rrënjësisht prej emrave të përgjithshëm, pasi këta të fundit, si pjesë e leksikut të përgjithshëm, kanë funksion përgjithësues, klasifikues, duke u përdorur për një numër të madh frymorësh ose jofrymorësh të së njëjtës klasë. Kurse emrat e përveçëm dhe emërtimet e përveçme kanë si funksion themelor thjesht shënimin, individualizimin e frymorëve dhe të objekteve, vënien e një etikete çdonjërit prej tyre, me qëllim që individ apo objekti i emërtuar të identifikohet e të dallohet me lehtësi prej individëve apo objekteve të tjera të asaj klase”²⁶.

Antroponimet

“Onomastika përbën një ndër shtresat gjuhësore me vlerë të paçmuar për historinë dhe gjuhën e një etnie. Për këtë arsye studimi i emrave të përveçëm të njerëzve dhe i emërtimeve të vendeve merr një rëndësi të veçantë”, – thekson R. Memushaj²⁷.

Pasurisë së madhe leksikore të Qoses i shtohet edhe përdorimi i një larmie të madhe të emrave të përveçëm, të cilët janë qëmtuar prej tij me shumë kujdes, duke bërë një lidhje semasiologjike dhe semantike mes emrit dhe personazhit. Emrat vetjakë, mbiemrat dhe pseudonimet janë ndërtuar prej autorit duke u mbështetur në karaktersitikat e tyre psikologjike, formimin e tyre intelektual-kulturor, botëkuptimin si edhe në profesionin e tyre ose në rolin që

²⁶ Ç. Bidollari, *Emri i përveçëm vetjak: semantika dhe morfologjia*, SF, 2000, nr. 1–2, f. 148.

²⁷ R. Memushaj, *Antroponimia e Himarës*, në “Himara në shekuj”, Tiranë, 2004, f. 295.

kanë në vepër; gjithashtu, nëpërmjet këtyre antroponimeve autori shpalos edhe qëndrimin e tij ndaj dukurive sociale, problematikave të caktuara, mendësive si edhe ngjarjeve të rëndësishme historike e kombëtare. Kjo gjë është vërejtur edhe nga studiuesit e veprës së tij. Kështu R. Kryeziu shprehet: "... krijuesi, përmes emërimit të personazheve, shpreh qëndrimin e tij mendor, emocional e artistik ndaj tyre. Rexhep Qosja në përzgjedhjen e emrave të karaktereve të tij në roman mëton që, edhe nëpërmjet tyre, ta bëjë përkufizimin karakterizues. Emërtimi i karaktereve është përkufizim edhe i qëndrimeve që autori ka ndaj një dukurie apo një vetie të caktuar (lavdia, tradhtia, besa, besëthyerja). Këto dukuri, që janë trase nëpër të cilat rrjedh jeta e njeriut janë edhe emra të personazheve gjegjësisht të protagonistëve dhe antagonistëve të romanit. Kjo mënyrë e procedimit krijues i mundëson autorit që ta shprehë qëndrimin e vet ndaj një dukurie të cilën dëshiron ta afirmojë apo stigmatizojë dhe në të njëjtën kohë vetëm nëpërmjet një fjale ai flet për karakteristikat e individit"²⁸.

Antroponimet e krijuara nga Qosja janë të ndryshme, si nga përmbajtja ashtu edhe nga ndërtimi, kështu, më poshtë po paraqesim disa nga antroponimet e krijuara prej tij, të cilat mund janë:

a) emra njerëzish të tipit *emër + emër në gjinore*, si: *Xhezairi i Gjikkës, Danjollli i Sherkës, Rudina e Bardhit, Arifi i Tëhuajzinit, Kasëmi i Hoxhës, Ejupi i Hundozit, Nderimi i Musës, Qerimin e Plepollit, Durmishin e Kasapollit, Trashja e Dervishit të Mukailit, Talja e Deli Musës etj.*

Përdorimi i emrave të njerëzve të këtij tipi, si p.sh. *Xhezairi i Gjikkës apo Danjollli i Sherkës*, është një karakteristikë dalluese e veprës letrare të Qoses. Këto lloj ndërtimesh nuk bëjnë pjesë në kulturën e gjuhës shqipe, që do të thotë se një përdorim i tillë është bërë për efekte stilistike. Jemi të mendimit se kjo dëshmon se autori ka njohuri të gjera të kulturës orientale-arabe, pasi në këto vende njerëzit emërtohen në këto lloj forme, si: *Ibn Kajimi* (i biri i Kajimit), *Umu Ali* (nëna e Aliut) etj. Por autori mund t'u jetë drejtuar ligjërimëve popullore. Në shumë treva shqipfolëse emërtime të tilla marrin konotacion negativ, por këto përdorime shërbejnë vetëm në stilin bisedor, pra në gjuhën e përditshme dhe jo në atë të letrave.

²⁸ R. Kryeziu, *Fjalori në strukturën e romanit "Një dashuri dhe shtatë faje"* të Rexhep Qoses, botuar në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, IAP, Prishtinë, 2007, f. 170-171.

P.sh., personazhi *Xhezairi i Gjikës*, protagonist i romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, njihej me këtë emër, pasi e thërritnin me mbiemrin e të atit. Emërtime të kësaj natyre gjenden dendur në romanet e Qoses.

Nderimi i Musës, prozator i njohur, që shkruante rrallë e për mall, anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve që prej moshës njëzet e njëvjeçare, nuk kishte mundur kurrë të pajtohej me pohimet e dramaturgut, Aliut të Tejtës, të poetit, Kasëmit të Hoxhës, të kritikut, Siriut të Balës, se krijimtarinë artistike më së shpeshti e frymëzojnë skamja [...] (Vdekja..., f. 35)

α) emra me burim shqip dhe ilir, si: *Miran Bushati, Arben Begeja, Hana Ujëmiri, Nderim, Bardha, Arbërie, Ermir, Agron, Tigrana, Zanë, Bisha, Trashe etj., dhe pseuonimet: Garip (Grep), Dem (Gojarti), Zift, Belban, Ujk, Mel, Besnik, Kajmak*. Emrat e këtij grupi janë të paktë në numër.

β) Emra të burimit oriental, si: *Din, Hasan, Fatime, Abdil, Abdi, Ethem, Sabedin, Zejni, Zahir, Kasëm, Ismail, Mahir, Qemal, Kadrije, Sulltane, Hakif, Qerim, Ahmet, Xhabir etj.* Emrat e këtij grupi janë më të shumtë në numër se ata me burim të krishterë.

[...] e Bedriut, banonte piktori Ejupi i Hundozit; në katin e katërt, menjëherë mbi kokën e Ejupit, Në katin e parë, menjëherë mbi kokën e tij, banonte vjershëtari, Kasëmi i Hoxhës; në katin e dytë, menjëherë mbi kokën e Kasëmit, banonte vjershëtari tjetër, Bedriu i Shytit; në katin e tretë, menjëherë mbi kokën banonte piktori i dytë, Esadi i Jakovës; në katin e pestë, menjëherë mbi kokën e Esadit, banonte skulptori Tefiku i Qorrit; në katin e gjashtë, menjëherë mbi kokën e skulptor Tefikut, banonte skulptori i dytë, Talati i Pushkollit; në katin e shtatë, menjëherë mbi kokën e Talatit, banonte artisti, Sheremeti i Kastratit; në katin e tetë, menjëherë mbi kokën e Sheremetit, banonte një artist i dytë, Avniu i Bejtës; në katin e nëntë, menjëherë mbi kokën e artist Avniut, banonte kompozitori, Viktori i Karahasanit; në katin e dhjetë, ndërkaq, menjëherë mbi kokën e kompozitor Viktorit, banonte dirigjenti, Nusreti i Spahiut, që ia kishte vënë kapakun kësaj hierarkie të rastit, por të çuditshme. (Vdekja..., f. 37)

χ) Emra të besimit të krishterë: *Mark Teli, Premt Dukagjini, Shtjefën Gjon Krasniqi, Dedë Palë Gashi, Shtjefën Ishmi, Kolë Kushti, Pjetër Potasi etj.*

δ) Emra fetaret lashtë vendës ose të huaj, si: *Kabil, Habil, Mukail, Undina, Hinda, Harun, Haran, Monun, Molos, Ixhlil, Beselam, Bidad, Iblisi etj.*

Në prozën e Qoses bie në sy numërimi i emrave të përveçëm njëri pas tjetrit, gjë që e bën jo vetëm me emrat e njerëzve, por edhe me emrat e vendeve.

Në rrethin e dytë rreth meje pas shpinës së Budinit, Demit, Garipit, Zanës dhe Tules, që thanë ç'patën të thonë një herë për një herë, shoh edhe shumë personazhe të tjera: shoh Tolin, Kazanovën, Mugni Matjanin, Murtez Mukën, Nusret Tuhinë, Mushakun, Mushak Mejën, Çerkez Cakun, Xhemshit Gjetanin, Rushanin, Lanin e Idiotin, Kajkush Baliun, Zojën e Almën, madje edhe pëshpëritësit Qerim Qemanen, Osman Galanin, Ermira Patozin, Kabil Kalemin, Ajvaz Abazin, Azë Barbullushin, Leze Mirashin, Sadik Radikën, Imzot Nart Mëhill Harapin, Ambroz Ndrecën dhe imam Mulla Tajarin. (Nata..., f. 509)

Qosja krijon personazhe dhe i karakterizon ato edhe nëpërmjet emrave; ai vendos lidhje përshoqëruese mes emrit dhe personazhit, duke vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit për të bërë tipizimin e karaktereve nëpërmjet emërtimit të tyre, për të zbuluar rolin e tyre, karakteristikat e tyre, aktualizimin e tyre në vepër. Studiuesi B. Baliu në një artikull kushtuar onomaksionit në veprën e Qoses, thekson: “Një prej mënyrave me të cilat profesor Rexhep Qosja i ka ndërtuar prozat e tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Një dashuri dhe shtatë faje” dhe “I ringjallur i penduar”, është edhe struktura e veçantë e rrafsheve kuptimore të toponimeve dhe antroponimeve. Në këto vepra numri më i madh i personazheve vetëshpjegohen sipas emrave dhe sidomos mbiemrave të tyre. Përmes kësaj veçantie të emërtimit autori ka realizuar efekte të shumta semasiologjike. Struktura e tyre gjuhësore e artistike reflektohet qoftë atëherë kur këto identifikohen si antroponime, patronime e mikrotoponime, qoftë atëherë kur këto paraqiten të organizuara si sisteme më vete: eponime, leksikë dhe onoma. Mes tyre autori ka krijuar raporte të shumfishta motivuese e rimotivuese, konceptuale e kodifikuese,

estetike e semantike, sistemesh, fushash e dimensionesh gjuhësore e letrare.”²⁹

Te Qosja emrat vetjakë janë të ngarkuar semantikisht dhe ndërlidhen me kohën dhe vendin e ngjarjes, mjedisin dhe njerëzit, profesionet dhe mjeshtëritë, duke u bërë bartëse të ngarkesave shprehëse dhe të vlerave stilistike. Autori, shpeshherë, e bën të lehtë për lexuesin gjetjen e kuptimit që mbart emri vetjak, madje ka edhe raste kur ai i shpjegon vetë kuptimisht emrat që krijon. Kjo prirje e Qoses për t’ua dhënë vetë kuptimet emrave vetjakë që krijon është theksuar edhe nga B. Baliu: “Brenda romaneve dhe sidomos në kuadër të temave që trajtohen në prozat veç e veç, shumë personazhe, me sjelljen e tyre vetetimologjizohen si antroponime dhe patronime dhe vetëshpjegohen si verbalizime, ndërsa një numër tjetër i tyre zbërthehen edhe nga vetë autori:

– për *Xhaferin e Nallbanit* thuhet se “punonte shalaxhi”³⁰;

– për *Arifin e Hamallit* thuhet së është i “fortë si demat e *Aqifit të Kasapit*”;

– për *Arifin e Tëhuajzimit* thuhet se ishte “njeri i sëmure prej nervave”, pra ishte njeri i tëhuajsuar, i rrënuar nga dhuna pushtetare;

– për *Nadi Sitaxhiun* thuhet se ishte “zejtar që punonte kalanica”³¹;

– për *Skeren e Vidhaxhiut* thuhet se ishte i prirë për të shikuar vithe;

Për *Trashen* po ky autor thotë: “Emri që kishte u përgjigjej jashtëzakonisht mirë vijave të jashtme aq sa edhe cilësive të saj shpirtërore: ishte e trashë, si thesi i mbushur miell [...]”³²

Gjithashtu, Qosja e ndihmon lexuesin në gjetjen e kuptimit të emrave vetjakë që ngjiz edhe në këtë formë:

E pse ju duket ashtu i kuptimshëm mbiemri im – Derti?

Pse? Sepse do të thotë gajle, kujdes, brengë për tjetrin.

Domethënë: është mbiemër me kuptim të njerëzishëm. Obligues. (Bijtë 1, f. 65)

Nuk mund t’u flas unë se kush ishte ky, ky farë Akjani, gati e shkrova Arkani, sepse nuk di për të më shumë se ç’thonë SMS-të e tij.

²⁹ B. Baliu, *Epoleksikonomat e prozës së Rexhep Qoses*, botuar në “Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes”, IAP, Prishtinë, 2007, f. 369.

³⁰ R. Qosja, *Vdekja...*, f. 195.

³¹ *Po aty*, f. 65.

³² B. Baliu, *Epoleksikonomat e prozës së Rexhep Qoses*, art i cit., IAP, Prishtinë, 2007, f. 371.

E di se Arkan do të thotë: i fshehtë apo jo! Por, do t'u tregojë ai vetë kush është! (Bijtë 2, f. 306)

Rëndësi të veçantë për studim paraqesin emrat vetjakë që përmbajnë tregues semantikë, emra që e rritin ndjeshëm shprehësinë si edhe realizojnë një funksion të veçantë stilistik. Po sjellim në vëmendje disa prej tyre: *Hana Ujëmiri, Ylber Çadra, Hasan Halli, Qemal Qorri, Kasem Trashupa, Kajkush Baliu, Mugni Bafti, Mahir Kulla, Miri Meka, Rozaf Gashi, Ajri Bojaxhiu, Kush Akshiu, Valjet Shehjani, Naxhije Stringa, Gojë Burreli, Suman Sekushi, Kaposh Kajmani, Mentor Fishta, Sabedin Sabahu, Sokol Guri, Bajrush Toka, Tigrana Tepja, Mal Qatipi etj.*

Veçori e stilit të Qoses është edhe përdorimi i emrave të përveçëm në numrin shumë:

Ia kemi mësyre Evropës.

Evropës dhe Amerikës.

Por, me izbera, brosha, samia, sadria, saraça, muhameta, abdyla, ismajla, qemajla, ramadana, rexhepa, mehmeta, skëndera, envera, hiqmeta, hashima, jakupa, saliha, halila, hanumshahe, hajrije, sanije, bedrije, as nuk hyhet lehtë në Evropë, as nuk bëhet miqësi e sinqertë dhe e gjatë me Amerikën. Apo jo? (Bijtë 1, f. 99)

Në leksikon e Qoses gjejmë shtrirje të gjera edhe emra të njohur të artit, kulturës, letërsisë, sportit, politikës, historisë etj., etj., si edhe tituj veprash të njohura, çka dëshmon për erudicionin e tij të pashoq në fusha të ndryshme.

Kur isha nxënëse në gjimnazin e Tiranës, në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar, profesori i letërsisë, quhej Mark Shiroka, na thoshte se si Floberi, Tolstoi, Dikensi, Tomas Mani, Aleksandër Manxoni i kanë shkruar nga shumë herë romanet e tyre të mëdha, "Zonjën Bovari", "Luftën e paqen", "David Koperfildin", "Malin Magjik", "Të fejuarit".

Samiun, Vaso Pashën, Luigj Gurakuqin, Ndre Mjedën, Gjergj Fishtë, Fan Nolin, Asdrenin, Faik Konicën, Hoxha Tahsini, Vaso Pasha, Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Koto Hoxhi, Jani Vreto dhe, gati e harrova, Ismail Qemali. (Bijtë II, f. 30)

Emrat vetjakë që përdor Qosja në veprën e tij janë të larmishëm dhe mund të shihen si një pasuri me vlerë për onomastikën shqiptare, ashtu siç shprehet gjuhëtari Gj. Shkurtaç, i cili vë në dukje

se “antroponimia artistike apo emrat e personazheve të dramave, romaneve, novelave, tregimeve etj., përbëjnë edhe një gurrë të pasur e ndikuese për antroponiminë shqiptare.”³³

Toponimet

Toponimet e Qoses lidhen ngushtësisht me vendosjen e subjektit letrar në një rrafsh hapësinor e kohor të caktuar, ato përgjithësojnë përmbajtje e ide të caktuara dhe kryejnë funksione të rëndësishme artistike. Në korpusin e analizuar ndeshim toponime imagjinare ose të trilluara dhe reale. Vendosja e tyre në kontekste simbolike e polisemantike dhe aktualizimi i tyre sjell vlera të larta evokuese, estetike, ekspresive e sugjestive.

Si dominante stilistike toponimet që ndeshim në romanet në hetim shfaqen në dy rrafsh: në rrafshin semantik, ku paraqesin variacione të ndryshme kuptimore, si edhe në rrafshin e motivimit.

Toponimet më të larmishme Qosja i përdor në funksion të tipizimit e lokalizimit të ngjarjeve dhe hasen veçanërisht në përshkrime të mjediseve, ngjarjeve a situatave, duke e plotësuar ligjërimin me informacion dhe pamje të rëndësishme gjuhësore.

Disa nga toponimet e ngjizura prej Qoses janë: *Lumi i Mullenjave, Xhamia e Madhe, Bjeshkët e Pashës, Shpella e Harapit, Varri i Kopilit, Livadh i Mulla Jusufit, Kodra e Madhe, Bjeshkët e Thata, Mëhalla e Dylit* etj.

Simboli është ndër figurat më të qëlluara që shfrytëzon Qosja në ndërtimin e emrave të vendeve, kështu që mund të themi se toponimet e hetuara në romanet e tij kryejnë funksione të ndryshme artistike. Si emërve simbolike mund të përmendim: *Vajazan, Kurrnajë, Ajmelot, Gropa e Dreqit, Kudomani, Kukubolli, Menella, Mërzimali, Sheshi i Ylbertë, Shtëpia e të çmendurve, Kështjella magjike* etj.

Vajazani simbolik, paraqitet si emërvendi me denduri më të lartë, me 720 paraqitje, të cilin e hasim në të gjithë romanet e tij. Simbolika e tij jepet që në zbërthimin e emrit të tij vaj + zá, ndërsa për sa i përket pozitës gjeografike dhe ngjarjeve historike që parashtron autori, të kujton Kosovën ose Prishtinën.

Më poshtë po paraqesim edhe shpjegimin që i bën personazhi kryesor i romanit “Bijtë e askujt”, Miran Bushati emërvendit *Kurrnajë*:

³³

Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, vep. e cit., f. 164.

Kurnnajë!

Kurr-natë! Nuk thotë gjë kështu: Kurr-najë.

Kurr-natë...E, kështu ka kuptim të veçantë. Shumë të dëshiruar.

Ku ka pa natë? Askund.

Ku ka vetëm ditë? Askund.

E Kurnnaja, më thoshte babai, kishte më shumë net se ditë. (Bijte 1, f. 88)

Toponimet që përdoren në prozën e Qoses janë të ndryshme dhe shumë të larmishme, origjinale ose të trilluara, si edhe të mbështetura në gjedhe popullore ose që mund të kenë përmbajtje historike, siç kanë vërejtur edhe studiuesit e prozës së tij: “Autori ka krijuar toponime ngjyrimesh popullore kuptimi i të cilave është me përmbajtje historike si, fjala vjen, Kroi i Pashës; me domethënie legjendare si Shpella e Harapit; me botëkuptime mitologjike si Liqeni i Zanave. Të gjitha këto pamje folklorike njësohen me përmbajtjet e romaneve moderne dhe janë krijuar ashtu sa në zëshmerinë e tyre shijohet aroma e krijimtarisë letrare gojore.”³⁴

Në korpusin e analizuar ndeshim një numër të madh emërvendesh, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: emra shtetesh, krahinash, qytetesh, vendesh, fshatrash, detesh, lumenjsh, fushash, malesh etj., të cilët shpesh mund të kenë tregues kombëtarë.

Në vijim po japim, sa për shembullsim, disa emërtime interesante që përdor Qosja në romanet e tij: *Lumi i Mullenjave, Bjeshkët e Pashës, Kodra e Madhe, Kodra Diellore, Kodra e Trimave, Livadh i Mulla Jusufit, Shpella e Harapit, Varret e Thesarit, Varri i Kopilit, Varrezat e të Lavdishmëve, Mëhalla e Hodumit, Tasjan Mëhalla, Xhamia e Madhe, Lagjja e Muhaxhirëve, Lagjja e Trimave, Lagjja e Hashkalinjve, Lagjja e Varreve të Mëdha etj.*

Si përfundim, mund të themi se antroponimet dhe toponimet përdoren me larmi dhe denduri të madhe në prozën e Qoses. Këto njësi shenjuese përmbajnë vlera stilistike, semantike, simbolike, shprehëse dhe përmbushin kërkesat ideo-tematike dhe gjuhësore të veprës së tij; gjithashtu, ato paraqesin pasuri për onomastikën shqiptare dhe shërbejnë si lëndë e rëndësishme gjuhësore e stilistike për studime.

³⁴ R. Berisha, *Eposi dhe romanet e Rexhep Qoses*, botuar në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, IAP, Prishtinë, 2007, f. 224.

Literaturë

1. Baliu, B., *Epoleksikoonomat e prozës së Rexhep Qoses*, botuar në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, IAP, Prishtinë, 2007.
2. Berisha, R., *Eposi dhe romanet e Rexhep Qoses*, botuar në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, IAP, Prishtinë, 2007.
3. Bidollari, Ç., *Emri i përveçëm vetjak: semantika dhe morfologjia*, SF, 2000, nr. 1-2.
4. Islamaj, Sh., *Gjuha e Jakov Xoxës*, IA, Prishtinë 2000.
5. Kryeziu, R., *Fjalori në strukturën e romanit "Një dashuri dhe shtatë faje" të Rexhep Qoses*, botuar në *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, IAP, Prishtinë, 2007.
6. Memushaj, R., *Patronimia e Himarës*, në "Himara në shekuj", Tiranë, 2004.
7. Q o s j a , R . , *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, IAP, Prishtinw, 2010.
8. Shkurtaç, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015.



Nr. 12, Shkup 2018

ISSN 1857-8896

UDC 811.18

Punim studimor

GRETA JANI

Universiteti "Aleksandër Moisiu"

Durrës, SHQIPËRI

Departamenti i Gjuhës Shqipe

Email: greta_jani@yahoo.com**"KËNDI I VOGËL I GJUHËS" I NJË GJUHËTARI TË MADH****"SMALL ANGLE OF THE LANGUAGE" OF A GREAT LINGUIST**

Përmbledhje

Mehmet Çeliku është gjuhëtari që kontribuoi për ta bërë shqipen një gjuhë kulture që do të luante rol vendimtar në përhapjen e diturisë dhe kulturës në popull. Pa një gjuhë të zhvilluar e standardizuar nuk mund të mendohej përparimi i vendit dhe ndërtimi i shoqërisë sonë të re. Veprimtaria e tij është e gjerë dhe e larmishme në fushën e gjuhësisë, por ne jemi ndalur në trajtesat e problemeve të gjuhës që botoheshin në gazetën periodike "Drita". Prof. Çeliku ka pasqyruar në "Këndin e vogël të gjuhës" mjaft probleme gjuhësore që pengojnë zhvillimin normal të gjuhës shqipe. Prof. Çeliku mban qëndrim të rreptë, tregon rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka misioni dhe profesioni i gjuhëtarit kur vjen fjala për gjuhën shqipe. Sipas prof. Çelikut është i vështirë, por jo i pamundur zotërimi i shpejtë jo vetëm teorik, por edhe praktik i normave të gjuhës së njehsuar. Të gjitha trajtesat në këto rubrika dëshmojnë, jo vetëm përgatitjen e

lartë shkencore, aftësinë për të trajtuar drejt dhe me mjaft korrektesë problematikën e ngritur, por edhe ndjenjën e përgjegjësisë së shqiptarit që do dhe respekton gjuhën e tij, kombin e tij.

Fjalë çelës: probleme gjuhësore, shenja pikësimi, parafjalë, fjalë e ndërmjetme

Abstract:

Mehmet Çeliku is the linguist who contributed to make Albanian language a culture language that would play a decisive role in spreading knowledge and culture in the people. Without a standardized language, the country's progress and the construction of our new society could not be considered. His activity is vast and varied in the field of linguistics, but we have stopped in the language problems that were published in the periodical newspaper "Drita". Prof. Çeliku has reflected on the "Small Angle of the Language" many linguistic problems that hinder the normal development of the Albanian language. Prof. Çeliku holds a strict attitude, shows the importance and responsibility of the language mission and profession when it comes to the Albanian language. According to prof. Çeliku is difficult, but not impossible, not only theoretical but also the practical assimilation of the standard language norms. All the features in these rubrics show, not only the high level of scientific preparation, the ability to handle fairly and correct the raised problem, but also the sense of responsibility of the Albanian who loves and respects his own language, his nation.

Keywords: linguistic problems, punctuation marks, preposition, intermediate word

Hyrje

Populli ynë përherë e ka vështruar gjuhën si gjënë më të vyer të thesarit tonë kulturor, pasi gjuha shqipe na identifikon si komb. Rilindasit e më tej, brezat me radhë, janë mësuar të kujdesen për ta ruajtur gjuhën, ta shpëtojnë nga "bastardimi" e asimilimi.

Në hullinë e këtyre figurave të ndritura që ka punuar për ta ruajtur e zhvilluar gjuhën shqipe është edhe Mehmet Çeliku, gjuhëtari që kontribuoi për ta bërë shqipen një gjuhë kulture që do të luante rol vendimtar në përhapjen e diturisë dhe kulturës në popull, faktor pa të cilin as që mund të mendohej përparimi i vendit dhe ndërtimi i shoqërisë sonë të re.

Mehmet Çeliku, ky kolomb i gjuhësisë shqiptare, është ndër të parët që pas Çlirimit thekson detyrën e dyfishtë të shkollës në zotërimin e gjuhës amtare: së pari, në lëndën e gjuhës shqipe u jep

nxënësve nocionet themelore për gjuhën si sistem dhe, së dyti, shkolla jonë, nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe, duhet të ngulisë te nxënësit edhe praktikisht normat e gjuhës letrare të njehsuar (Çeliku 1985:146)

Si gjuhëtar, por edhe si njeri, prof. Çeliku e dinte mirë se këto detyra ishin të lidhura e të pashkëputura nga njëra-tjetra dhe se realizimi i njërës ndihmonte tjetrën dhe e kundërta.

Ky punim do të hedhë dritë mbi disa probleme të gjuhës shqipe, evidentuar dhe trajtuar nga prof. Çeliku në “Këndin e vogël të gjuhës”, rubrikë për problemet gjuhësore që botohej në gazetën “Drita” në vitet 1970-1973, me qëllim që të vlerësojmë kontributin e Mehmet Çelikut, qëndrimin e rreptë, rëndësinë dhe përgjegjësinë që ky gjuhëtar merrte kur vinte fjala për gjuhën shqipe, pasi sipas tij është e vështirë, por jo i pamundur zotërimi i shpejtë jo vetëm teorik, por edhe praktik i normave të gjuhës së njehsuar.

Kontributi i Mehmet Çelikut në zhvillimin e shqipes standarde

Në fushën e gjuhësisë të vetmit që mund të thonë me kompetencë fjalën e fundit janë shkencëtarët e shkollës gjuhësore shqiptare. Një ndër arkitektët kryesorë të kësaj ngrehine është edhe Mehmet Çeliku, ndaj shkenca e ka për detyrë të përjetësojë veprimtarinë e prof. Çelikut, dijetarit që për më shumë se gjashtë dekada kontribuoi në mësimin e zhvillimin e shqipes standarde.

Prof. Mehmet Çeliku ka treguar një interesim të vijueshëm për problemet e gjuhës letrare shqiptare duke përfshirë edhe ato të shkrimit dhe drejtshkrimit të kulturës së gjuhës. Këtë kontribut të madh prof. Mehmet Çeliku e pasqyroi në gazetën periodike “Drita” ku një rubrikë mjaft e dobishme për shqipfolësit dhe gjuhën shqipe titullohej “Probleme gjuhësore”. Të gjitha trajtesat në këtë rubrikë dëshmojnë jo vetëm përgatitjen e lartë shkencore, aftësinë për të trajtuar drejt dhe me mjaft korrektesë problematikën e ngritur, por edhe ndjenjën e përgjegjësisë së shqiptarit që do dhe respekton gjuhën e tij, kombin e tij.

“Probleme gjuhësore”, përdorimi i parafjalës *prej* dhe *nga*

Në këto trajtesa shpjegohet se përdorimi i gjerë i dy parafjalëve *prej* dhe *nga* shpesh sjell dhe përdorimin e tyre në ndërtime të gabuara. Parafjala *nga* shpjegon prof. Çeliku përdoret 8 herë më shumë se parafjala *prej* e këto janë përdorime të larmishme si nga ana kuptimore dhe nga ana strukturore. Të dy këto parafjalë

përdoren, përgjithësisht në ndërtime të caktuara, ato i vënë fjalët në marrëdhënie të caktuara. Që gjuha letrare të jetë edhe në këtë pikë sa më e ngulitur duhet që parafjalët nga e prej të përdoren në ndërtimet përkatëse dhe të mos përdoren njëra për tjetrën.

Mehmet Çeliku evidenton ndërtimet kur përdoret parafjala prej që përbën normë sot. P.sh.: *rrobë prej shajaku* - lënda nga përbëhet një send; *mendje prej çilimiu*- karakteristika, cilësia e një sendi; dendur përdoret prej përpara përemrave: *njëri prej nesh, goditeshin prej saj, ka turp prej meje; u shkëput prej tyre*; ndërtime ku tregohet sasi numerike, masë në kohë, në distancë: *mbi një shtresë prej dy pëllëmbësh, patrullë prej katër vetësh*. Parafjala prej përdoret në përsëritje: *gjë prej gjëje, një ditë prej ditësh*, si edhe në togje të qëndrueshme si: *prej së largu*. Duke trajtuar këtë përdorim të gabuar, ai na ngulit mirë në mendje që parafjala prej duhet përdoret vetëm në ndërtimet e mësipërme dhe përdorimi i saj në ndërtime të tjera tregon përdorim të gabuar, pra, është përdorur në vend të parafjalës nga.

Duke treguar rastet kur përdoret parafjala nga dhe duke e ilustruar me shembujt tipikë: *dal nga shkolla, nga dritarja, sytë nga tavani etj.*, ai përjashton mundësinë e përdorimit të parafjalës prej që ndonjëherë autorë të ndryshëm e përdorin në këto ndërtime, kur duan të individualizojnë gjuhën e personazheve të veprës që janë me origjinë nga Veriu.

Po kështu, prof. Çeliku thekson se parafjalën prej në vend të nga e përdorin shkrimtarë që janë me origjinë nga veriu, por edhe shkrimtarë që janë me origjinë nga jugu, por kanë pësuar një ndikim nga dialekti i veriut. Shkrimtarë të tjerë e përdorin prej në vend të nga në raste më të kufizuara.

Raste të tilla shmangieje gjenden në shumë vepra, por ato në çdo vepër takohen mjaft rrallë në krahasim me përdorimin normë. Këtë kërkesë për përdorimin në ndërtime të caktuara të të dy parafjalëve prof. Çeliku e shtron për shkrimtarët, autorët e shkrimeve të ndryshme, mësuesit, gazetarët, korrektorët e redaktorët me origjinë nga veriu, si edhe ata me origjinë nga jugu ndikuar nga gegërishtja.

“Probleme gjuhësore”, përdorimi drejt i një parafjale

Një problem tjetër që trajton në “Këndin e vogël të gjuhës” prof. Çeliku është edhe përdorimi drejt i një parafjale. Në faqet e gazetave, të revistave, të veprave shkencore e politike, shumë herë edhe në veprat letrare, në emisionet e përditshme të radio Tiranës, si edhe në leksione të ndryshme po përdoren, gjithnjë e më shumë,

shprehje të tilla si: *në drejtim, me anë, nga ana, në vend, nëpërmjet, për shkak, etj.*

Mehmet Çeliku shpjegon përdorimin drejt dhe të gabuar në ndërtime të caktuara. Ai thekson se parafjala *në drejtim*, sikurse edhe parafjalët e tjera emërore (d.m.th që kanë ardhur nga emrat) nuk kanë lindur dhe nuk përdoren në gjuhën letrare pa një qëllim. Këto parafjalë plotësojnë kërkesën e domosdoshme për të shprehur mendimin në një mënyrë sa më të diferencuar dhe më të përpiktë. Parafjala *në drejtim* zëvendëson parafjalët e thjeshta të shumëkuptimshme *nga, në, për*. Parafjala *në drejtim* përdoret për të treguar drejtimin e një lëvizjeje, prandaj, si rregull, kjo parafjalë vë në marrëdhënie folje që tregojnë, përgjithësisht lëvizje si: *shkoj, udhëtoj, eci, kthehem, rend, vrapoj, etj.*, me emra konkretë ose përemra që zëvendësojnë këto. Autori jep shembuj të shumtë të përdorimit drejt të kësaj parafjale, p.sh.: *Njeriu i panjohur u zhduk në drejtim të barakave*; duke theksuar që në shembuj të tillë kjo parafjalë shpreh mendimin në një mënyrë shumë të diferencuar e më të përpiktë sa mund të shprehnin parafjalët e thjeshta *në, nga, për* që shprehin kuptime më të përgjithshme e më formale gramatikore të një shkalle të lartë abstraksioni.

Gjithashtu, ai thekson që parafjala nuk mund të zëvendësohet as me parafjalën *drejt*, sepse kjo në dallim nga *në drejtim* nuk tregon, thjesht, orientimin e një lëvizjeje a veprimi, por edhe pikëmbërritjen. Kjo parafjalë po bëhet polisemantike, me shumë kuptime. Kjo dukuri në vetvete ka një rëndësi teorike, sepse dëshmon parafjalëzimin e plotë të ndërtimit *në drejtim*. Përdorim të shpeshtë të kësaj parafjale takohet në stilin publicistik e shkencor, në stilin e letërsisë artistike ose përdoren në tekste ku nuk duhet të përdoren fare parafjalë.

“Këndi i vogël i gjuhës” pasqyrë e përdorimeve të sakta e të pasakta

“Këndi i vogël i gjuhës” nuk do të mbetet pa qenë pasqyrë edhe e përdorimeve të sakta e të pasakta. Autori shprehet se parafjalët *ndanë, mbanë*, të përfuara nga shkrirja e fjalëve të thjeshta *ndë, mbë* me emrin *anë* nuk duhen përdorur në gjuhën letrare shqipe. Këto sot përdoren rrallë dhe vetëm në letërsinë artistike dhe jo në stilet e tjera. Prof. Çeliku thekson se këto parafjalë sot tingëllojnë arkaike, nga shkaku i parafjalëve të thjeshta *nd (ë) e mb (ë)* që marrin pjesë në përbërjen e tyre dhe që sot kanë trajtuar në trajtat e reja *në, më*. Parafjalët *mbanë* dhe *ndanë* janë sinonimike me parafjalët emërore *buzë, anë* dhe me parafjalët ndajfoljore *anës,*

pranë. Emrat që pasojnë parafjalën *ndanë e mbanë* tregojnë një send konkret, zakonisht jofrymor, si p.sh: lumë, përrua etj., por të njëjtët emra në shumicën dërrmuese të rasteve përdoren jo pas *ndanë*, *mbanë*, por pas parafjalëve *buzë, anë, rrëzë, pranë*. Pra, në vend të *ndanë, mbanë* lumit (përroit, rrugës, udhës etj., mund të përdoren më mirë *buzë* lumit (përroit, vatrës etj.) ose *pranë* fshatit, lumit, vatrës etj. Në vend të *ndanë, mbanë* hendekut (liqenit, rrugës etj. mund të përdoren *anë* ose *anës* hendekut, liqenit, rrugës, në vend të *ndanë, mbanë* malit kodrës, pemës etj., në vend të *ndanë, mbanë* malit, kodrës, pemës mund të përdoret *rrëzë* malit, kodrës, pemës etj.

“Probleme gjuhësore”, përdorimi i shenjave të pikësimit

Por syrit të mprehtë të gjuhëtarit nuk i shpëtojnë edhe shenjat e pikësimit. Përdorimi i gabuar i tyre përherë sjell probleme në gjuhën e shkruar. I tillë është përdorimi i presjes.

Kështu, Prof Çeliku gjen hapësirën për t’u ndalur tek përdorimi i presjes në fjalët, togjet e fjalitë e ndërmjetme që folësi i përdor për të treguar vërtetësinë e burimit e kumtimit, lidhjen e gjymtyrëve të fjalisë e fjalëve, si dhe për të bërë vlerësimin emocional të kumtimit të cilat shqiptohen me një intonacion të veçantë dhe, përgjithësisht, ndahen me pauza, duke ndërprerë kështu, vijën e intonacionit të fjalisë. Prof. Çeliku thekson përdorimin e presjes në tri rastet, kur ndodhet në fillim, në mes, në fund. Më pas, ai jep shembuj të fjalëve të ndërmjetme në togje e fjali të ndërmjetme të grupuara sipas kuptimit të tyre. Gjithashtu, autori nuk lë pa përmendur edhe rastet kur fjalët e togjet e fjalëve nuk ndahen me presje, të cilat ai këshillon të mos përdoren dhe jep shembuj të shumtë të rasteve, kur nuk përdoret asnjë shenjë pikësimi.

Më 5 mars 1972, Mehmet Çeliku në artikullin e radhës trajton gjerësisht çështje të përdorimit të shenjave të pikësimit, p.sh.: kur përdoren dy pika në vend të presjes apo vija ndarëse në vend të presjes.

Shenjat e pikësimit kanë rëndësi të veçantë sidomos në ato raste, kur mjetet leksikore e sintaksore nuk janë të mjaftueshme për të dhënë qartë lidhjen e fjalëve e të fjalive. Ato mund të jenë të vetmit tregues të marrëdhënieve ose të nuancave kuptimore që vendosen ndërmjet fjalive. Në ligjërimin e folur këto nuanca shprehën me anë të intonacionit.

Presja në fjalët e ndërtimet e ndërmjetme herë-herë nuk është një pasqyrim i thjeshtë i intonacionit karakteristik të tyre, kuptimi i disa ndërtimeve të njëjta diferencohet me shkrim vetëm

nga prania ose mungesa e presjes. Autori jep shembuj ku ndërtimi i nënvizuar, i ndarë me presje është i ndërmjetëm, ndërsa shembulli tjetër, ndërtimi i nënvizuar i pandarë me presje funksionon si fjali lidhore-përcaktore: “Atëherë ai, *që thoni ju*, ngriti dorën dhe i këputi një pëllëmbë të fortë në fytyrë...” (P.Marko) “- Unë këtë *që thua ti*, nuk e mendova.” (N.Jorgaqi)

“Probleme gjuhësore”, përdorimi i foljes “bëj”

Jo tolerant ndaj gabimeve, duke këmbëngulur gjithnjë në përdorimin e drejt të fjalëve, prof. Çeliku trajton qartë edhe problemet që dalin nga shpërdorimi i fjalës *bëj*. *Bëj* është një nga fjalët që përdoret më shumë në gjuhën shqipe, si në gjuhën popullore, thjesht, ligjërimit dhe në të gjitha stilet e gjuhës letrare. Autori rendit larmishmërinë e përdorimeve: si njësi leksikore, si element përbërës në shumë njësi a shprehje frazeologjike, në togfjalësha të leksikalizuar ose që janë në rrugën e leksikalizimit, në ndërtime të tjera dhe së fundmi, si mjet gramatikor. *E ç’të bëjmë moj bijë?; bëhem dyllë; bëj lëshim; ujk më bëre mua ti?*

Pra, sjell shembuj të përdorimit të kësaj fjale në të gjitha stilet, por shumë shprehje frazeologjike e togfjalësha janë karakteristike sidomos për stilin bisedor. Mehmet Çeliku tregon se autorët, disa nga këto ndërtime mund t’i përdorin në gojën e personazhit e, kryesisht, në gojën e njerëzve që nuk kanë një nivel të lartë arsimor. Në gjuhën e autorit, në stilin shkencor e publicistik ndërtimet si: *bëj pushim, bëj llogari, bëj zbulim, bëj bisedë, bëj vizitë, bëj luftë, bëj të qartë, etj.*, do jetë më mirë të jepen me sinonimet përkatëse: *pushoj, llogaris, zbuloj, bisedoj, udhëtoj, luftoj, qartësoj etj.*

Prof. Çeliku këshillon se për t’u mënjeluar është edhe përdorimi i foljes *bëj* në kuptimin e disa foljeve të tjera. Përdorime të tilla nuk duhet të ketë në gjuhën e autorit, pasi raste të tilla tregojnë varfëri leksikore të autorit. Ilustrimet me shembuj nga vepra të ndryshme (*kush do ta bëjë projektin*) (*do ta hartojë*) (*të gjitha ato bënin 200 lekë*) (*kushtonin*) *me lëngun do bëhej kaçamak* (*do gatuhej*) *etj.*, qartësojnë qëllimin e trajtimit të këtij problemi.

Mehmet Çeliku evidenton edhe një rast tipik të përdorimit abuziv të foljes *bëj* në vend të foljeve të tjera, përdorimin në dialogje të shprehjes “*ja bëri*”, të cilën e përdorin fëmijët apo njerëzit me nivel arsimor e kultural të ulët. Mehmet Çeliku vëren se shumë shkrimtarë e kanë futur këtë shprehje që tregon një veprim të papërcaktuar në veprat e tyre dhe ç’është më keq, disa autorë e përdorin gjerësisht. Në qoftë se kjo shprehje mund të lejohej ndonjëherë në gojën e personazheve, nuk mund të lejohet në asnjë mënyrë në gjuhën e autorit. Përdorimi i shprehjes “*ja bëri*” në vend

të foljeve *tha, pyeti, u përgjigj, ndërhyri, ndërpreu, urdhëroi, shau, ja pat, etj.*, varfëron mundësitë shprehëse të gjuhës.

Prof. Çeliku radhit emrat e shkrimtarëve ku vihet re një përdorim i tillë, si: N. Jorgaqi, P. Zoto, Dh. Shuteriqi, Gj. Zheji, si edhe shembuj të shumtë vjelë nga veprat e tyre. Sipas Tij edhe D. Agolli është autori që përdor më shumë “bëri” se sa “ja bëri”. Dhjetëra raste ai i evidenton në romanin “Komisari Memo”. – *Thoma-bëri Memua* – po me Rustemin ç’ngjau? (f.48)

“Probleme gjuhësore”, pikësimi i thirrorit

Një çështje tjetër që prof. Çeliku trajton në “Këndin e vogël të gjuhës” është edhe pikësimi i thirrorit. Thirrori në gjuhën shqipe, sikurse edhe në gjuhë të tjera së bashku me fjalët që i takojnë atij, ndahet me presje nga pjesa tjetër e fjalisë, pavarësisht nga pozicioni ku ndodhet (në fillim, në mes, apo në fund të fjalisë). Presjet vendosen, jo vetëm për të pasqyruar në të shkruar pauzat që e ndajnë thirrurin nga fjalia, por edhe intonacionin karakteristik të tij. Pra, pas thirrurit që ndodhet në krye të fjalisë vihet një presje, thirruri që ndodhet në mes të fjalisë ndahet nga fjalia me dy presje, një përpara e një prapa, thirruri i vendosur në fund të fjalisë ndahet nga fjalia me një presje, ndërsa pas tij vihet pikë, pikëçuditje, ose pikëpyetje sipas llojit të fjalisë p.sh.: *Shoku Llazi, maqina erdhi*. Thirruri që qëndron në fillim të fjalisë shqiptohet në disa raste me intonacion të fortë thirrës ose me intonacion çuditës; në raste të tilla pas tij vihet pikëçuditje e jo presje, ndërsa fjala e parë e pjesës tjetër të fjalisë ka shkronjë të madhe. P.sh.: *E dashur Teftë! Së pari dëshiroj të jesh mirë*.

Me të drejtë prof. Çeliku thekson se ka autorë që nuk e respektojnë rregullin e mësipërm për ndarjen e thirrurëve me presje a me pikëçuditje. Kështu, disa autorë, kur thirruri është në mes të fjalisë, nuk përdorin asnjë presje, disa përdorin vetëm një presje, ose vihet pikë në vend të presjes. Me presje nuk e ndajnë disa thirrurin edhe në fund të fjalisë. Kuptohet rëndësia e madhe e përdorimit të saktë të shenjave të pikësimit në raste të tilla, ku vetëm shenja e pikësimit (pikëçuditje e presje), e vënë pas këtyre fjalëve dhe shkronja e madhe apo e vogël e fjalës pasuese përcakton intonacionin dhe vlerën e fjalëve të nënvizuara më lart. Mehmet Çeliku thekson se në raste të tilla nuk duhet përdorur jo vetëm presja në vend të pikëçuditjes a pikëçuditja në vend të presjes, po as edhe pika në vend të tyre. – *Qen. Më tadhëtove, ulëriti papritur kryetari*. Presjet vihen edhe midis thirrurëve të përsëritur. Në qoftë se midis thirrurëve të përsëritur përdoret një pjesëz thirrëse, atëherë para saj

vendoset presja. –*Shoku Kujtim, shoku Kujtim!* Kundër rregullit të përgjithshëm, disa autorë, thirrurët e përsëritur nuk i ndajnë me presje: *Ah! Rinë! Rinë!* Pikësimi i thirrurit është i lidhur me shqiptimin e tij, prandaj ai ka interes jo vetëm për folësin e lexuesin e zakonshëm, por edhe për folësit e radios e televizionit, madje edhe për aktorët e teatrit.

“Probleme gjuhësore”, fjalët e togjet e ndërmjetme

Vëmendje të posaçme merr nga prof. Çeliku edhe përdorimi i fjalëve a togjeve të ndërmjetme. Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme përdoren mjaft në të gjitha stilet e gjuhës letrare. Në shumicën dërrmuese ato janë formalizuar, kanë marrë një formë të qëndrueshme e të saktë. Megjithatë në përdorimin e tyre ka raste luhatjesh e shmangiesh. Fjalët modale ndoshta e paraqesin kumtimin si të mundshëm, të supozuar e përdoren paralelisht. Disa autorë parapëlqejnë njëren prej tyre, ndërsa disa të tjerë parapëlqejnë tjetrën. Madje luhatje vihen re te i njëjti autor. P.sh.: *Ndoshta, një nënë do të flasë me djalin ushtar.*

Mehmet Çeliku thekson përdorimin e togut të *paktën* (më shpesh) e *së paku* (më rrallë). Ai tregon se variantet pa *t së paku, të pakën*, megjithëse popullore, po përdoren gjithnjë e më rrallë; ndër to *të pakën* është vjetëruar. Një luhatje tjetër vihet re në shkrimin e togjeve të ndërmjetme *pa dyshim* e *pa tjetër*. Këto dalin si togje ose si fjalë të ndërmjetme. Luhatje vihen re në shkrime të të njëjtit autor. *Qemali, pa dyshim, është një figurë e madhe. Togu pa dyshim, për mendimin tonë duhet ruajtur si i tillë e nuk duhet shkruar si një fjalë e vetme.* Procesi i shkrirjes së parafjalës *pa* me emrin pasues nuk ka shkuar aq përpara në këtë rast.

Luhatje përbën edhe fjala e ndërmjetme *fundja*, e cila shpeshherë del edhe në trajtën *fundit*. *Po, fundja, kjo s'ishte gjë e madhe se unë jam mësuar vetëm.* Trajta *fundja* duhet të ngrihet në normë, sepse ajo është e diferencuar edhe formalisht nga fjala *fundit* në funksion të një gjymtyre çfarëdo në fjali. *Fundit, as nuk ishim edhe ne disa minj?* Togu i ndërmjetëm *fundit* i *fundit* tashmë është përgjithësuar në këtë trajtë, por pranë tij takohen edhe trajtat *fundit fundit, fund'i fundit* të cilat duhen mënjanuar si shmangie nga përdorimi. Në vend të togjeve *nga njëra anë, në një anë* që kanë edhe gjymtyrët përgjegjëse *nga ana tjetër, në anën tjetër* që janë në normë takohen edhe këto trajta që janë shmangie nga norma; përdoret e paplotë gjymtyra e dytë (*nga njëra anë...nga tjetra*). Përdoret në trajtë të paplotë një në gjymtyrëne parë (*nga një anë*), përdoret parafjala *më* në vend të *në* në të dy gjymtyrët (*më një anë*).

Prof. Çeliku që ka vëzhguar me kujdes mënyrën si përdoret gjuha shqipe, jo vetëm nga nxënës e studentë, por edhe nga shkrimtarët që kanë formim e kulturë të lartë gjuhësore është i prerë kur thekson se duhen mënjanuar edhe këto përdorime: Shkrimi i ndarë i fjalës së ndërmjetme *me doemos*, në vend të *medoemos*, parafjalës *pas* (*pas mendimit tim*) në vend të *sipas*, togu ose fjala *kështu që*, në vend të *kështu*, fjala *biles* në vend të *bile*, togjet *vete fjala*, *me të tjera fjalë*, në vend të *fjala vjen e me fjalë të tjera*, *pa tjetër* në vend të *patjetër*, *së parit* në vend të *së pari*, *përkundër* në vend të *përkundrazi*.

Fjalët e ndërnjetme me origjinë turke si dhe togjet që përmbajnë ndonjë fjalë me origjinë të tillë si: (*h*) *elbete*, *bile*, *bejta*, *dobare*, *xhanëm*, *zaten*, *asël*, *pa derman*, *për baft*, *etj.*, mund të përdoren për nevoja stilistike, për të karakterizuar edhe gjuhësisht personazhet e veprave letrare. Përndryshe në vend të tyre duhen përdorur fjalët e togjet përgjegjëse, si p.sh.: *natyrisht*, *ndoshta*, *madje*, *të paktën*, *në të vërtetë*, *pa tjetër*, *për fat* etj.

Përfundim

Është e vështirë të përmbledhësh në një artikull kontributin e madh të prof. Çelikut për vite të tëra në gazetën periodike “Drita”. Më lart u renditën disa nga problemet gjuhësore që ai evidentoi më së shumti në përdorimin e gjuhës shqipe, sidomos nga shkrimtarët e letërsisë artistike dhe, jo pa qëllim, edhe ne i kemi sjellë me ilustrimet përkatëse për të shpjeguar qëndrimin e rreptë, rëndësinë dhe përgjegjësinë që ky gjuhëtar merrte kur vinte fjala për gjuhën shqipe, shëndetin e saj teorik dhe praktik, me të cilën lidhej pazgjidhshmërisht ardhmëria e kombit shqiptar që frymon shqip nga lashtësia deri më sot.

Bibliografi:

- ÇELIKU, Mehmet (1985), *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe shkolla*, Gjuha jonë 1, Tiranë, ,
ÇELIKU, Mehmet (1970), Gazeta “Drita”, Tiranë.
ÇELIKU, Mehmet (1971), Gazeta “Drita”, Tiranë.
ÇELIKU, Mehmet (1972), Gazeta “Drita”, Tiranë.
ÇELIKU, Mehmet (1973), Gazeta “Drita”, Tiranë.

